

DOMOSDOSHËMËRIA E REFORMIMIT ADMINISTRATIV-TERRITORIAL TË PUSHTETIT VENDOR RAST STUDIMI: QARKU GJIROKASTËR

Msc. Arben Hysi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, me profil Menaxhim, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj

Numri i fjalëve: 52,630

Tiranë, Shkurt 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj së ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një komisioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

1. ABSTRAKTI

Ky është një punim që hulumton reformën admiministrativo- territoriale në Shqipëri, duke marrë si rast përfaqësimi Gjirokastrën. Në fokus kryesor të objektivave të tezës janë tri orientime që udhëheqin të gjithë punën. Për të aksesuar reformën administrativo territoriale, së pari matet rëndësia dhe përshtatshmëria e modelit të ngritur nga Ministria e Çështjeve Vendore Shqiptare për kryerjen e reformës territoriale - administrative. Ky punim arrin të vërtetojë vlefshmërinë e modelit të zonave funksionale të përdorura për reformën administrative territoriale dhe të vlerësojë së ky është modeli i duhur për kontekstin e zonës së Gjirokastrës. Në hapin e dytë të studimit, testohet nëse modeli i zonave funksionale është zbatuar siç duhet në Gjirokastër. Për këtë testohet modeli i zonave funksionale, i cili zbulon së cilat janë hendeqet dhe në çfarë mase janë keqmenaxhuar kriteret e ndarjes territoriale. Hapi i tretë dhe i fundit është adresimi i hendekëve të implementimit të modelit të zonave funksionale në Gjirokastër dhe sugjerimi i një modeli alternativ të ndarjes së re administrativ- territoriale. Përfundimi final i këtij punimi është se: modeli i zonave funksionale është modeli i duhur për kontekstin e Gjirokastrës, por nuk është implementuar duke realizuar një përmbrushje të të gjithë kritereve të zonave funksionale. Kjo rezulton në ndarje territoriale administrative dhe jo funksionale, mekanike dhe jo integrale. Ky punim sugjeron një model alternativ nëpërmjet të cilit mund të realizohet më mirë në praktikë modeli policentrik.

Fjalet kyçë: reformë admiministrative, ndarje territoriale, zona funksionale, pushtet lokal, pushtet ekzekutiv.

ABSTRACT

This is a work that explores administrative- territorial reform in Albania, by treating Gjirokastra District as a case study. Three main objectives guideline this thesis in overall. In order to access territorial administrative reform, priority importance and relevance takes model testing of administrative - territorial model established by the Albanian Ministry of Local Affairs. This paper manages to prove usefulness of functional areas model used for administrative-territorial reform and assess that this is the right model for Gjirokastra District context. The second step of the study, analyses whether the model of functional areas is implemented properly in Gjirokastra . For testing this, functional areas model gaps are identified by revealing the extent in which they are mismanaged. The third and last step is the process of addressing the implementing trenches of the functional areas model in Gjirokastra and suggest an alternative model for one new administrative-territorial division, which is considered more appropriate. The final conclusion of this paper is that: the model of functional areas is the right model for the context of Garrotters, but has not been properly implemented by resulting in a lack of fulfillment for all criteria of functional areas. This results in a administrative and territorial division simply dysfunctional, mechanical processes and not integrations. This paper suggests an alternative model through which polytechnic model can be better realized in practice.

Key words: admiministrative reform, territorial divisions, functional areas, local government, executive power.

DEDIKIMI

*Këtë punim i`a dedikoj familjes time,
në veçanti dy fëmijve të mi Geraldës dhe Bajramit,
të cilët më jasin forcë çdo ditë të qenies time.*

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Dëshira dhe realizimi i këtij punimi u bë e mundur nëpërmjet mundësisë që më dha Universiteti Europian i Tiranës. Falënderoj UET për trajtimin dhe përkujdesjen shkencore të programit të realizuar, aftësinë dhe përkushtimin e stafit.

Falenderoj miqtë dhe kolegët e mi, të cilët me ndihmën dhe vërejtjet e tyre më inkurajuan për të ecur përpara.

Një falenderim i veçantë i shkon atyre që më ndihmuani për të plotësuar pyetësorin duke lënë kohën dhe punët e tyre.

Dua të falenderoj gjithashtu, udhëheqësen shkencore Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj, e cila ka qenë një mbështetje e madhe në të gjitha fazat e punimit dhe ditët doktorale të zhvilluara.

Falënderoj familjen time, për kohën që më kanë kushtuar dhe ndihmën e dhënë.

Përbajtja e Lëndës

KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1 Arsyet e studimit të temës	3
1.2 Konteksti i Studimit.....	4
1.2.1 Udhëkryq i Dyfishtë	4
1.3 Deklarimi i Problemit të Kërkimit.....	7
1.3.1 Hendeku në Literaturë	7
1.3.2 Nevoja e një Reforme Administrativo-Territoriale në Kontekstin Botëror...	7
1.3.3 Nevoja e një Reforme Administrativo-Territoriale në një Vend: Rasti i Shqipërisë	10
1.4 Studime pararendëse mbi reformën Administrative Territoriale në Shqipëri .	12
1.5 Justifikimi i Studimit	13
1.6 Qëllimi i Punimit	14
1.7 Pyetjet e Kërkimit.....	17
1.8 Hipotezat e Kërkimit	18
1.9 Kufizimet e Studimit	19
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS	21
2.1 Koncepte dhe Përkufizime	21
2.1.1 Natyra e pushtetit.....	21
2.1.2 Koncepte për Rajonet	26
2.2 Decentralizimi: Eksperiencia Botërore dhe Europiane.....	32
2.2.1 Decentralizimi: Korniza Teorike.....	37
2.2.2 Tre D- Dekoncentrimi, Delegimi dhe Decentralizimi	40
2.2.3 Të decentralizohemi apo jo?.....	42
2.2.4 Pse të decentralizohemi?	44
2.2.5 Decentralizimi: Përvoja e reformimit të pushtetit lokal	47
2.2.6 Eficienca në lidhje me rritjen e numrit të popullsisëne	50
2.2.7 Vlerësimi i performancës në Qeverisjen Vendore.....	53
2.2.8 Vlerësimi i performancës dhe qasjet e saj	55
2.2.9 Arsyet për ndërtimin e një njësie të madhe vendore	57

2.2.10 Tendenca Negative të Rritjes së Madhësisë së Njësisë dhe thellimit të Decentralizimit	62
2.2.11 Decentralizimi – Mësimë dhe Rezultate.....	64
2.3 Decentralizimi në Nivele të Ndryshme	66
2.3.1 Decentralizimi në Vendet në Trazicion e zhvillim: Probleme të Përbashkëta	66
2.3.2 Decentralizimi në Vendet e Zhvilluara: Decentralizimi Fiskal dhe Zhvillimi Ekonomik.....	71
2.3.3 Decentralizimi: Eksperienca e Vendeve Nordike në Ndarjen Administrative-Territoriale	79
Burimi: (Gjonaj, 2015	82
2.3.4 Decentralizimi: Eksperienca e Vendëve të Europës PP	82
KAPITULLI III. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor në hqipëri.....	87
3.1 Analizë e Shqipërisë në Terma të Strukturës Administrativo – Territoriale	87
3.1.1 Decentralizimi: Rasti i Shqiperisë	87
Ndarja e Pushteteve në Republikën e Shqipërisë	87
3.1.2 Parimet e Organizimit dhe Funksionimit të Pushtetit Vendor në Shqipëri	92
3.1.3 Përbledhje Teorike e Momenteve më të Rëndësishme Historike të Reformimit Administrativo - Territoriale.....	94
3.1.4 Analize dhe Hulumtim i Reformës Administrativo – Territoriale në Shqipëri e Vitis 2013-2015	97
3.1.4.1 Një Reformë Gjithëpërfshirëse	97
3.1.4.2 Argumentat Pro Reformës dhe Kriteret	101
3.1.4.3 Problemet me Ndarjen e Vjetër.....	102
3.1.4.4 Reforma Administrativo – Territoriale në Shqipëri: Post Reformim..	104
3.1.4.5 Variantet e Qeverisë për Ndarjen e re Territoriale.....	105
3.1.5 Trajtimi i Minoriteteve në Shqipëri	112
KAPITULLI IV: Metotologjia e Kërkimit	115
4.1 Qëllimi I Punimit.....	116
4.2 Objektivat e Kërkimit. Pyetjet e ngritura dhe hipotezat.	116

4.3 Dizenjimi i Kërkimit.....	118
4.4 Kampioni i marrë në studim.....	119
4.5 Pritshmëria.....	120
4.6 Instrumenti i Mbledhjes së të Dhënave	121
4.7 Justifikimi i Instrumentit të Studimit.....	121
4.8 Variablat	124
4.9 Metodologja Statistikore e përdorur	127
4.9.1 Ngritja e Modeleve Statistikorë	127
4.9.2 Vlerësimi dhe Testimi i të dhënave statistikore.....	128
4.9.3 Modeli i regresit linear të shumëfishtë	129
4.9.4 Modeli i regresit logjistik të shumëfishtë.....	132
KAPITULLI V : REZULTATE DHE INTERPRETIME	134
5.1 Analizë e situatës post reformës 2016 në nivel makro	135
5.2 Analiza e Qarkut Gjirokastër në nivel rajonal	136
5.2.1 Analiza e lëvizjeve demografike	137
5.2.2 Ndërveprimi institucional	138
5.2.3 Analiza e mundësive për punësim.....	140
5.2.4 Analiza e nderveprimit ekonomik	142
5.2.5 Analiza e eficencës ekonomike	143
5.3 Analiza e vlerësimit të hipotezave.....	147
5.3.1 Analiza e Të Ardhurave të njësive vendore	147
5.3.2 Analiza e shpenzimeve të njësive vendore Qarku Gjirokastër.....	150
5.3.3 Analiza e Shërbimeve të njësive vendore.....	153
5.3.4 Përbledhje e analizës për hipotezën e parë.....	156
5.3.5 Analiza e grandit specifik të njësive vendore.....	157
5.3.5.1 Interpretim Analiza e Regresionit për ndikim e lidhjes midis popullsisë , sipërfaqes dhe transfertës scpecificke	160
5.3.5.2 Permbledhje për H1.b.....	163
5.3.6 Analiza për vlerësimin e performancës së njësive vendore.....	164

5.3.6.1 Regresioni Linear I shumëfishtë	176
5.3.7 Analiza e regresionit logistik.....	183
5.3.7.1 Kontrolli i ndikimit të variablate të pavarur tek F5.P1. “Si e vlëresoni profesionalizmin e personelit të bashkive në trajtimin e problemeve që keni kërkuar zgjidhje në bashki ? “	183
5.3.7.2 Kontrolli i ndikimit të variablate të pavarur tek F5.P2. “Merrni të gjitha llojet e shërbimeve në bashkinë ku jetoni ?“	187
5.3.7.3 Kontrolli i ndikimit të variablate të pavarur tek F5.P3. Si e vlerësoni cilësinë e shërbimeve që merrni në bashkinë ku jetoni ?	192
5.3.7.4 Kontrolli i ndikimit të variablate të pavarur tek F5.P4. A është zvogëluar kostoja për shërbimet që merrni në bashki ?	196
5.3.7.3.1 Përbledhje e analizës së regresionit logistik	200
5.3.8 Analiza e modelit “ Zona funksionale” për njësitë vendore.....	202
5.3.8.1 Analiza e Regresionit të thjeshtë Linear i popullsisë si variabël i pavarur me Institucionet e Shërbimeve Publike si variabël i varur.....	202
5.3.8.2 Analiza e Regresionit të thjeshtë Linear i Popullsisë si variabël i pavarur me Njësitë e Biznesit si variabël i varur	205
5.3.8.3 Analiza e Regresionit të thjeshtë Linear i Popullsisë si variabël i pavarur me Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë si variabël i varur.....	208
5.3.8.3.1 Përbledhje analizës hipoteza H3	211
5.3.9. Sygjerimi i një modeli	212
KAPITULLI VI . KONKLUZIONE TOTALE PUNIMI	227
6.1 Rekomandimet.....	232
SHTOCJA.....	244

Listë e Figurave

Figura 1 Skema e kompetencave të pushtetit lokal.....	76
Figura 2 Skema e ndarjes së pushteteve në republikën e Shqipërisë	88
Figura 3 Skema e decentralizimit dhe dekoncentrimit të shërbimeve publike	89
Figura 4 Struktura organizative e njesise vendore(komune,bashki),	90
Figura 5 Kuadri logjik i Metodologjisë së punimit.....	115
Figura 6 NJQV-të në qarkun e Gjirokastrës sipas popullsisë.....	138
Figura 7 NJQV-të në qarkun e Gjirokastrës sipas institucioneve	140
Figura 8 Përqendrimi i popullsisë dhe drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarave në qarkun e Gjirokastrës.....	141
Figura 9 Përqëndrimi i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve në qarkun Gjirokastër.....	142
Figura 10 Krahasimi i grandit për frymë para dhe pas reformës	144
Figura 11 Krahasimi i të ardhurave për frymë	148
Figura 12 Krahasimi i shpenzimeve për frym.....	150
Figura 13 Krahasimi i shërbimeve për vitet 2014-2016.....	153
Figura 14 Shpërndarja e zërave të buxhetit të NJQV-ve.....	158
Figura 15 Raporti i buxhetit të NjQV-ve/PBB, në vitet 2013, 2015, 2016, 2016.....	159
Figura 16 Regresioni linear i shumëfishtë për Transfertat Specifike.....	163
Figura 17 Banorët e pyetur sipas bashkive	165
Figura 18 Banorët e pyetur sipas grupve.....	166
Figura 19 Banorët e pyetur sipas arsimit.....	167
Figura 20 Banorët e pyetur sipas gjinisë	168
Figura 21 Banorët e pyetur sipas moshës.....	169
Figura 22 Regresioni i shumëfishtë , Performanca e Zonës Funksionale	182
Figura 23 Regresioni Linear për Institucionet e Shërbimeve Publike me Popullsinë.....	204
Figura 24 Regresioni Linear për Njësitë e Biznesit me Popullsinë.....	207
Figura 25 Regresioni i Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë me Popullsinë.....	210
Figura 26 Derivimi i një modeli alternativtë ndarjes Administrative Territoriale të Gjirokastrës bazuar në Konceptin e Rrethit	216
Figura 27 Skema aktuale e ndarjes së njësive administrative , Qarku Gjirokastër	219
Figura 28 Qarku Gjirokaster	220

Lista e Tabelave

Tabela 1 Tabela e të dhenave për organizimin e pushtetit vendor të vendeve Europeiane	82
Tabela 2 Tabela e popullsisë në Republikën e Shqiprisë sipas përkatësisë etnike ...	112
Tabela 3 Tabela e llogaritjes së masës së kampionit për popullatën masive në Gjirokastër sipas ndarjeve territoriale	119
Tabela 4 Indikatorët për përcaktimin e variablave.....	123
Tabela 5 Tabela e Variablate.....	124
Tabela 6 Pesha e buxhetit të NJQV-ve në vite.....	135
Tabela 7 Krahasimi në zëra i rritjes së buxhetit pas reformës , në milion	136
Tabela 8 Krahasimi i grantëve/frymëi në njësitë e qeverisjesi vendorei para dhei pasi kryerjesi së reformës	144
Tabela 9 Të dhënavë e njësive vendore 2014 në 000 leke	145
Tabela 10 Të Ardhurave për viti 2014 në 000 lek	147
Tabela 11 Të Ardhurave për viti 2016 në 000 lek	148
Tabela 12 Analiza Deskriptive për TR midis viti 2014-2016	149
Tabela 13 Shpenzimeve për vitin 2014 në 000 lek	151
Tabela 14 Shpenzimeve për vitin 2016 në 000 lek	151
Tabela 15 Analiza Deskriptive për Shpenzimet/frymë midis viti 2014-2016.....	152
Tabela 16 Shërbimeve për vitin 2014 në 000 lek.....	153
Tabela 17 Shërbimeve për vitin 2016 në 000 lek.....	154
Tabela 18 Analiza Deskriptive për Shërbimet/frymë midis viti 2014-2016.....	155
Tabela 19 Raporti i grandit të pushtetit vendor me PBB	157
Tabela 20 Vlerat e R , analiza e Transfertës Specifike	160
Tabela 21 Koeficjentët e regresionit linear të shumëfishtë , analiza e Transfertës Specifike	161
Tabela 22 Korelacioni i variablate , analiza e Transfertës Specifike	162
Tabela 23 Gjetjet nga pyetësorët në teren	169
Tabela 24 Përbledhëse statistikore për pyetësorin	173
Tabela 25 Analizës deskriptive	175
Tabela 26 Vlera e R, analiza e Performancës së Zonës Funksionale.....	176
Tabela 27 Koeficjentët e regresionit linear të shumëfishtë , analiza e Performancës së zonës Funksionale	177
Tabela 28 Korelacioni i Variablate , analiza e Performancës së Zonës Funksionale.....	179
Tabela 29 Sinjifikanca e modelit , analiza e regresionit logjik , F5.P1.....	183

Tabela 30 Vlera e R , analiza e regresionit logjik , F5.P1.....	184
Tabela 31 Koeficientët , analiza e regresionit logjik , F5.P1	184
Tabela 32 Model Fitting Information , analiza e regresionit logjik , F5.P1.....	187
Tabela 33 Test of Parallel Lines ^a , analiza e regresionit logjik , F5.P1	187
Tabela 34 Sinjifikanca e modelit , analiza e regresionit logjik , F5.P2.....	188
Tabela 35 Vlera e R , analiza e regresionit logjik , F5.P2.....	188
Tabela 36 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit logjik , F5.P2	188
Tabela 37 Model Fitting Information , analiza e regresionit logjik , F5.P2.....	191
Tabela 38 Test of Parallel Lines ^a , analiza e regresionit logjik , F5.P2	191
Tabela 39 Sinjifikanca e modelit , analiza e regresionit logjik , F5.P3.....	192
Tabela 40 Vlera e R , analiza e regresionit logjik , F5.P3.....	192
Tabela 41 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit logjik , F5.P3	193
Tabela 42 Model Fitting Information , analiza e regresionit logjik , F5.P3.....	196
Tabela 43 Test of Parallel Lines ^a , analiza e regresionit logjik , F5.P3	196
Tabela 44 Sinjifikanca , analiza e regresionit logjik , F5.P4.....	197
Tabela 45 Vlera e R , analiza e regresionit logjik , F5.P4.....	197
Tabela 46 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit logjik , F5.P4	197
Tabela 47 Model Fitting Information , analiza e regresionit logjik , F5.P4.....	200
Tabela 48 Test of Parallel Lines ^a , analiza e regresionit logjik , F5.P4	200
Tabela 49 Vlera e R , analiza e regresionit linear , Institucionet e Shërbimeve Publike ...	202
Tabela 50 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit linear , Institucionet e Shërbimeve Publike	203
Tabela 51 Vlera e R , analiza e regresionit linear , Njësitë e Biznesit.....	205
Tabela 52 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit linear , Njësitë e Biznesit.....	205
Tabela 53 Vlera e R , analiza e regresionit linear , Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë	208
Tabela 54 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit linear , Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë.....	209
Tabela 55 Distanca kohore në NJQV Gjirokastër.....	215

KAPITULLI I: HYRJE

Ky kapitull përmban kontekstin e punimit. Në të specifikohen çështjet e adresuara dhe shpjegohen motivet e studimit. Gjithçka bëhet bazuar tek referimet e autorëve më të njojur të fushës.

Ky punim trajton çështjen e vlerësimit të efektivitetit të reformës administrative – territoriale në Shqipëri në drejtim të arritjes së qëllimit të decentralizimit, si emërues i përbashkët i objektivave të reformave të ndërmarra nga një sërë vendesh Europiane – Lindore në dekadat e fundit.

Punimi ka si qëllim kryesor vlerësimin e ndikimit që reforma e fundit administrative – territoriale, e miratuar nga parlamenti shqiptar në 23.07.2014 nëpërmjet ligjit “Për ndarjen administrativo- territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” ka në drejtim të proceseve decentralizuese.

Nëpërmjet hulumtimit është përpjekur që të analizohet modeli i reformimit në tërësi dhe kriteret e reformimit një për një, me synimin e vlerësimit dhe gjykimit të kësaj reforme relatuar me përvojën e shteteve të ngjashme dhe mbi të gjitha relatuar me vetë përshtatjen e kësaj reforme me kontekstin shqiptar.

Tematika është aktuale, madje për disa mund të konsiderohet edhe si e parakohshme, pasi shpesh pas një reforme duhen lënë rezultatet që të flasin përficiencën. Por nisur nga vetë rëndësia e kësaj tematike, si faktor i rëndësishëm për të rritur decentralizimin administrativo –territorial në vend, i cili është një nga

objektivat e vendosura për vendin tonë nga BE, është gjykuar kjo temë do të japë një kontribut të rëndësishëm në literaturën mbi performancën e ndarjeve të reja administrativo - territoriale.

Gjatë realizimit të studimit janë konsultuar dhe shfrytëzuar materiale të ndryshme që marrin në analizë këtë proces, është analizuar mënyra sesi reforma administrative - territoriale është perceptuar dhe konkretizuar në nivel kombëtar dhe veçanërisht në nivelin vendor në Gjirokastër, por pa anashkaluar edhe studimet e bëra për këtë qëllim nga institucione, si BB, PNUD-i, FMN-ja etj. Analiza është bazuar mbi eksperientat më të mira në këtë drejtim, ka patur synimin e gjetjes së anëve të përbashkëta apo dhe diferenca e ndërmjet asaj që reforma kishte si objektiv dhe mënyrës si ajo është implementuar. Për të arritur në këtë synim janë marrë në konsideratë përgjigjet e vetë popullsisë mbi efektet që ka kjo reformë, tek vet ata që janë përfituesit final të kësaj reforme.

Problemi është trajtuar në dy aspekte: në nivel konceptimi dhe atë implementimi. Synimi ka qenë, që gjatë analizës të reflektohet mbi ecurinë e këtyre proceseve të para në nivelin kombëtar dhe në atë rajonal.

Në fund të punimit, është bërë analiza e objektivave me arritjet, me qëllim evidentimin e përmirësimeve që duhet të bëhen, me synimin që reformimi jo vetëm t'i shërbejë decentralizimit, por mbi të gjitha t'i shërbejë qytetarëve në nivel sa më cilësor.

1.1 Arsyet e studimit të temës

Për të zbatuar një sistem të qëndrueshëm administrativ dhe territorial të decentralizuar, qeveria e Shqipërisë duhet të tregojë kujdes nëse po i kushton rëndësinë e duhur fazës më delikate të performancës së një reforme, pikërisht implementimit të saj.

Duke patur parasysh sa më sipër disa nga motivimet e ndërmarrjes së kësaj teme janë: *Së pari*, nuk është kryer ende një rishikim i efektivitetit të reformës aktuale administrative – territoriale. Kjo ishte sfida e këtij punimi: të ishte i pari që ngre pyetje ambicioze për efektivitetin e reformës më të madhe administrative – territoriale në Shqipëri në 30 vitet e fundit. *Së dyti*, kriteret e reformës u bënë nisur nga parimi i Benchmark: përzgjedhja e metodës më të mirë dhe maksimizimi i përpjekjeve për t'a arritur atë. Por, nuk është adresuar ende, sa i përshtatshëm është ky model për kontekstin shqiptar dhe nuk është bërë një rishikim pas në histori për të krahasuar këtë metodë me metodat e tjera e për të nxjerrë mësimet e duhura nga e shkuara. Ky studim nxitet nga dëshira për t'a krahasuar reformën administrative – territoriale të vitit 2014 me reformat e tjera të ndërmarra përgjatë viteve në historinë e Shqipërisë dhe me nevojat që paraqet kjo fushë në ditët e sotme. *Së fundmi*, reforma administrative – territoriale nuk ka një plan emergjence, çka do të thotë se e merr si të mirëqenë si “One Best Way” e proçesit të reformimit. Ky punim nuk pranon egzistencën e paracaktuar të “One Best Way” dhe u ndërmor për të verifikuar sukseset dhe hendekët që ka ende për të përbushur kjo rrugë e gjatë reformimi e sistemit administrative – territorial në Shqipëri.

1.2 Konteksti i Studimit

1.2.1 Udhëkryq i Dyfishtë

Në raportin e Bankës Botërore “Raporti për zhvillimin botëror”, për vitin 2004, në fjalën hyrëse të drejtorit të BB, në fjalinë e dytë shkruhet: “For the first time in human history, we have the possibility of eradicating global poverty in our lifetime.” Duke e vendosur theksin e reformimit të pushtetit lokal të orientuar drejt misionit të reduktimit të varfërisë në rang global. Rritja e aksesit të shtresave të varfëra në shërbimet e administratës publike, kjo në dakordësi edhe me 8 qëllimet e mileniumit të ri. E gjithë metodologja, të dhënat e mbledhura dhe ngritja e shtjellimi i problemit sipas raportimeve të BB në këtë botim, kanë si bosht reduktimin e varfërisë.

Në këtë raport përmendet edhe Shqipëria, konkretisht në paragrafët në vijim:

- Kornizat e shpenzimeve afat-mesme nuk janë një shkop magjik. Rezultatet aggregate dhe sektoriale në terma të zhvillimit të kapaciteteve për uljen e shpenzimeve afatmesme, zbulojnë një tablo të përzier. Disa prej aplikimeve janë duke u zhvilluar ngadalë (Shqipëri, Afrika e Jugut, Uganda).
- Në mënyrë ideale, strategjitet e varfërisë duhet të integrohen plotësisht në buxhet, por kjo është ende një qasje e re. Për disa vende, integrimi ka qenë një synim primar (Shqipëri). Tanzania dhe Uganda kanë integruar strategjitet e varfërisë me kornizat e tyre të shpenzimeve afatmesme, duke i shtuar fokusit legjitimitet dhe stabilitet për të dyja.

Banka Botërore (2013) pohon se ka qenë e përfshirë në një numër të madh të projekteve të zhvillimit urban dhe komunal. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (2009) vuri në dukje se më shumë se 190 projekte të reformave administrative – territoriale të tilla janë zbatuar që nga viti 1998. Shumica e vendeve kanë hyrë në një proces të decentralizimit, me shkallë të ndryshme të progresit dhe suksesit (Kogut, 2014). Edhe Janno Reiljan (2012) deklaron se kudo ku shikon rreth globit, një lloj i decentralizimit është duke u zhvilluar apo duke u diskutuar.

Sipas Bankës Botërore (2013), që nga fillimi i krizës financiare, ekonomike, dhe sociale të vitit 2008, autoritetet lokale dhe rajonale në mbarë Europën kanë pasuar domosdoshmërinë për t'u përshtatur në një kontekst të ri politik dhe ekonomik. Reforma të shumta janë bërë në lidhje me praktikat e këtyre qeverive, si dhe funksionet e autoriteteve subnacionale. Strukturat territoriale dhe administrative në nivel vendor dhe rajonal janë aktualisht në fokus në gjithë Europën, për shkak të modernizimit të vazhdueshëm të sektorit publik.

Problemet me pushtetin lokal në Europën Juglindore janë të ngjashme me ato në Evropën Perëndimore, ku ngrihen pyetje në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe kapacitetet administrative. Administratat territoriale të pjesës dërrmuese të vendeve të Europës Juglindore janë njësi qëndrore shumë të fragmentuara dhe joefikase dhe lokale me vështirësi serioze në planifikimin hapësinor. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për reforma të suksesshme, por nevojat dhe kërkesat për ndryshime vijojnë të jenë prezente. Karta Evropiane për Liritë Komunale e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1985, sot është ratifikuar pjesërisht apo në tërësi nga të gjithë 47

shtetet anëtare të saj. Përveç një dispariteti të mënyrës së kryerjes së reformave, karta ka dy këndvështrime kryesore të cilat i eksploron: *së pari* Dilema midis decentralizimit dhe ricentralizimit e *së dyti*, presionet financiare. Në këtë kuptim, një studim i cili hulumton me detaje të gjithë reformën territoriale në Shqipëri është i domosdoshëm. Përse thuhet që vendet nga gjithë pjesët e globit, veçanërisht në Europë, po përjetojnë një udhëkryq në terma të reformës administrativo – territoriale? “Decentralizimi në një udhëkryq, reforma territoriale në Evropë në kohën e krizës” është titulli i një botimi të Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Europën Jug-Lindore.

Mësimet nga praktikat e reformimit administrativo - territoriale tregojnë se, megjithëse reformat në nivelin makro janë të vështira për t'u arritur, mund të bëhet shumë në nivelin e qeverisjes vendore, kur ekziston vullneti politik për përgjegjësi më të madhe në përdorimin e fondeve publike dhe kur reforma në gjenerimin e të ardhurave është e lidhur në mënyrë të qartë me raportin, shpenzimet e dukshme / investimet në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kuptim udhëkryqi i parë është: udhëkryqi që po përjetojnë të gjithë vendet e Europës të përforcuar nga kriza ekonomike. Nga ana tjetër, udhëkryqi i dytë është udhëkryqi që po kalon struktura administrativo – territoriale në Shqipëri. Parlamenti i Shqipërisë në 2014 deklaron në projektligjin për reformën administrativo – territoriale në Shqipëri: Reformat administrativo – territoriale nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë, disa më pak e disa më shumë, përgjithësisht qeveritë e tranzicionit dështuan në sfidën e menaxhimit të territorit.

Reforma madhore e reformimit administrativo – territorial të Shqipërisë e ndërmarrë në 2013 dhe e implementuar në 2015, a do i bashkohet vargut të dështimeve të reformave të mëparshme homologe? Apo, kjo reformë do të jetë e suksesshme?

Pyetja, ashtu sikurse e shtron Niko Nako (2014) në shkrimin: “Reforma E Ndarjes Administrative” është: reforma është e nevojshme, madje e vonuar, por kjo reformë rrezikon të rezultojë në bashkime mekanike dhe arimetikë dhe jo në një reformë të vërtetë dhe reale.”

1.3 Deklarimi i Problemit të Kërkimit

1.3.1 Hendeku në Literaturë

Nga sa u diskutua në paragrafin paraardhës mund të deduktohet se aktualisht, nuk është ende e qartë përsë disa reforma administrativo-territoriale kanë qenë të suksesshme dhe pse disa jo. Në këtë paragraf do të hidhet dritë mbi hendekët në kontekstin botëror dhe atë shqiptar.

1.3.2 Nevoja e një Reforme Administrativo-Territoriale në Kontekstin Botëror

Sipas Bankës Botërore (2013), që nga fillimi i krizës financiare, ekonomike, dhe sociale të vitit 2008, autoritetet lokale dhe rajonale në mbarë Europën kanë konstatuar domosdoshmërinë e përshtatjes në një kontekst të ri politik dhe ekonomik. Reforma të shumta janë bërë në lidhje me praktikat e këtyre qeverive, si dhe funksionet e autoriteteve subnacionale. Këto ndryshime legislative dhe organizative, shpesh të

iniciuara nga qeveritë lokale, vënë në dyshim rolin e nivelist lokal dhe rajonal në mirëmenaxhimin e punëve të brendshme të shteteve (Publication, 2013).

Njësitë vendore në qeveritë e centralizuara, kanë për qëllim thellimin e decentralizimit, atëherë për të mundësuar këtë, u bënë bashkime të njësive vendore, shumica e të cilave ishin pjesërisht të detyruara, si një përpjekje për të shmangur ose eleminuar sistemet dy shtresore që shiheshin si jofunksionale (Sancton, 2000:112)

Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane (CEMR), që përfaqëson 57 shoqata kombëtare në 41 vende, mbron qeveritë lokale dhe rajonale dhe shoqatat e tyre përfaqësuese dhe i kërkohet të veprojë si një zëdhënës në përfaqësimin e interesave të tyre gjatë këtyre përpjekjeve. Reformat që përfshijnë riorganizimet territoriale janë bërë mjaft të zakonshme gjatë disa dekadave të fundit në Evropë.

Aq rëndësi i është kushtuar performancës së procesit të reformimeve territoriale saqë, në shkurt të vitit 2013, CEMR dërgoi një pyetësor tek shoqatat anëtare të saj, që përfaqësojnë autoritetet lokale dhe rajonale nga 40 vende evropiane, në mënyrë që: (1) të rinovonte të dhënat e saj në çdo reformë territoriale të përfunduar ose në përgatitje, (2) për të kërkuar mendime mbi pikëpamjet e autoriteteve lokale dhe rajonale në lidhje me ndryshimet legjislativë dhe mbi çështjen e vetëqeverisjes lokale në vendin e tyre.

Përgjigjet e dhëna të këtij pyetësori përbëjnë një nga burimet kryesore të informacionit për të gjitha studimet e mëvonshme, të cilat kanë si qëllim studimin e ndikimit që reforma territoriale ka pasur mbi autonominë e autoriteteve lokale dhe rajonale të Evropës.

Kriza financiare, ekonomike dhe sociale nuk e ka rimodeluar arkitekturën e përgjithshme të autoriteteve lokale dhe rajonale në Europë. Ajo megjithatë ka pasur një ndikim të madh në qasjen e Evropës për organizimin e shërbimeve dhe çështjes së pavarësisë financiare. Reformat territoriale që po zhvillohen aktualisht, marrin parasysh dëshirën për decentralizim më të madh dhe parimin e subsidiaritetit mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshillit të Evropës. Megjithatë, veprimet e caktuara qeveritare janë në kundërshtim me këto parime. Për më tepër, ato shpesh duken se rezultojnë në ricentralizimin e kompetencave, braktisje të afërsisë së qeverive lokale ndaj qytetarëve, si rezultat i organizatave të reja territoriale dhe në kufizime të shumta buxhetore dhe operative.

Në lidhje me metodologjitet e reformimit është vënë re një tendencë e përgjithshme e bashkimit të njësive vendore të vogla ose rajonalizimit të territorit. Kjo reformë, bazuar në konceptin e një Europe të rajoneve, ka qenë shumë aktive në vitet 1980 dhe 1990 dhe që në shenjat e para të krizës financiare, duket së fenomeni është rikthyer.

Reformimi administrativo-territorial në ditët e sotme, në ndryshim nga e shkuara, nuk është më i fokusuar vetëm në realizimin e objektivit të decentralizimit, por ka integruar edhe objektivin e përmirësimit të eficencës me të cilën autoritetet lokale dhe rajonale menaxhojnë shpenzimet buxhetore/ operative të alokuara nga qeveritë qëndrore.

Karta Evropiane për Liritë Komunale ka festuar përvjetorin e gjashtëdhjetë që kur u krijuar në vitin 1951. Ajo ka përqëndruar gjithmonë vëmendje të veçantë në parimin e vetëqeverisjes lokale. Asambleja e Përgjithshme e organizatës në vitin 1953 e ka

mishëruar këtë parim duke miratuar Kartën Evropiane për Liritë Komunale, e cila në 2013 festoi për nder të 60 vjetorit të saj. E nënshkruar nga më shumë së 1000 komuna në të gjithë Evropën, Karta thekson rëndësinë e pavarësisë politike dhe financiare të komunave nga qeverisja qëndrore. Për më tepër, kjo kartë lindi tre dekada pas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. E miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1985, sot ajo është ratifikuar, pjesërisht apo në tërësi, nga të gjithë 47 shtetet anëtare të saj. Përveç një dispariteti të mënyrës së kryerjes së reformave, karta ka dy këndvështrime kryesore të cilat i eksploron: Dilema midis decentralizimit dhe ricentralizimit e së dyti, presionet financiare.

1.3.3 Nevoja e një Reforme Administrativo-Territoriale në një Vend: Rasti i Shqipërisë

Shqipëria në 20 vitet e fundit, i ka transferuar kompetencat shtesë njësive rajonale, të cilat kanë forcuar rolin që ato luajnë. Megjithatë, vlen të theksohet së në të shkuarën njësitë e qeverisjes vendore emërtoheshin “bashki” dhe “komuna”, pas reformës së fundit administrativo-territoriale tani ekziston vetëm koncepti i bashkive.

Cilat janë forcat motivuese që fshihen prapa sipërmarrjes së reformës administrativo-territoriale?

Ashtu sikurse u argumentua në hyrjen e këtij punimi, reformat administrativo territoriale janë praktika të përhapura në të gjithë Europërn (vecanërisht në atë Jug- Lindore) për shkak të objektivave të neutralizimit të eksternaliteteve negative të krizës ekonomike dhe financiare. A vlen e njëjtë arsyet edhe në konteksin shqiptar?

Studimet dhe mendimet e autorëve pohojnë se, në fakt ka patur motivacione më të forta për të adresuar domosdoshmërinë e reformimit administrativo – territorial. Së pari, reforma e tashme territoriale planifikon të transferojë kompetenca të caktuara në favor të bashkive. Kjo ka të bëjë me shpërndarjen e ujit, menaxhimin e mbeturinave dhe menaxhimin e pyjeve, si edhe me shërbime të tjera publike. Niveli lokal, në këtë mënyrë forcohet në përputhje me dëshirën për integrim të vendit në nivel evropian. Në të njëjtën kohë, edhe pse autoritetet lokale dhe rajonale të vendit nuk duket se kanë vuajtur nga pasoja të mëdha si rezultat i krizës ekonomike dhe financiare, kanë vendosur të programojnë në mënyra efektive programe, për të kanalizuar aktivitetet, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të zvogëluar shpenzimet. Përveç kësaj, qeveria po përpinqet të nxisë bashkëpunimin ndër-bashkiak, një zgjidhje që favorizon gjithnjë e më shumë njësitë vendore për menaxhimin e disa shërbimeve publike lokale. Së fundi, duhet theksuar objektivi i menjëherëshëm i këtij projekti të reformimit është që të sjellë madhësinë, organizimin dhe kompetencat subjekteve të qeverisjes vendore në përputhje me standarde evropiane, të përdorura në menaxhimin strukturore të fondeve. Reforma e qeverisjes lokale po kryhet në Shqipëri për të forcuar vetëqeverisjen e autoriteteve lokale dhe rajonale duke i caktuar atyre kompetenca të reja, duke i'u lejuar gjithashtu përbushjen e detyrave të tyre, përmes transferimit të financimit të mjaftueshëm.

Sipas raportit të projektligjit për reformën administrativo – territoriale në Shqipëri (Minisria e Brendshme, 2014) komisioni i ngritur për konkludimin e modelit më të mirë të reformimit administrativo- territorial në Shqipëri, është përgatitur duke studiuar reformat e shteteve të tjera europiane. Sigurisht që Shqipëria mund të mësojë

nga procesi dhe rezultatet e reformave të suksesshme. Modeli i implemetuar për reformimin është krijuar dhe nga rekomandimet e dhëna nga institucionet ndërkombëtare, për të përmirësuar strukturat administrative-territoriale. Në konferencën Post Reformim (Shqiptarja, 2016) u pohua se thelbi i modelit të reformës administrativo – territoriale ishte evidentimi i zonave funksionale, duke marrë si model “One Stop Shop”, të prezantuar në Shkoder e Lezhë dhe më pas implementimi edhe në bashkitë e tjera të vendit.

1.4 Studime pararendëse mbi reformën Administrative Territoriale në Shqipëri

Në këtë pjesë do të hulumtohen disa prej punimeve që analizojnë një apo disa aspekte për të cilat interesohet ky punim.

Studimi: “Ndikimi i Proceseve Decentralizuese në Zhvillimin Rajonal dhe Social: Rasti I Vlorës”, Veliu (2012), i paraprin kryerjes së reformës administrative- territorial. Ai shtrihet në dy linja kryesore: analizimin e legjislacionit, strategjisë sociale dhe politikave vendore të Shqipërisë si edhe në relacionin ndërmjet decentralizimit dhe rritjes ekonomike. Aspekt pozitiv i këtij punimi është se, i paraprin reformës administrativo - territorial, duke kërkuar ndarje të qartë të përgjegjësive dhe funksioneve të aktorëve të ndryshëm në fushën e legjislacionit, financimit, vëzhgimit profesional etj. Nga ana tjetër, punimi ndihmon duke hedhur dritë mbi direktivat dhe rekomandimet për proçesin e decentralizimit duke marrë shembuj të vendeve homologe. Por, kufizim i studimit është së fokusohet më së shumti në aspektin e decentralizimit të funksioneve dhe institucioneve sociale që u shërbijnë shtresave në nevojë. Për këtë arsyen ky punim nuk mund të merret si shterues për problemen e reformës administrative-territoriale

në Shqipëri. Kjo do të thotë së përtej problemit të shtresave në nevojë, reforma duhet të analizohet në terma më të gjerë, për një vlerësim të plotë të saj. Eva Dhimitri 2014, në dhënjen e një varianti, në të cilin nuk përcaktohen kritere dhe modele përgjithësues.

1.5 Justifikimi i Studimit

Për të adresuar hendekët e mësipërm në literaturë, janë kryer shumë studime.

Egzistojnë tri punime të cilat fokusohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë rëndësinë që ka marrë çështja e reformave administrativo – territoriale në botën e sotme:

- Reforma Strukturore – një rrugë drejt suksesit? (Kivist., 2008)
- Reforma administrative brenda Komisionit European. (Marinovic, 2008)
- Decentralizimi në udhëkryq – reformat territoriale në Europë në kohën e krizës. (CEMR Publication, 2013)

Nga ana tjerër ka shumë studime të viteve të fundit që trajtojnë problemin e reformimit administrativo territorial në vende të ndryshme të Europës (kryesisht asaj jug-lindore).

- “Përqasje ndaj implementimit të reformës administrativo – territoriale në Ukrahinë.” (Kogut, 2014)
- “Nevoja e reformës administrativo - territoriale në një shtet: Rasti i Estonisë” (Reiljan, 2012).
- “Zhvillimi i kordinimit të mekanizmit qeveritar në Hungari” (Kovács, 2014)

- Kontrastimi i reformës administrativo-territoriale në Poloni dhe Ukrainë. Pse vende të ngjashme zgjedhin rrugë të ndryshme decentralizimi.” (Romanvska, 2012).

Fakti që pjesa më e madhe e botës është duke kaluar nëpër një formë të decentralizimit, dëshmon për rëndësinë e një zhvillimi të tillë. Ky konkluzion përforcon gjithçka që u diskutua më sipër: decentralizimi është në një udhëkryq. Cili është lloji i vetëqeverisjes lokale benchmark¹? Kjo pyetje ende nuk ka një përgjigje të saktë. Ky studim i pozicionuar mbi skepticizmin ndërkombëtar të çështjeve të decentralizimit, i shërbën jo vetëm kontekstit shqiptar për një vlerësim shkencor të mënyrës së implementimit të metodologjisë së zonave funksionale, por edhe për t'i shtuar literaturës botërore analiza që hapin shtigje të reja në prakikat e reformimeve të suksesshme dhe të pasuksesshme.

1.6 Qëllimi i Punimit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij disertacioni është të analizojë reformën e fundit madhore administrativo – territoriale që ka ndodhur brenda Shqipërisë. Në këtë kontekst, disertacioni kërkon të shqyrtojë korrektsinë dhe funksionalitetin e implemetimit të modelit të implemetuar të reformimit, si edhe karakteristikat kryesore strukturore të koordinimit të qeverisë qëndrore me atë lokale.

Ky hulumtim do të kontribuojë në kuptimin më të mirë të modelit më të përshtatshëm të reformimit administrativo – territoriale në Shqipëri.

¹ Në literaturën menaxheriale ky term është gjërësisht i njojur dhe përdoret për të shpjeguar “me të mirin e tregut” . Kjo do të thotë së për çdo proces, ide, produkt, apo sistem në përgjithësi egziston një më i miri i tregut i cili merret si standardi më i lartë i mundshëm për t'u arritur nga çdo operator tjetër.

Ky studim përpitet të analizojë me baza shkencore qeverisjen administrativo – territoriale nga perspektiva e qarkut të Gjirokastrës, por edhe të shqyrtojë në mënyrë më konkrete reformën që ka përfshirë çdo qark të vendit. Analiza e përqasjeve teorike dhe praktike mbi madhësinë e bashkive kërkon të nxjerrë në pah nëse, njësitë aktuale administrativo – territoriale janë të fragmentarizuara dhe të papërshtatshme.

Ky punim ka tri objektiva themelore:

- Të matet rëndësia dhe përshtatshmëria e modelit të ngritur nga Ministria e Çështjeve Vendore Shqiptare për kryerjen e reformës territoriale - administrative.
- Të testohet nëse modeli i zonave funksionale është zbatuar siç duhet në Qarkun e Gjirokastrës.
- Të adresohen hendekët e implementimit të modelit të zonave funksionale në Gjirokastër dhe sugjerimi i një modeli alternativ të ndarjes së re administrativ-territoriale.

1.7 Pyetjet e Kërkimit

Këto faza që janë në fakt edhe qëllime të studimit do të realizohen nëpërmjet përgjigjes së pyetjeve si më poshtë:

1. A ka sjell reforma administrativo-territoriale në Shqipëri, rritjen e eficencës dhe thellimin e decentralizimit të pushtetit vendor?

1.a: A është rritur fuqia financiare e buxheteve të njësive vendore?

1.b: A janë rritur të ardhurat për frymë në NjQV-ve ?

1.c: A është zvogëluar kosto për frymë në NjQV-te?

1.d: A ka mundësuar rritjen e decentralizimit reforma në të gjithë njësitë NJQV?

1.e: Si ka ndikuar rritja e popullsisë në thellimin e decentralizimit te NJQV?

1.f: Si ka ndikuar sipërfaqja në thellimin e decentralizimit ne NJQV?

2. A ka rritur performancën e shërbimeve reforma territoriale në të gjitha njësitë vendore të qarkut Gjirokastër?

2.a: Si ndikojnë faktorët ekonomikë në performancën e zonës funksionale?

2.b: Si ndikon faktori social-kulturor në performancën e zonës funksionale?

2.c: Si ndikon infrastruktura në performancën e zonës funksionale?

2.d: Si ndikon rrjeti i institacioneve pubike në performancën e zonës funksionale?

3. A është i përshtatshëm modeli i zona funksionale në të gjitha njësitë vendore?

Nënpjetjet e pyetjes tre, e cila është më e rëndësishmja e këtij punimi janë si vijon:

- 3.a: Si ndikon numri i bizneseve në zbatimin me efektivitet të modelit?
- 3.b: Si ndikon numri i institucioneve publike ne zbatimin me efektivitet të modelit?
- 3.c: Si ndikon numri i institucioneve shëndetësore ne zbatimin me efektivitet të modelit?

1.8 Hipotezat e Kërkimit

H1: Modeli i zonës funksionale zbatuar nga Qeveria Shqiptare është modeli më i përshtatshëm për reformimin e pushtetit vendor, rrit të ardhurat/ frymë, zvogëlon shpenzimet administrative/frymë, mundëson thellimin e nivelit të decentralizimit.

H1.a : Rritja e madhësisë së zonës funksionale ka lidhje positive me të ardhurat për frymë, dhe negative me zvogëlimin e shpenzimeve administrative/frymë.

H1.b : Rritja e madhësisë në popullsi dhe sipërfaqes ka lidhje pozitive me thellimin e decentralizimit.

H2: Performanca e NJ.Q.V-ve të konsoliduara (lidhje ekonomike, infrastruktur shërbimesh, lidhje tradicionale, vazhdimësi terreni) bashki ish-rreth, është më e mirë se performanca e NJ.Q.V - ve të pakonsoliduara (bashki jo qëndër rrathi).

H3: Hipoteza e tretë, Modeli “Zona Funksionale” është më i realizuar në bashkitë e konsoliduara (bashki ish-rreth) sesa në ato të pakonsoliduara (jo qëndër rrathi).

H3.a: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e shërbimeve publike.

H3.b: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e numrit të njësive të biznesit.

H3.c: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e numrit të shërbimeve shëndetësore.

Hipoteza tre nënkupton së pavarësisht së reforma aktuale administrativo – territoriale është udhëhequr nga kritere të përshtatshme për realizimin e ndarjes territoriale eficiente, ka vend për përmirësimin e mënyrës aktuale të implementimit të modelit të aprovuar të ndarjes administrativo - territorial dhe modele alternative duhet të sugjerohen.

1.9 Kufizimet e Studimit

Limitimi kryesor i studimit është se, analiza po kryhet në një kohë të shkurtër pas implementimit real të ndarjes administrativo territoriale. Kjo do të thotë se, nuk ka kaluar një kohë e mjaftueshme për të cilën reforma të japë efektet e saj. Gjithsesi, kjo nuk pengon në shqyrtimin e të dhënave teorike dhe empirike të deritanishme.

Nga ana tjetër, po të vijojmë me këtë kontekst, në Shqipëri mungojnë studime që të kenë hulumtuar performancën e reformave të shkuara administrativo – territoriale në Shqipëri. Kjo do të mundësonte krahasimet në rrafsh historik me studimet e reformave të mëparshme administrativo – territoriale, por edhe gjeografik me studime të bëra për vende të tjera.

Kufizimi themelor teorik është se, nuk egziston asnjë studim i mëparshëm në literaturë që adreson në mënyrë këtë temë me një metodë sasiore. Shumica e studimeve përdorin metodën cilësore të “Rastit të Studimit”.

Një nga kufizimet teorike të tjera mbetet pamundësia, për të kriuar matës sa më gjithëpërfshirës për të gjithë variablat e studimit. Egziston ky problem pasi është bërë kompromis midis: përqasjes holistike (përfshirjes së të gjithë variablave në studim) dhe përqasjes së fokusuar (specializimi i temës në trajtimin e thelluar të vetëm disa prej variablave).

Kufizimi i fundit mund të përmendet mungesa e transparencës mbi informacionet e natyrës financiare të institucioneve të përfshira në studim. Kjo do të mundësonë nxjerrjen e rezultateve më objektive.

KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Koncepte dhe Përkufizime

2.1.1 Natyra e pushtetit

Shoqëria njerëzore është e përbërë nga individë, të cilët në jetën e tyre të përditshme kanë interesa të cilat nuk mund ti plotësonin pa organizmat, e organizimin e kësaj shoqerie. Pa organizimin shoqëror njerëzit nuk do të kishin këto mundësi për të jetuar si sot, sepse vetëm në shoqëri njerëzit janë të aftë të kryejnë veprime komplekse për prodhimin e mjeteve të ndryshme të jetesës (Taylor,Laci, Sh. 2010:35). Në jetën e përditshme ndeshim në kontradikta individuale dhe të grupeve. Pikërisht, për të zgjidhur këto kontradikta dhe për të rregulluar sjelljen tonë, duhet një mekanizëm shoqëror që quhet shtet (Weber, 1991: 78)².

Njerëzimi ka mbijetuar për një kohë të gjatë pa shtetin dhe i ka zgjidhur konfliktet nëpërmjet vetëqeverisjes individuale dhe kolektive. Njerëzit në shoqërin fisnore gjëzonin të njëtin nivel të ardhurash materiale dhe ndikim politik. Mundësitë dhe niveli i zhvillimit ekonomik shoqëror, ishte i tillë që i detyronte njerëzit vvetët i ishin të bashkuar dhe të respektonin rregullat kolektive ose vetëqeverisëse për të mbijetuar.

Nga ana tjetër, qeverisja si koncept ka qënë gjithmonë e pranishme në marrëdhëniet njerëzore, si të atyre fisnore dhe pas-fisnore. Antropologjistët e konceptojnë qeverisjen si një proces që i ka prirë formimit të shtetit(Hobhus, 1964, Manxhari, M. 2009:6).

²H.Gerth dhe C.Eright mills, From Max Weber, London, 1991 fq.78

Qeverisja është procesi i rregullimit të sjelljes së shoqërise, duke përcaktuar e garantuar rregullin brënda shoqërisë. Sipas Hobhousit (1964), (Manxhari, M. 2010:6) individi i vetëqeverisur nuk mund të imagjinohet jashtë kufijve të të ashtuquajturit “shtet i vete-qeverisur”.

Në jetën e përditshme, shpeshherë ngatërrohen termat: (1) qeverisje si një lloj shoqërie dhe (2) qeveri (shtet) kur mes tyre nuk ka ndonjë ndryshim cilësor. Ato të gjitha paraqesin sisteme politike të formave dhe madhësive të ndryshme. Nacioni i qeverisjes thekson vazhdimesinë mes vetëqeverisjes, moralitetit, standardeve morale të pranuara, jetës familjare të organizuar dhe manaxhimit të ekonomisë. Max Webërs (Manxhari, M. 2010) e përkufizon shtetin “si një komunitet të bashkësisë njerëzore që shpall monopolin e përdorimit të forcës fizike brenda një territori të dhënë”. Ai thotë se shteti përbëhet nga: monopoli, territori, legjimiteti dhe forca. Në të gjithë shoqërinë janë të paevitueshme konfliktet e interesave, ekzistenca e tyre prodhon politikën, e cila në thelb ngre problemet dhe qeverisja duhet të gjej zgjidhje. Në këtë mënyrë qeverisja është procesi që u mundëson individeve t'i zbusin dhe zgjidhin problemet (Vallier, 2013). Qeverisja është pjesë e sistemit shtetëror dhe si e tillë ajo përmban forcën në vete. Kur elita përdori forcën për të drejtuar të tjerët, pikërisht në këtë moment kemi kalimin nga drejtimi me forcën e tradicionales zakonore, në përdorimin e dhunës.

Ndarja konceptuale e shtetit nga shoqëria ka qënë me ndikim të madh përmendimin politik dhe shkencën politike të mëvonshme. Hobsi, Ruso, Lok, Hegel Manxhari (2010), argumentojnë se, shoqëria është shuma e individeve dhe grupeve, me interesa vetjake ku secili ndjek interesin e vet dhe përpinqet ta realizojë atë, me çdo kosto dhe me një konflikt më të gjerë. Për të shpëtuar shoqërinë nga konflikti i përgjithshëm dhe i

përhershëm është i nevojshëm një aktor, organizëm, që nuk ka interesin e vet dhe qëndron mbi interesat e veçanta. Këtë funksion e realizon qeverisja (shteti), sepse konceptohet i shkëputur nga interesa direkte për të përfituar për vete dhe përfaqëson realizimin e interesit të përgjithshëm. Prej këtej lind një kontradiktë, midis qeverisjes dhe shoqërisë sepse, parimi i operimit të qeverisë dhe shoqërisë qëndrojnë në kontradikt me njëri - tjetrin.

Përkundër ndarjes së shtetit dhe shoqërisë një numër autorësh argumentojnë se, në shoqërinë e përparuar industriale, kufijtë midis shtetit dhe shoqërisë janë duke u shuar dhe nuk ekziston më një ndarje e qartë midis tyre. Një numër autorësh argumentojnë se kufijtë midis shtetit dhe shoqërisë janë të vendosura në varësi të konteksit dhe një vendosje e përhershme e kufijve nuk mund të konstatohet për të gjitha kontekstet. Në kulturën anglo-sanksone, koncepti shtet mund të këmbehet apo të barazohet me termat “komb”, “qeveri”, midis këtyre termave duhet bërë një dallim.

Kombi është një komunitet njerëzor i karakterizuar nga koshienca e identitetit të tij historik ose kulturor dhe shpesh prej unitetit të gjuhës dhe fesë. Shteti është një shprehje e nevojës që ndjen shoqëria për ekzistencën e një pushteti të organizuar.

Koncepti i kombit ka qënë përdorur në një mënyrë antropologjike për të shënuar një grup njerëzish të cilët kanë karakteristika të përbashkëta gjuhe, historie ose kulture. një shtet komb përfshin rastet ku shteti dhe kombi mbulojnë njëri-tjetrin. Në teorinë e Hegelit, shteti konceptohet si “realizimi i idësë morale”, në krahasim me shoqërinë ku ndiqen interesat egoiste private. Sipas pikëpamjeve të ndryshme pluraliste, shteti është mjedisi në të cilin realizohen interesa të grupeve të ndryshme sociale si rezultat i rritjes

së lëvisjes për të drejtat e individit dhe grupeve shoqërore, kombëtare etj. Ndaj shtetit janë vendosur dhe po vendosen kufizime në sovranitetin e brendshëm.

Giddens argumenton se, territori i caktuar i rrethuar nga kufijë të qartë është karakteristike e shtetit modern, kufijët gjenden vetëm në shtetin-komb, ndërsa territoret e shteteve tradicionale janë shënuar nga frontet (zona). Frontet i referohen një hapsire në rajonet periferike të shtetit, në të cilën autoriteti politik i qendrës është i shtrirë ose i përhapur dobët.

Ne shtetet moderne mund të ekzistojnë pikëpamje të përziera politike dhe sociale, që shfaqen nga grupe që jetojnë në hapësirat kufitare, këto grupe janë qartazi të nënstruara ndaj sundimit administrativ të njërit shtet apo tjetrit. .

Natyra e pushtetit vendor

Në vija të përgjithëshme, bashkësitë komunitare janë grupe sociale më të hershme që bazohen në miqësinë natyrore, në lidhjen natyrore, në vullnetin natyror dhe jo të organizuar mbi bazën e llogarive racionale.

Pushteti vendor ekziston jo vetëm për afrimin e shërbimeve, por dhe për plotësimin e nevojave sipas dëshirës së banorëve, (Tindal 1997, Byerne 2008: 153). Në kontekstin shqiptar pushteti lokal i referohet kryesisht bashkive, por gjithashtu përfshin një shumëlojshmëri të qëllime të posaçme lokale, organe të tilla si agjencitë, bordet dhe komisione. Qëllimi kryesor i të gjitha organizatave është të bëjë të mundur në mënyrë më efikase, arritjen e disa objektivave të përbashkëta. Në mënyrë tipike, njerëzit formojnë një institucion të qeverisjes lokale, kur ata mund të bëjnë gjëra së bashku, të cilat nuk mund t'i bëjnë në mënyrë efektive si individë. E thënë thjesht, qeveria lokale përbën një paisje institucionale dhe ligjore, që mundëson individët

për të vepruar kolektivisht për sigurinë e tyre dhe të mirëqenies së përgjithshëm. Pushteti lokal është formuar, kur përfitimet e bashkësisë janë më shumë të rëndësishme, se kënaqësitë dhe liritë e individëve, ose kur qëllimet shoqërore shihen si reciprokisht të dobishme. Crawford (1954:15) thekson, "... nevoja për pushtetin lokal lind kur njerëzit që jetojnë në komunitete, krijojnë shoqata pér zgjidhjen e problemeve, ose pér të arritur përfundime të dëshiruara reciproke ". Forma e një pushteti lokal shfaqet kryesisht në dy role themelore, administrimit të shërbimeve dhe përfaqësimit (shprehjen e dëshirave të njerëzve). Performanca e një organizate të qeverisjes vendore rrjedhimisht, duhet të matet kryesisht nga efektshmëria e saj në kryerjen e këtyre dy funksione. "Kombinimi i këtyre roleve sugjeron, se qeveria lokale ekziston pér të ofruar shërbime në përputhje me nevojat dhe dëshirat e banorëve"(Tindal,1977: 3).

Një nga justifikimet pér pushtetin lokal, është se ai shërben si një instrument i demokracisë, dhe si agjensi pér ofrimin e shërbimeve. Duke qenë më afér banorëve e bën atë në thelb, më të përgjegjshme se sa nivelet e tjera të qeverisjes (Crawford, 1954: 8). Të tjerë, ende shohin qeverisjen lokale si terren trajnimi pér liderët e ardhshëm politikë krahinor ose kombëtar. Sipas kësaj teorie, pushteti lokal është ai ku njerëzit, *së pari* do të mësojnë ushtrimin e demokracisë dhe marrin arsimin fillestare pér politikë. Pushteti vendor është koorporat natyrore, kufij gjeografik të caktuar, autoritet i zgjedhur (Keith. L. Miller, 2002: 3), Pushtet takse, (Trinda &Trindal, 2004: 2). Një qeveri lokale është njësi ekonomike ligjore, që i lejon banorët e një zone të caktuar gjeografike, që të sigurojnë shërbimet me interes të përbashkët. Por është edhe një institucion demokratik i qeverisur nga një këshill i zgjedhur nga banorët, pér të zgjedhur shqetësimet e tyre kolektive. Tiparet përcaktuese të qeverisjes vendore të paraqitura në Tindal & Tindal,(2004: 2): *Së pari*, duhet të jetë relativisht e qartë dhe dallimi i plotë në atribuimin dhe ndarjen e detyrave. *Së dyti*, qeveria lokale kërkon ngritjen e kufijve të identifikueshme

lehtësisht gjeografike. Këto kufijë janë të nevojshëm për të lejuar një popullsi të dhënë, për t'u identifikuar me qeverinë e saj lokale. Kufijtë gjeografikë ose politikë jo gjithmonë korrespondojnë me ata "natyrorë" ose de facto socio-demografike dhe hapësiren ekonomike të njësisë. Shpesh ekzistejnë disa subjekteve komunale, secili me kufijtë e tyre brenda një zone të caktuar metropolitane. Kapaciteti i popullatës lokale për t'u identifikuar me qeverinë e saj lokale, mund të të jetë i komplikuar më tej nga ndarja e shërbimeve në mesin e qeverive lokale fqinje. Në raste të tillë, kufijtë politike dhe gjeografik kanë tendencë të bëhen më pak të rëndësishme, duke komplikuar llogaridhëni. *Së treti*, pushteti lokal ka nevojë për një hapësire gjeografike, demografike dhe bazë financiare për kryerjen e përgjegjësive të tij. Kjo do të thotë se hapësira gjeografike dhe popullsia duhet të jenë të mjaftueshme, për të lejuar organizimin efektiv të afritimit të shërbimve.

Së katërti, qeveria lokale duhet të organizohet në mënyrë të tillë, që të bëjë të mundur caktimin e qartë të përgjegjësive ndërmjet të zgjedhurve dhe të emëruarve zyrtarë.

Së pesti, lidhja e brendshme mes zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar duhet të jetë e tillë, që ajo të kontribuojë në ushtrimin e lidershipit vendor, si dhe në koordinimin e mirë të aktiviteteve në kuadër të qeverisjes lokale, Tindal (1977: 2-4).

2.1.2 Koncepte për Rajonet

Një problem i rëndësishëm është shpërndarja gjeografike e popullsisë, si dhe çështja e "rajonalizimit". Por rajonalizim, jo në kuptimin e tregtisë së lire midis shteteve, por në kuptimin e zhvillimit të rajoneve brenda seclit vend. Kjo në fakt, është tema më e rëndësishme në

agjendën e të gjitha vendeve më të mëdha sot. Për shumë shtete të popujve të vegjël dëshira për vetëqeverisje, është thjesht një përgjigje logjike dhe racionale e nevojës për zhvillimin rajonal. Në vendet e varfra në veçanti nuk ka shpresë për të varfërit nëse nuk ka zhvillimi të suksesshëm rajonal, si dhe përpjekje të zhvillimit të zonave urbane jashtë kryeqytetit, qyteteve (Schumacher, E.F., 2004: 76).

Koncepte të tillë si decentralizimi, zhvillimi lokal dhe pjesëmarrja e qytetarëve, të cilat janë objekt i kësaj analize, studiues në shkencat shoqërore i përcaktojë dhe interpretojnë në mënyra të ndryshme (Sharma 2000: 183). Zhvillimi Ekonomik-Shoqëror i shumë vendeve Europiane sidomos në infrastrukturë, bëri të mundur afrimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, si dhe rritja e eficençës në përdorimin e fondeve publike, kjo herë pas here i ka detyruar që të rishikojnë organizimin e pushtetit vendor. Tindal & Tindal (2004: 3.), kur rendi i qeverisë lokale i shërben një territori shumë të madh "... ajo shkon drejt një pike, ku ajo humbet afërsinë e nevojshme me qytetarët, për të qënë qeveri lokale efektive ". Megjithatë ata pranojnë, se afërsia nuk është faktori i vetëm për t'u marrë parasysh në përcaktimin e shkallës së operacioneve të qeverisë lokale. Byrne (1963) argumentoi se: " kombinimi i metodave (struktura vendore dhe rajonale) në disa raste, mund të jetë mënyra më e përshtatshme për të siguruar që problemet komunitare të vogla, mund të administrohen në nivel lokal, ndërsa në të njëjtën kohë shërbime që paraqesin mundësi për ekonomitë e shkallës dhe duan ekspertizë më të gjerë, të ofrohen nga një organ rajonal "(Byrne, 1992: 45). Në disa vende kemi organizimin e pushtetit vendor në një nivel si Finland, Norvegji, Island, Estoni etj., por dhe shërbimet janë në lartësinë e duhur (Aalbu.et.al.2008: 16). Pikërisht në Shqipëri në qoftë se rrisim hapësirën e nivelit të pushtetit vendor atëherë patjetër duhet të ndryshojmë ose të ezaurojmë nivelin e dytë.

Rajonalizimi është tendenca e re botërore, me ndikim të ndërsjelltë edhe në qeverisje (Toto Rudina, 2014: 7) territori dhe zhvillimi. Në vitet 50-80, zhvillimi rajonal i mbështetur nga qeveritë, njozu një periudhë të suksesshme në nivel politik, ashtu dhe akademik. Por në vitet pas luftës së Dytë Botërore pati dështim në ecurin e rajonalizimit e pasuar nga suksesi i kësaj politike në vitet 80-90 të zhvillimit lokal. Politikat rajonale do të bënin zbutjen e diferençave lokale, për të cilat qeverisja qëndrore nuk bënte dot më shumë. Koncepti i zhvillimit lokal është i vështirë për t'u përcaktuar në terma standarde, pasi ai është i lidhur me një gamë të gjerë të përkufizimeve dhe interpretimeve (Oyugi 2000). Shumica e ekonomistëve “Laissez-faire”, e shpjegojnë zhvillimin lokal në drejtim të rritjes ekonomike dhe treguesve sasiorë, si rritja e prodhimit kombëtar bruto, ose për të ardhurat për frysë (Hussein, 2004). Nga ana tjetër, ekonomistët e mirëqenies kanë tendencë për të theksuar transformimin strukturor organizativ, dhe zhvillim lokal të shoqëruar me mirëqenien publike dhe arritjen e qëllimeve, si në rritjen e të ardhurave neto, uljen e varfërisë, papunësisë dhe pabarazisë shoqërore (Hussein, 2004). Në një kontekst tjetër, zhvillimi është i lidhur me modernizimin, blerjen e shërbimeve, objekteve dhe infrastrukturen, duke përfshirë ujë të pastër dhe të sigurt, arsimin, institucionet shëndetësore, rrugët, dhe shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, në nivel lokal (Venter, 2001). Në këtë drejtim, ne një pikëpamje më të gjerë të zhvillimit, që tejkalon pikëpamjet ekonomike dhe ndryshimet e thjeshta materiale, duhen përfshirë qëndrimet njerëzore në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve. Zhvillimi lokal shihet si një proces i veprimit social, në të cilin qytetarët apo njerëzit lokalë në rrethina, planifikojnë dhe marrin vendime në partneritet me qeverinë, për të përmirësuar kushtet politike dhe socio-ekonomike të lokalitetit (Sharma 2000). Kështu, fokusi është vendosur kryesisht në gjendjen e mirëqenies sociale dhe cilësinë e treguesve të

përgjithshëm në jetën e qytetarëve dhe jo në aspektet sasiore të rritjes ekonomike dhe ekonomisë shtetërore.

Zhvillimi rajonal nxorri në dukje disa instrumenta të tjerë ekonomike dhe nuk mund të perballoj me faktorët e erës së re të globalizimit, të cilët mund të trajtohen vetëm nën frymen e re të rajonalizimit (Plane et al. 2007). Pas viteve 90 “Rajonalizimi i ri”, ka sjell sigurimin e ekonomisë dhe qeverisjes së shkallës, stimulimin e konkurrencës, decentralizimin e vendimarrjes qëndrore në policentrike, fuqizimin e lidhjes midis territorit, ekonomisë dhe qeverisjes efektive (Toto Rudina, 2014: 7)

Debatet për rolin e natyrës së qeverisjes lokale dhe rajonale për impaktin në zonën urbane dhe atë rajonale, trajtohen midis dy grup-diskutimeve: nga njëra anë diskutohet impakti që ndryshimi ekonomik ka në territor, në strategjitet e zhvillimit dhe në reagimin institucional; nga ana tjëtër diskutohet në qartësimin e marrëdhënieve komplekse, midis shtetit, rajonit dhe lokalitetit (Herrschel & Neëman, 2002). Grupi i parë fokusohet në koordinimin e territorit specifik me rrjetin institucional, për krijimin e avantazheve krahasuese, grupi i dytë në kalimin e më shumë kompetencave nga qeverisja qëndrore në atë rojonale e lokale, pra një dobësim i shtetit tradicional. Në marrëdhëniet midis shtetit, territorit dhe zhvillimit ekonomik, kërkohet përshtatja e shtetit sipas specifikave e avantazheve të pasurive natyrore e zhvillimit shoqëror të rajoneve. Por, ka dhe kundërshtime që argumentojnë se qeveritë rajonale të zgjedhura, nuk ndikojnë në performancën rajonale (Harding et al, 1996).

Rajoni konsiderohet shkalla më e përshtatshme territoriale, bazë e ndryshimit të marrëdhënieve ekonomike dhe institucionale. Kjo ndodh për disa arsyet (Toto Rudina, 2014:8):

- Rajoni është njësi territoriale fleksibël dhe pozicionohet mes shkallës kombëtare dhe lokale, duke luajtur rolin e ndërmjetësit;
- Rajoni përmban identitetin kulturor dhe historik homogjen, e duke ushqyer ndjenjën e fortë të përkatësisë, ushtron presione politike dhe ndikon në krijimin e përfaqësimeve të rëndësishme politike;
- Rajoni inkurajon ekonominë e shkallës dhe konkurrencën e shëndetshme;
- Rajoni është hapësirë për mbrojtje të marrëdhënieve sociale;
- Rajoni është bazë për barazi ekonomike, hapësinore dhe përfitimeve mjedisore.

Sot në Politiken e bashkimit European kemi një tendencë për zbutjen e pabarazive ekonomike dhe sociale për të cilën një nga instrumentat e përdorur nga BE-ja janë dhe politikat për zhvillimet Rajonale. Këto politika e kanë zanafilën në vitin 1957, por vetëm në vitin 1986 u bë e mundur të implementohen, duke u fokusuar tek politikat investuese në rajonet e varfra. Traktati i Manstritit, 1992 dhe Traktati i rishikuar për komunitetin hynë në fuqi në vitin 1993, dhe materializuan fondin e kohezionit³, komitetin e rajoneve e prezantuan parimin e subsidiaritetit.

Për të zbutur disnivelet midis vendeve të Europës, në vitet 2007-2013 politikat e BE u përqëndruan në këto drejtime:

³ Toto Rudina, "Rajonalizimi I Shqiperise perkundrejt reformës Teritoriale", 2014, fq 8

- Konvergjencë- në kuadër të rritjes së pabarazisë rajonale si rezultat i zgjerimit të komuniteteve;
- Konkurrencë rajonale dhe krijim i vendeve të reja të punës;
- Bashkëpunim territorial Europian.

Sot theksohet dhe pjesëmarrja e qytetarëve, në katër fusha kryesore të teorisë demokratike: sjelljes politike, zhvillimit të komuniteteve, nismave qytetare dhe veprimtarisë qeveritare (Checkoway dhe Van Til 1978: 60). Ajo nënkupton një proces aktiv në të cilin pjesëmarrësit marrin iniciativë dhe veprime konkrete në lidhje me një institucion lokal, ku ata janë banorë ligjore për qëllime të caktuara (Brynard 1996). Pjesëmarrja e qytetarëve është kritike për zhvillimin lokal, pasi mundëson njerëzit për të kontrolluar dhe monitoruar burimet dhe aktivitetet zhvillimore lokale. Ajo shërben si një mjet monitorimi për abuzimet, sigurimin e transparencës dhe llogaridhënie, në shfrytëzimin e burimeve lokale (Clapper 1996).

Menjëherë pas ribashkimit, në teritorin e Gjermanisë Lindore (Buloë.J: 114) u krijuan 5 shtete. Në vitin 1990 të gjitha këto shtete filluan reformen territoriale në nivelin e konteve, deri në vitin 1993. Kontet e trashëguara ishin inefiqente, për shkak të vogëlsisë së tyre si njësi administrative. Gjermania Lindore e asaj kohe kishte 189 konte me një mesatare prej vetem 57000 banorë dhe sipërfaqe prej 557 km², ndërkohë që Gjermania Federale kishte 240, me një popullsi mesatare 169000 banorë dhe sipërfaqe 1000 km² për konte. Pas reformës (Buloë.J: 114) numri i konteve u reduktua në 89 njësi, me një numër mesatar prej 122000 banorë dhe me një sipërfaqe prej 1200 km². Për shkak të pavarësisë së (Buloë.J: 114) politikave të shteteve federale, standartet e zbatuara për krijimin e konteve qenë të ndryshme. Në disa shtete u fiksua numri i banorëve prej 80.000 banorë, ndërsa në disa shtete të tjera ky numër i banorëve ishte 150.000 banorë.

Përsa i përket sipërfaqes, ajo u la standarte për të gjitha shtetet si kriter prej 2500 km². Një kriter tjetër ishte ballancimi në burimet e pasurive, duke bashkuar komuna të pasura ekonomikisht me disa komuna më të dobëta. Eksperiencia tregoj se kishte vecori në qytetet e mëdha, barra e përballimit të problemeve sociale dhe shërbimeve (sportive, kulturore, mjedisore mjeteve të transportit publik, shkollave etj) nga bashkitë me taksat që mbledhin, kishte diferencim me komunat perreth. Gjithë të pasurit për shkak të mjedisit të ndotur dhe kërkimit të qetësisë, jetonin në komunat përreth, pra konsumi dhe taksat e tyre shkonin në komuna dhe jo në qytet. Kjo solli trajtimin me kujdes, duke përfshirë në konte komunat përreth të pasura por dhe komuna të largëta të dobëta. Një tjetër mënyrë për të ndihmuar komunat e varfëra, gjithmonë brenda hapësirave ligjore, ishte transferimi i qendrave të distriktit (rrethit) ose njësive administrative që kishin qindra persona të punësuar, pikërisht në qëndrat e komunave më të varfëra.

2.2 Decentralizimi: Eksperiencia Botërore dhe Europiane

Raporti Botëror i Zhvillimit, në hyrjen në shekullin e njëzetënë, arriti në përfundimin dramatik që dy janë forcat të cilat tjetërsuan botën: i pari është globalizimi, integrimi i vazhdueshëm i vendeve të botës, së dyti është lokalizimi vetëvendosja politike dhe shpërndarja e financave (Banka Botërore, 2000). Çfarë është emërtuar "lokalizimi" është përmendur shpesh si "decentralizim" - shpërndarja e funksioneve ndërqeveritare të sektorit publik ndërmjet llojeve të shumta të qeverisjes qëndrore dhe subnacionale.

Për më tepër, ndërsa në shikim të parë të dy tendencat duken kundërbalancuese, ato janë në fakt plotësuese, pasi shpesh rrjedhin nga të njëjtë faktorë të jashtëm. Mbështetjet e komplementaritetit të globalizimit me lokalizimin janë disa. Për shembull, përparimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit kanë lehtësuar përhapjen e dijes globale, që

lejon grupet e qeverisjes lokale të anashkalojë autoritetet qëndrore në kërkimin e tyre për efektivitetin e përmirësuar të qeverisjes. Gjithashtu ndikim ka dhënë edhe shfaqja e organizatave dhe institucioneve vendore, kombëtare, dhe ndërkombe, të tilla si: shoqëria civile dhe rrjete të tjera qytetare, regjimet e tregtisë së lirë, partnershipet e Qëllimeve të Zhvillimit të Mileniumit dhe, në disa raste, një monedhë e përbashkët.

Shumica e qyteteve në mbarë botën po përballen me sfida të financimit, falimentime, deficitet buxhetore, vakumet finanziare, mos-mirëmbajtje të infrastrukturës, rënie në cilësinë e shërbimeve, rritjen e varfërisë urbane, janë i probleme të shumë qeverive lokale.

Shumica e vendeve kanë hyrë në një proces të decentralizimit, me shkallë të ndryshme të progresit dhe suksesit (Janno Reiljan, 2012), është e drejtë të thuhet se në shumicën e rasteve, transferimi i përgjegjësive nga pushteti qendror drejt qeverive lokale nuk është shoqëruar me transferimin adekuat të burimeve. Ndër çështjet më të rëndësishme të mbetura pezull janë: a) nevoja për të qartësuar ndarjen e përgjegjësive ndërmjet niveleve të qeverisë; b) forcimin e bazës së burimeve të qeverive lokale. Disa reforma përpiken të sqarojnë përgjegjësitë pa adresuar çështje finanziare, të tjerë u caktojnë qeverive lokale përgjegjësitë e reja, për të cilat këto njësi nuk i kanë kapacitetet e nevojshme për t'i mirëmenaxhuar.

Në të njëjtën kohë, njësitë lokale po bëhen gjithnjë e më shumë të varura nga transfertat ndërqeveritare të cilat janë pakësuar, për shkak të presionit fiskal të krijuar nga ngadalësimi ekonomik global. Decentralizimi Fiskal dhe madhësia e qeverisjes, dy qasje të ndryshme, të rrënjosura në dy pikëpamjeve të kundërtta lidhur me vendim-marrjen ne sektorin publik, janë aplikuar për të analizuar efektin e konkurrencës fiskale mes niveleve qeverisës

horizontal,(Brennan & Buchanan 1980: 185). Decentralizimi i agjencive të Sektorit publik, prezanton elementet e konkurrues që kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve. Ky argument mbështetet ne hipotezën e famshme Leviathan: " Sa më e vogël ndërhyrja e qeverisë në ekonomi, aq më e madhe shkalla në të cilën taksat dhe shpenzimet janë decentralizuar "(Brennan dhe Buchanan, 1980: 185, Oates, 1985: 748). Qeveria lokale dorëzon pushtetin e tatimit tek qeveria qendrore, për të marrë grantet (Grossman 1989, Ehdaie 1994). Brennan dhe Buchanan (1980: 183) theksojne, se një marrëveshje e tillë është e padëshirueshme ", sepse ajo rrëzon qëllimin parësor të federalizmit, e cila është për të krijuar konkurrencë mes juridiksioneve. Lidhjet e tjera midis decentralizimit fiskal dhe madhësisë së qeverisjes mund të ekzistojnë: (1) për shkak, se decentralizimi paraqetet më i pranueshem mes preferencave të popullsisë për taksat dhe shpenzimet publike (Oates, 1972); (2) sepse agjensitë politike në nivel lokal, janë më të afta për të afruar sherbime publike për nevoja elektorale të tyre (Oates, 1972); (3) për shkak se decentralizimit rrit llogaridhënen dhe dukshmërinë e zyrtarëve publikë.

Banka Botërore ka qënë e përfshirë në një numër të madh të projekteve të zhvillimit urban dhe komunal. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (2009) vuri në dukje se më shumë së 190 projekte të reformave administrative – territoriale të tilla janë zbatuar që nga viti 1998. Ky raport gjithashtu vuri në dukje, se performanca më e lartë ishte në mesin e komunave në Afrikë, ku u zbatuan projekte të zhvillimit nga Banka Botërore. Mësimet nga këto praktika tregojnë se, megjithëse reformat në nivelin makro janë të vështira për t'u arritur, shumë mund të bëhet në nivelin e qeverisjes vendore. Kudo shikon rrëth globit, një lloj i decentralizimit është duke u zhvilluar apo duke u diskutuar (Kiveste, 2008). Një shumëllojshmëri përkufizimesh, analizimesh dhe marrëveshjesh mund të integrohen nën termin e vështirë dhe të papërcaktuar të decentralizimit.

Duhet gjithashtu të theksohet, se disa nga sistemet e përfshira në këtë analizë kanë ushtruar një ndikim të madh në sistemet e qeverisjes vendore të vendeve të tjera. Për shembull, Modeli “Napolitan” Francez i qeverisjes vendore u zbatua në vendeve të tjera, si Belgjika, Spanja, Italia. Modeli Britanik “Westminster” i qeverisjes vendore e cila ka qenë me ndikim në vende, si Irlanda, Kanadaja, Zelanda e Re. Ndërsa modeli Gjerman i qeverisjes vendore është zbatuar në vendet e Evropës Veriore e Qëndrore (Hesse dhe Sharpe, 1991; Loughlin dhe Seiler, 2001: 186-159). Autoritetet lokale ndryshojnë në vargun e funksioneve, madhësin e popullsisë, strukturat vendimmarrëse, kompetencat e tyre dhe sigurimin e të ardhurave. Çdo system i pushtetit lokal është i ndryshëm në formë, nga rrëthanat kombëtare dhe lokale. Analiza krahasuese duhet të pranoj nevojën për të marrë në konsideratë faktorët unike historike dhe kulturore në fusha të ndryshme, që të çojën në tradita të dallueshme politike dhe administrative. Megjithatë, pavarësisht nga dallimet në rolet ligjore dhe format, në praktikë aktivitetet e shumë autoriteteve lokale tregojnë disa karakteristika të ngashme. Sot pritshmëria e qytetarëve dhe kërkesat janë rritur, strukturat e pushtetit vendor në të gjitha vendet kanë pësuar një sërë reformash për t'i bërë ato më efikase, të përshtatshëm dhe të arritshëm për qytetarët, si dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të zonës së tyre.

Gjermania ka një sistem federal të qeverisjes, ku ligji themelor (Kushtetuta) përcakton kompetencat në nivelin federal dhe nivelin rajonal ose shtetëror (Lände). Përveç qeverisë federale dhe 16 shteteve, niveli lokal përbëhet nga 323 qarqeve (Kreis), 116 qytetet e “qarkut të lire” (kreisfreie Städte), dhe 14,199 komuna (Gemeinden). Çdo qark ndahet zakonisht në komuna, në një numër të vogël të zonave ekziston një njësi e vetme (të ashtuquajtura qytetet), i cili kombinon kompetencat e të dy niveleve dhe komunave në zonën e tyre (Gabriel dhe Eisenmann, 2005). Ligji themelor përmban vetëm disa dispozita të përgjithshme në lidhje me

nivelin lokal, dhe dispozitat më të hollësishme janë të vendosur tradisionalisht në kushtetutat shtetërore. Secili prej 16 shteteve (Länder) është përgjegjës për organizimin e pushtetit lokal në sistemin e shtetit të tyre (Bullmann, 2001: 85). Ashtu si në Shtetet e Bashkuara, kjo do të thotë se sistemi i Qeverisjes Lokale Gjerman ndryshon në një farë mase nga shteti në shtet, edhe pse nuk ka shumë ngashmëri në të gjithë vendin. Për shembull, disa dallime ekzistojnë mes shteteve të ndryshme në Gjermani në drejtim të strukturës së brendshme të vendimarrje së qeverisjes lokale. Në pjesën më të madhe të Gjermanisë, për shembull në Bavari dhe Baden-Württemberg në jug, qytetarët lokalë zgjedhin direkt një kryetar, për të vepruar si kryetar i këshillit dhe ekzekutivit. Autoritetet lokale në shumë pjesë të Gjermanisë veriore tradisionalisht kanë pasur një kryetari ceremonial i cili zgjidhet nga këshilli dhe jo nga qytetarët. Megjithatë, në vitet e fundit, tendenca në Gjermani ka qenë për të lëvizur në drejtim të modelit për të zgjedhur direkt kryetarin (Gabriel, 1971: 130, Eisenmann, 2005: 118).

Sistemi francez i qeverisë ka një model që ka frymëzuar organizimin e shtetit në një numër vendesh, duke përfshirë vende të ndryshme në Evropën Jugore, të cilat importuan disa nga tiparet e qeverisjes lokale francize në sistemin e vendit të tyre (Loughlin dhe Seiler, 2001). Niveli i qeverisjes vendore është i përbërë nga më shumë se 36.000 komuna (Loughlin dhe Seiler, 2001) këshilli bashkiak është zgjedhur çdo 6 vjet, dhe shumica në këshill zgjedh një kryetar, i cili vepron si ekzekutiv i komunës. Shumica e komunave janë të vogëla dhe të paqëndrueshme në aspektin e ofrimit të shërbimit, i cili nënkupton përdorimin më të madh të shërbimeve të përbashkëta ndërmjet autoriteteve fqinje (Borraz dhe Le Gales, 2005; Loughlin dhe Seiler, 2001). Shumica e qytetarëve kanë një lidhje të fortë natyrore në komunitetin e komunave, dhe përpjekjet për të konsoliduar nivelin komunal në struktura më të mëdha kanë qenë kryesisht të pasuksesshme.

2.2.1 Decentralizimi: Korniza Teorike

Pavarësishët nga ndryshimet, ka tendencë të jetë një marrëveshje e përbashkët se decentralizimi është një koncepti i përgjithshëm për forma të ndryshme të marrëveshjeve strukturore në qeveri dhe organizata. Si proces, decentralizimi përfshin transferimin e autoritetit dhe pushtetit, për të plannifikuar, marrë vendime dhe menaxhuar burimet, nga niveli më i lartë në nivele më të ulëta të qeverisjes, në mënyrë që të lehtësojë ofrimin efektiv të shërbimeve (Smith 1985:1). Megjithatë, format kryesore të decentralizimit politik dhe administrativ të cilat janë miratuar nga shumica e vendeve në zhvillim, janë dekoncentrimi dhe decentralizimi (Rondinelli, 1981, Maywood 1993: 3; Tordoff, 1994: 555-80).

Decentralizimi përfshin transferimin e autoritetit dhe pushtetit në njësitë e qeverisjes lokale, të cilat veprojnë në mënyrë autonome jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë administrativ dhe struktur të qeverisë qëndrore. Kjo përfshin dhënien e kompetencave të nevojshme ligjore strukturave lokale, për të kryer funksione specifike të karakterizuar nga një masë e autonomisë konstucionale (Smith 1985). Nga pikëpamja politike, decentralizimi konsiderohet si një strategji kyçë, për promovimin e qeverisjes së mirë, më pluraliste, e përgjegjshëme, transparente, për pjesëmarjen e qytetarëve dhe zhvillimin vendor (Crook 1994: 340). Në demokraci, procesi politik i lejon njërit të shprehin preferencat dhe llojin e sherbimeve që duan nga qevria qëndrore (Dollery, 2004: 8). Decentralizimi kryhet ne tre drejtime, (Wolman in Benet, 1990): decentralizimi politik, decentralizimi administrativ, decentralizimi, fiskal.

Decentralizimi politik

Decentralizimi Politik i referohet marrëveshjeve ku legjimiteti ligjor i pushtetit vendor është i njojur qoftë në mënyrë eksplikite nga kushtetuta kombëtare ose nga vendimet ligjore dhe administrative. Në shumicën e vendeve ajo përfshin sigurimin për: (a) zgjedhjet lokale; (b) një ndarje të shpenzimeve e përgjegjësive apo kompetencave midis llojeve të qeverive; (c) Nivel lokal i autoriteti të vet-tatimit (p.sh. komunale), (d) rregullat dhe rregulloret që lidhen me huamarjen vendore dhe menaxhimin e borxhit; dhe (e) një status i veçantë për qytetet kryesore (Xhoko dhe Chattopadhyay, 2009).

Decentralizimi Administrativ

Disa autorë theksojnë (Rondinelli, et.al, 1981:137, Plostajer.Z, 2001) se ka të bëjë me shpërndarjen e burimeve të autoriteteve dhe përgjegjësive, për ofrimin e shërbimeve publike përgjatë niveleve të ndryshme të qeverisjes. Ky proces transferimi përgjëgjësish ka të bëjë me funksione të ndryshme që mund të decentralizohen:

- a) Planifikim; b) Financimi; c) Menaxhimi i shërbimeve; d) Përmirësimi i shërbimit

Procesi i decentralizimit mund të përfshijë një prej tyre, kombinim të tyre ose të gjitha së bashku. Format e decentralizimit administrativ mund të janë:

1. Ndryshimi I strukturës territoriale të administritimit
2. Ndryshimi I funksioneve
3. Ndryshimi I strukturave administrative dhe praktikave drejtuese

Decentralizimi Fiskal

Ndërsa vendimi për të decentralizuar është politik, fitimet ekonomike dhe financiare rrjedhin nga një sistem i mirë-projektuar i decentralizimit - fiskal që është: klasifikimi ndërqeveritar i përgjegjësive për shpenzimet dhe financimet ndërmjet llojeve apo niveleve të ndryshme të qeverisjes, në harmoni me kornizën politike (Nina Boschman, 2009: 20)

Është thelbi i ekzistencës së qeverisjes vendore, sepse është transferimi i autoritetit dhe përgjegjësisë të funksioneve publike nga pushteti qëndror në pushtetin lokal ose në organizma të tjera vendore. Vetëm nëpërmjet decentralizimit bëhet e mundur kalimi i disa kompetencave tek pushteti vendorë, për të përbushur më mirë realizimin e tyre por dhe qeverisja është më afër qytetarëve, për të afruar shërbime cilësore. Sipas (Plostajner.Z :58), të mirat që sjell decentralizimi shpesh janë përdorur si argumente pro decentralizimit. Përkrahësit (Dollery 2004, Albau 2008) janë të mendimit se decentralizimi: ndihmon në pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje më të afërt; siguron më tepër përgjegjësi në punët dhe nevojat e qytetarëve; prezanton kundërpeshë ndaj shtetit autoritar; jep një mundësi për të provuar struktura dhe politika të reja; jep më tepër efikasitet në dhënen e shërbimeve ndaj qytetarëve në krahasim me qeverisjen qëndrore; krijon një sens komuniteti në organizimin dhe orientimin social, ekonomik dhe politik të komuniteteve, sipas nevojave që ata mendojnë se janë të domosdoshme për jetën e tyre; bashkon shoqërinë qytetare me qëndrën e shtetit sidomos për komunitetet minoritare.

Ka dy dimensione të decentralizimit të sistemit të menaxhimit publik: ai ekonomik dhe ai politik. Dimensionet standarte ekonomike të hartimit të një politike publike financiare janë stabiliteti mikroekonomik, barazia dhe eficenza. Për sa kohë që preferencat

individuale në lidhje me shërbimet ndryshojnë në një sistem të decentralizuar fiskal, individët zgjedhin të jetojnë në komunitetin që reflekton preferencat e tyre dhe maksimizon mirëqenien sociale. Aspekti i eficencës ka të bëjë kryesisht me faktin që, meqënëse pushteti lokal është më afër qytetarëve, është më në gjendje të kuptoj pikëpamjet dhe preferencat e tyre dhe si rrjedhim bënë një shpërndarje më të mirë të burimeve se sa pushteti qëndror. Sipas (Stigler 1957) një qeverisje sa më afër qytetarëve të jetë, aq më mirë e kryen punën e vetë. Musgave (1959) bën një ndarje të funksioneve të qeverisjes: stabiliteti ekonomik, rishpërndarja e të ardhurave dhe alokimi i burimeve. Në të njëjtin drejtim me Musgave dhe Stigler, më vonë Oates (1972) e përkufizonte decentralizimin “çdo shërbim publik duhet të sigurohet nga autoriteti i cili ka kontrollin mbi përfitimet dhe kostot e këtij shërbimi, në një zonë gjeografike”.

2.2.2 Tre D- Dekoncentrimi, Delegimi dhe Decentralizimi

Hussein (2004) koncepte të tillë si delegimi, devolucioni, dekoncentrimi dhe transferimi i kompetencave janë të lidhur me decentralizimin (shih Barle dhe UYS 2002: 143; Rondinelli 1981: 137).

Dekoncentrim

Dekoncentrimi përfshin transferimin e ngarkesës së punës ose vendim-marrjes, autoritetin dhe përgjegjësinë nga zyrtarët e nivelit të lartë në nivele më të ulëta, brënda fushës së qeverisë qëndrore apo agjencive publike (Sharma 1995: 26). Dekoncentrimit i janë referuar disa herë si decentralizim administrativ. Ai tregon një proces ku zyrat rajonale të ministritive qëndrore janë vendosur në juridiksionet lokale, me qëllim të marrin vendim mbi nivelin dhe përbërjen e

mallrave dhe shërbimeve që do të ofrojë qeverisja lokale (Keith, L. Miller, 2002: 4). Dekoncentrimi i autoritet do të thotë, se degët rajonale të ministrive kanë disa aftësi për të marrë vendime të pavarura, megjithëse zakonisht brenda udhëzimeve qëndrore. Dekoncentrimi pa autoritet ndodh kur zyrat rajonale janë krijuar pa asnje autoritet të pavarur vendimmarrës. Në të dy rastet, zyrat e financave të qeverisjeve locale të dekoncentruara ofrojnë shërbime (të tillë si arsimi, shërbimet shëndetësore, ujë, apo transport), banorët lokalë ka të ngjarë të mos jenë të përfshirë në vendimarrjen për fushëveprimin ose cilësinë e shërbimeve dhe mënyrën në të cilën ata janë siguruar.

Decentralizimi

Decentralizimi (Transferimi) është ekstremi tjetër i linjës "tre-D". Në decentralizim, njësitë e vetëqeverisjes vendore të pavarura krijohen me përgjegjësi për ofrimin e një sërë shërbimeve publike dhe autoritetin për të imponuar taksat dhe tarifat për të financuar ato. Qeveritë e decentralizuara kanë fleksibilitet të konsiderueshëm, për të zgjedhur miksin dhe nivelin e shërbimeve dhe në disa raste autoritetet, që do të gjenerojnë të ardhurat e tyre. Me decentralizim, qytetarët kanë aftësinë për të përdorur qeverinë e tyre lokale për të shprehur preferencat e tyre në lidhje me miksin dhe nivelin e shërbimeve publike që ata duan (kërkesa), duke marrë parasysh koston e tyre (furnizim). Rezultati që devoluimi ofron për marrjen e vendimeve lokale është shfrytësimi "më i mirë" (më efikas) i burimeve të kufizuara krahasuar me rastin kur vendimet për politikat e taksave dhe shpenzimeve lokale merren në një qëndër larg qytetarëve.

Delegim

Varianti i tretë, delegimi, mendohet shpesh si një marrëveshje e ndërmjetme midis decentralizimit dhe dekoncentrimit. Ajo mund të karakterizohet si një marrëdhënie drejtues-ajgent midis një qeverie të nivelit më të lartë (kryesor) që cakton një pushtet lokal (ajgent) me përgjegjësinë për kryerjen e funksioneve të caktuara vendore (p.sh., arsimi, shpërndarja e ujit, klinikat shëndetësore), të cilat të financohen apo jo nga transfertat e drejtuesit për ajgentin.

2.2.3 Të decentralizohemi apo jo?

Tre hapa ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes se pse disa shtete kanë tendencë të mbeten të kontrolluara nga qëndra, politikisht dhe në aspektin fiskal, ndërsa të tjerët të kanë ecur përpala me decentralizimin.

Hapi i parë është që të shihen arsyet pse kaq shumë vende vazhdojnë të mbajnë sektorin publik të centralizuar. I dyti është që të shqyrtohen argumentet teorike dhe praktike konvencionalë në mbështetje të decentralizimit dhe të shqyrtohet së si teoria e financave publike e trajton pyetjen. Hapi i tretë është shqyrtimi i ndikimit të decentralizimit, provat empirike.

Pse pro centralizimit?

Raporti i Zhvillimit 1999/2000 i Bankës Botërore (Banka Botërore, 2000) vuri re se, shumë vende në zhvillim janë ende të centralizuar, pavarësisht trendit të identifikuar drejt lokalizimit. Tre argumente ofrohen në mbështetje të centralizimit: Mungesa e kapaciteteve lokale, mungesa e sigurisë që funksionet qeveritare po përbushen dhe trashgimia institucionale.

Një argument është se, në vendet në zhvillim qeveritë lokale nuk kanë kapacitet për vetëqeverisje. Ky argument dëgjohet më shpesh kur diskutimi bëhet për dhënien tek qeverisja lokale përgjegjësi të tilla si: gjenerimi i të ardhurave të tyre ose autoriteti për të marrë hua. Në një vend me një traditë të gjatë të centralizimit, mungesa e kapacitetit të qeverive lokale për vetë-qeverisje është një konstatim që ka të ngjarë të jetë e vërtetë. Qeveritë lokale në disa vende të apo decentralizuara kanë demonstruar, se zhvillimi i kapaciteteve për të qeverisur është një proces i të mësuarit duke vepruar (Thomas 2006, Sen 1999). Kështu, për shembull, në fillim të viteve 1990 nën kryebashkiaku Gabor Demszky, i komunës Budapest morri hua në tregun e eurobonove, jo për shkak se nuk mund të merrte hua nga burimet hungareze, por më tepër për të demonstruar se qyteti ishte mjaft i besueshëm për ta bërë këtë. Siç shkruan Demszky, në vitin 1991 "Shteti i trishtuar i Budapestit ishte një pasqyrim i vërtetë i dyzet viteve të diktaturës", dhe në këtë mënyrë, qytetarët e saj "Zgjodhën të ndjekin një tjetër rrugë" (Demszky, 2003).

Këtu është e rëndësishme të theksohen dy mësime në lidhje me aftësinë e një vendi për të qenë të decentralizuar. Së pari, "Decentralizimi i pushtetit qendror" nuk ka lidhje me çmontimin e tij. Decentralizimi i suksesshëm ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve të qendrës për kalimin drejt një strukturen ndërqeveritare (Kopanyi et al 2000; Pallai 2003). Së dyti, reforma e suksesshme e sektorit publik kërkon shumë më tepër se fokusi në kapacitetet individuale; ajo gjithashtu kërkon lidhjen e kapaciteteve organizative, institucionale, dhe individuale për zhvillimin e rezultateve të synuara (Thomas, 2006).

Mungesa e sigurisë që funksionet qeveritare po përbushen, është argumenti i dytë në mbështetje të centralizimit. Sipas këtij argumenti, në një sistem unitari apo federal, qeveria qëndrore mund të shpallë përparësinë e saj ndaj qeverisjes lokale për shkak se

prioritetet e qeverisë qëndrore janë të parat. Një argument i tillë kundër decentralizimit të gjerë është veçanërisht i zakonshëm në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që tentojnë të mos jenë ekonomikisht të larmishme dhe që për këtë arsy, janë më të ekspozuar ndaj luhatjeve në çmimet e mallrave ndërkombëtare, fatkeqësive natyrore dhe të barrës së kostove të borxhit. Rezultati është se qeveria qëndrore mban kontrollin e instrumenteve kryesore të taksave dhe të huamarrjes (Tosun dhe Jilmaz 2010).

Argumenti i fundit për përqendrimin e pushtetit politik dhe fiskal në qendër është: trashgimia - vazhdimësia e metodave tradicionale (mënyrat e vjetra janë mënyra më të mira.). Ky shihet sidomos nëpër pjesën më të madhe të kontinentit Afrikan, ku dekada e kolonializmit çoi në një rrënjosje të thellë të traditës së autoritetit nga lart-poshtë (Ndegëa 2002; Commins dhe Ebel 2010). Pavarësisht nga një traditë e vetëqeverisjes lokale në shumë vende të Evropës, qeverisja e komandës dhe kontrollit ende karakterizon shumë ish-republikat sovjetike, veçanërisht ato të Azisë Qëndrore. Në Lindjen e Mesme, kontrolli autoritar është ruajtur nga një sistem afatgjatë i oligarkisë politike, duke rezultuar në atë që Tosun e etiketon "centralizim të tepruar".

2.2.4 Pse të decentralizohemi?

Fakti që pjesa më e madhe e botës është duke kaluar nëpër një formë të decentralizimit dëshmon për rëndësinë e një zhvillimi të tillë. Të paktën katër faktorë ndihmojnë të shpjegohet tendenca drejt decentralizimit:

Së pari, globalizimi. Konkluzioni i Raportit Botëror të Zhvillimit 1999-2000 ishte së tendencat e hershme të shekullit të 21 drejt globalizimit dhe lokalizimin po përforcohen. Ai përfshin modelimin e "ndarjes" që përballet me një "kërkesë nga rajonet e rrethinave për autonomi vendore, e cila rritet me rritjen e të ardhurave kombëtare, popullsinë më të madhe në zonat e thella relative dhe rritjen e popullsisë kombëtare" (Arzaghi dhe Henderson 2005), si dhe rastet e studimit për një rritje të organizatave të qytetarëve që "nuk mbështeten më në instrumentat nga lart – poshtë [për të përmirësuar qeverisjen (McNeil dhe Malena 2010). Përvec tendencave, edhe ciklet zbatohen në të gjitha shtetet pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të tyre ekonomik (Bird, 2011b). Kështu, një periudhë e reformës ndërqeveritar mund të pasohet nga një rezistencë politike nga autoritetet qëndrore të reformave. Prapësimë të tillë ka të ngjarë të ndodhin më shpejt dhe thellë në shtetet unitare sesa në shtetet federale. Kështu, raporti i 2011 i Qeverive Qëndrore dhe Lokale të Bashkuara (UCLG) mbi qeverisjen lokale në Afrikë konkludon së "decentralizimi fiskal po vuan nga situata e vështirë financiare në shumicën e vendeve afrikane sot" dhe së "edhe pse gjenerimi i të ardhurave nga vendet afrikane është përmirësuar gradualisht që prej fillimit të viteve 2000, pas katër dekadash stanjacioni, e ardhmja nuk është e ndritshme "(Yatta dhe Vaillancourt, 2010). Një paralajmërim i ngjashëm bëhet në lidhje me disa veprime të fundit decentralizuese të Evropës për shkak të "befasisë dhe peshës" të krizës fiskale që ka ndërprerë një periudhë të zgjatur rritje të qëndrueshme në burimet buxhetore të qeverisjes lokale (Regulski, 2010).

Së dyti, shkaktari kryesor për decentralizim është politika dhe "reagimi nga poshtë." Shpjegimi i dytë pohon se edhe pse vendimi për të decentralizuar është politik, pas marrjes së këtij vendimi janë reformat ekonomike dhe fiskale që çojnë në një ndryshim

në marrëveshjet fiskale ndërqeveritare. Duke u ndalur në Afrikë, Amerikën Latine, dhe Euroazinë paskomuniste, Kalandadze dhe Orenstein (2009) përmendin 17 raste, jo të gjithë të suksesshëm, të revolucioneve të buta elektorale "nga poshtë", që nga viti 1991.

Së treti, për ekonomist, argumenti kryesor për decentralizim ka të bëjë përmirësimë në efikasitetin ekonomik. Për shkak, (1) të preferencave të ndryshme për nivelin dhe miksin e të mirave dhe shërbimeve publike vendore, (2) dallimet në kostot lokale të prodhimit dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve. Mirëqenia e përgjithshëme e gjithë shoqërisë do të rritet, nëse vendimet për të cilën miksi i të mirave dhe shërbimeve që duhet ofruar në lokalitet, bëhet në nivel lokal krahasuar me rastin kur bëhet nga një zyrtar qëndror. Nga sa thamë më lartë për përkufizimin e decentralizimit rrjedhin përfitime potenciale nga decentralizimi fiskal, përsa i përket efiçencës këto përfitime janë të lidhura me manaxhimin dhe alokimin:

1. Alokimi efiçent i burimeve, deçentralizimi rrit efiçencën sepse qeverit lokale kanë lidhje më të afërtë me komunitetin dhe nevojat e tyre. Vendimet e marra nga qevrisja lokale që është më afër tyre për shpenzimet publike, si dhe më e përgjegjëshme reflekton zgjedhjet e qytetarëve dhe nevojat e tyre më shumë sesa vendimet e marra nga qeveria qëndrore.
2. Konkurenca ndërmjet Qeverive Lokale, nëse të mirat publike do të financohen nga taksat lokale, qytetarët do të mundohen të drejtohen për të banuar në komunat ose qytetet që i plotësojnë më mirë nevojat e tyre, pra ata kuptojnë se taksat që paguajnë përdoren për shërbime publike. Kështu vetveti decentralizimi fiskal rrit konkurrencën midis njësive lokale për perdonimin me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të burimeve të tyre.

Organizimi dhe zhvillimi i qeverisjes vendore si një institucion, që merr përsipër përgjegjësin e realizimit të shërbimeve publike, do të thotë së drejtpërdrejt është marrë parasysh fakti i decentralizimit financiar dhe garantimi i qëndrueshmërisë financiare të njësive vendore në përputhje me Kartën Europiane të Vet-qeverisjes Vendore Neni 9 (Ananieva.N),

3. Barazia në shpërndarjen e të ardhurave, një nga problemet e politikave në finansat publike është përdorimi dhe rishpërndarja e tyre në mënyrë të barabartë pa krijuar diferencime të cilat çojnë në difercime sociale, në diferencime rajonale në zhvillim. Nivel të njëjtë shërbimesh. Ka dy faktorë kryesorë që ndikojnë në barazinë horizontale: baza e taksës e cila mund të ndryshojë në mënyrë të ndjeshëm nga rajoni në rajon, karakteristikat rajonale të cilat ndikojnë në koston e afritit të shërbimeve publike nga ana e qeverive lokale. Politikat e rishpërndarjes, në kuadër të barazisë horizontale, hartohen të tilla që tu sigurojnë më shumë burime zonave më të varfëra. Një politikë rishpërndarje e suksesheme duhet që t'i kushtojë rëndësi edhe barazisë brenda lokaliteteve.

2.2.5 Decentralizimi: Përvoja e reformimit të pushtetit lokal

Reformimi i pushtetit lokal, ka qenë një problem i të gjitha vendeve Evropiane gjatë shekullit të kaluar, të cilat bënë një reduktim drastik të numrit të njësive vendore. Por kush ishte shkaku i këtij transformimi: *së pari*, rritja e eficences së shërbimeve të pushteteve lokale, për të patur shërbime më cilësore dhe në kohën e duhur në bazë të nevojave të komuniteteve përkatëse; *së dyti*, ndryshimi i kushteve ekonomike e shoqërore

në këto vende. Vetë zhvillimi industrial solli natyrshëm përqëndrimin e popullsisë në zonat urbane. Zhvillimi i infrastrukturës bëri të mundur që të reduktohet koha e realizimit të ofrimit të shërbimeve me cilësi. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit bëri të mundur qeverisjen E-gouvernement, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen e komuniteteve përkatëse. Vendet Europiane përdorën rrugë të ndryshme, për shkak të natyrës së karakteristikave kombëtare të popullsive dhe të trashëgimisë së organizimit të pushtetit lokal. Atje ku ndjenja traditës ishte më e fort, si në rastin e Gjermanisë dhe të Francës u përdor rruga e bashkimeve vullnetare dhe shoqërizimeve. Ndërsa në vendet Nordike u përdor rruga e bashkimit të detyruar, por jo në një periudhë të vetme, vetëm Suedia e ka bërë këtë proces transformues në katër etapa gjatë shekullit të kaluar, duke e përshtatur ndërtimin e pushtetit vendor me ndryshimin e kushteve ekonomike. Në përgjithësi vendet e Europës perëndimore kanë një ekonomi të bazuar të industria dhe një bujqësi të modernizuar të cilat kanë patur një ndikim pozitiv në transformimin e pushtetit lokal.

Qëllimi i reformimit të pushtetit vendor, është rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, e cila arrihet nëpërmjet dy rrugëve: *së pari* nëpërmjet rritjes së eficencës së shërbimeve duke zvogëluar shpërdorimin e fondeve nga administrata, *së dyti politike* duke bërë reformimin administrativë-territorial, i cili vetveti redukton shërbimet e dubluara por dhe shkurton shpenzimet administrative duke reduktuar numrin e tyre nga bashkimi në një njësi sipas rastit (Dollery 2001). Vendet e Europës Lindore mbas rënies së sistemit komunist u përfshin të gjitha në organizimin e pushtetit vendor sipas legislacioneve përkatëse kombëtare. Ato u meështetën tek parimet e “Kartës Europiane të Vetqeverisjes

Vendore, për t'i dhënë pushtetit vendor autonomin⁴ e nevojshme, për të kryer funksionin e vet sipas koncepteve perëndimore. Reforma administrative territoriale (Ananieva, N:40) duhet të synojë:

- Rikonstruktmin dhe zhvillimin territorial, funksional dhe organizimin institucional të qeverisjes vendore, si dhe zhvillimin e lidhjeve më efektive me institucionet dhe organet e pushtetit qëndror.
- Ekzekutimin dhe zhvillimin e procedurave demokratike dhe mekanizmave të organizimit dhe funksionimit të vetqeverisjes vendore.
- Mbrojtjen e sigurisë dhe interesave kombëtare
- Integrimin e strukturave rajonale dhe vendore me strukturat europiane.

Rruja që ndoqën vendet ish komuniste janë një eksperiencë e mirë për tu patur parasysh nga qeveria Shqipëtare për reformimin e pushtetit lokal. Më tipike që përafrohen, për nga siperfaqa dhe popullsia me Shqiperinë, është rasti i Republikave të Moldavise dhe i Letonisë, për nga rruga e ndjekur dhe shtrirja në kohë e këtij procesi. Në ndarjen administrative (Ananieva, N: 42) janë zbatuar këto kritere:

- Veçori fizike dhe gjeografike të territorit
- Prania e një qyteti, që ka qenë historikisht qendër kulturore dhe qendër e zhvillimit social, infrastrukturor dhe njëkohësisht që jepte mundësine e komunikimeve të domosdoshme ndërmjet të gjitha vendbanimeve të territorit.
- Traditat e përbashkëta të jetesës së banorëve të vendbanimeve të ndryshme të territorit.

⁴ Karta Europiane e Autonomise Vendore.

- Së fundmi, në disa vende, decentralizimi ka qenë një strategji për të promovuar kohezionin kombëtar dhe për të lehtësuar tensionet në qoftë së shoqëria është e fragmentuar sipas përkatësisë etnike, fesë, moshës, burimeve natyrore, apo kushteve të tjera. Janë dokumentuar disa raste në të cilat përdorimi praktik i një kombi-shtet i parimit të subsidiaritetit ka çuar në kohezion më të madh kombëtar dhe ka ndihmuar në uljen e tendencave të çmimeve në një rajon të veçantë. Rastet historike përfshijnë ato në Belgjikë, Kanada, Indi, Indonezi, Gjermani, Federatën ruse, Spanjë, Sudan, dhe Zvicër.

2.2.6 Efiçenca në lidhje me rritjen e numrit të popullsisë

Politikëbërësit në përgjithësi besojnë se komunat më të mëdha shfaqin efikasitet më të madh. Ekziston një literaturë e bollëshme për madhësinë e komunës dhe efiçencës së ofrimit të shërbimeve lokale. Besimi se njësitë me madhësi më të madhe do të jenë më efikase, ka motivuar shumë studjues dhe më tej, përpjekjet për konsolidimin e mendimit për kurimin e joefikasitetit. Literatura ofron mbështetje të vogël për madhësinë e njësive dhe marrëdhënieve me efiçencën, dhe për këtë arsy, pak prova konkrete, përveçse e garantuar mbi një bazë rast pas rasti të reformave në vende të ndryshme. Gabler 1971, Katsuyama 2003, Mabuchi 2001, Byrnes & Dollery 2002, diskutojnë për kufijtë e një madhësie të njësive vendore në limite të tillë (figura 7.1 tek shtojca):

- Ka pak korrelacion të përgjithshme në mes të madhësisë dhe efiçencës, te komunat me popullsi ndërmjet 25,000 dhe 250,000.

- Literatura sugjeron se komunat më të vogla (popullsia nën 25.000) janë më pak efikase.
- Rritja e madhësisë është e lidhur me rritjen e eficencës në shërbimet e investimeve kapitale të tilla si sistemet e shërbimeve ose punëve publike.
- Për shërbimet e specializuara, të tilla si puna e policisë, një rritje në madhësi sjell rënienë e eficencë - njësit më të vogla janë më të efektshme se sa janë njësitë më të mëdha.
- Literatura sugjeron se kostoja për banor nuk mund të jetë një matëse e mirë e eficencës ose të performancës për shkak të efektit të devijues të faktorëve të tjera.
- Ekziston një marrëdhënie në kurbën formë U, midis madhësisë dhe eficencës në një nivel të përgjithshëm. Eficiencia rritet me madhësinë e popullsisë deri në rrëth 25.000 banorë, në të cilën ajo pikë është e qëndrueshme deri në rrëth 250.000 banorë, dhe rënien pas kësaj. Në thelb, kurba thekson se komunat e vogla janë më pak eficiente se komunat më të mëdha

A ka një madhësi optimale, ose varg të madhësive të një njësie të qeverisjes vendore nga pikëpamja e efikasitetit? A ka diseconomi të shkallës, lidhur me bashkitë më të mëdha që kërkojnë në mënyrë proporcionale më shumë administrata?

Gjetjet në literaturë nuk janë në përputhje aq të fortë, në lidhje me marrëdhënen, në mes të dendësisë së popullsisë dhe eficencës, pa vlerësuar dhe renditur efektin e karakteristikave demografike të popullsisë (pasuria, varfëria, gjendja social-kulturore, kërkesa për shërbime). Literatura në përgjithësi nuk sugjeronë karakteristikat e popullsisë si përcaktues të efikasitetit të komunës, për të shpjeguar efektet e dobëta të madhësisë në eficencë ka pasur disa prova, se pasuria është një faktor për shkak të kërkesave në rritje për cilësinë e shërbimit. Gjetjet tregojnë që popullatat shumë të moshuara dhe shumë të reja, kërkojnë shpenzime më të vogla për banorë dhe që popullsitet më të privuara ekonomikisht kërkojnë kosto më të lartë.

Kostoja për fryshtës së tregues i përgjithshëm i eficencës së njësive vendore. Me fjalë të tjera, kurba formë –U, sugjeron se në qeveritë më të vogla, kostot janë më të mëdha për atrimin e shërbimeve. Kjo deklaratë është një pikënisje: ‘E konsensusit në mesin e studiuesve, se gati 80 për qind e shërbimeve dhe aktiviteteve komunale kanë ekonomi shkalle, për një popullsi prej mbi 20.000 banorë. "(Katsuyama, 2003), (Gabler, 1960 përdor pragu e 25.000 banor). Rezultatet e këtij studimi sugjerojnë, se qytetet e mëdha kanë tendencë për të punësuar dhe shpenzuar më shumë për banorë, se qytetet e vogla"(Gabler, 1971). Një studim i furnizimit me ujë në Indi zonë rurale (Banka Botërore, 2008a) siguron më shumë dëshmi, se kurba U-formë vërtetohet për 1000-1500 familje (por në këtë rast, ajo është aplikuar për ekonomitë familjare). Reformat e pasluftës në Japoni treguan edhe funksionimin e U-formë, por me nivele disi më të ndryshme të popullsisë, duke treguar se 115,109 persona ishte kufiri i popullsië së një njësie vendore eficiente (Mabuchi, 2001).

Disa studime tregojnë se, ka pak ose aspak marrëdhëni në mes të madhësisë dhe efikasitetit. Në një studim në qarqet që ofrojnë shërbime lokale në Iowa (Koven dhe Hadwiger, 1992), autorët e shohin se nuk ka prova për "Më e madhe, është më e mirë". Njësia e madhe nuk është superiore në shumë aspekte të shpenzimeve përfrymë, ato tejkalojnë shpenzimet e katër nga pesë njësi të vogla të marra në studim. Taksat përfrymë, në mënyrë të ngjashme janë më të larta në shërbimet e njësive më të mëdha, me përjashtim të spitaleve, autostradat, dhe shpenzimeve kapitale. Faktorë të tillë si cilësia e shërbimeve, plogëtia organizative, si dhe gatishmëria e banorëve për të paguar për shërbime, duhet të merren parasysh në mënyrë që të nxjerrim konkluzione definitive, në lidhje me avantazhet e planeve përiorganizimin strukturor. .

Australia miratoi shumë bashkime të njësive vendore, në bazë të parimit të përgjithshëm, që komunat më të mëdha do të shfaqin efikasitet më të mëdha ekonomik. Byrnes dhe Dollery (2002)

rishikuan literaturën për të përcaktuar nëse, ekziston një bazë empirike për këto pikëpamje. Përfundimi i tyre ishte: "Mungesa e provave rigorozë të rëndësishme e ekonomive të shkallës në ofrimin e shërbimeve komunale, hedh dyshime të konsiderueshme në përdorimin e kësaj si bazë për bashkime "

Një studim i hershëm, gjen pak mbështetje për marrëdhëniet në mes të madhësisë dhe efikasitet, në mesin e komunave më të vogla (Bodkin dhe Conklin, 1971). Studjuesit sugjerojnë se komunat mjaft të vogla, madje edhe ato me popullsi në rangun e 5,000 deri në 10.000 persona, mund të sigurojën mbrojtjen nga zjarri, sigurinë, kanalizime, heqjen e mbeturinave, ruajtjen e shëndetit, shërbime lokale me çmim më të ulët, se komunat e mëdha. Boyne, (2003) paraqet një shqyrtim empirik në studimet e performancës së shërbimit publik. Ai thekson: "Pak argumenta janë gjetur te marrëdhëniet në mes të madhësisë së organizatës dhe performancës së shërbimit". Në përgjithësi, variablat menaxheriale kanë një ndikim të rëndësishme në performancë (Mera, 1973). Provat mbështesin supozimin që pasuria apo burimet (matur në aspektin e të ardhurave mesatare të familjes) janë shumë më të rëndësishëm se madhësia e popullsisë ose dëndësia, në shpjegimin e variacioneve të shpenzimeve totale për frysë mes njësive lokale. Studimi, "Copëzimi dhe Zgjerimi: Dëshmi nga analiza rajonal" (Carruthers dhe Ulfarrson, 2002), që u përqëndrua në marrëdhëniet në mes fragmentimit dhe bashkimit, vë në dukje efektet në shpenzimet publike, "Copëzimi është i lidhur me dendësi më të ulëta dhe vlera më të larta të pronës, por nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shërbimit publik".

2.2.7 Vlerësimi i performancës në Qeverisjen Vendore

Pavarësisht kërkesës ligjore për qeveritë lokale për të shfrytëzuar sistemet e matjes së performancës, një pjesë e konsiderueshme e hulumtimit që lidhet me matjen e performancës në

qeveritë lokale është zgjeruar që nga mesi vitit 1990 (Ammons 1995a; zvicerane 1995; Foltin 1999; Kopczynski dhe Lombardo 1999). Metodat e matjes së performancës, janë disi të përziera. Matja e performancës nuk është një koncept i ri, por një koncept i rinovuar në kontekstin aktual të manaxhimit publik (Poister 2003).

Poister dhe Streib (1999) tregojnë se vetëm 38 për qind e qyteteve të anketuara, përdorin sistemet e matjes së performancës. Gasb dhe Akademisa Kombëtare e Administratës Publike (SHBA)(1997) argumentojnë se norma e përdorimit mund të ketë qenë e mbivlerësuar në disa anketime, për shkak të përfshirjes vetëm të njësive të mëdha. Për më tepër, mënyrat e përdorura kanë tendencë të jenë të një niveli të ulët dhe masin vetëm ngarkesën e punës dhe jo të gjithë aktivitetin, matjen nuk e bëjnë në mënyrë kuptimplotë lidhur me procesin e vendimmarrjes, si dhe nuk raportojnë për palët e jashtme (Poister dhe Streib 1999; Kopczynski dhe Lombardo 1999). Për më shumë, sot matja e performancës, ose krahasimi i performancës midis qeverive lokale, të njojur si "matja e performances krahasuese", është koncept relativisht i ri. Arsyet kryesore për mënyrën e pr dorimit të performancës krahasuese si metodë, janë për të gjetur praktikat më të mira të qeverisjes lokale, duke krahasuar qeverit lokale dhe identifikuar teknikat e manaxhimit ose strategjitet e ofrimit të shërbimeve që sjellin rezultatet më të mira (Ammons 1996). Një nga përpjekjet më të hershme për përdorimin e "performancës krahasuese" si metod matje midis qeverive lokale, ishte Këshilli Rajonal i Qeverisë Denver në vitin 1978. Në atë kohë, Qëndra Kombëtare për produktivitetin dhe cilësinë e jetës dhe punës, krahasojë dhe ekzaminojë performancën e shërbimeve publike të qeverisjes vendore brënda zonës metropolitan Denver, të tilla si shërbimi policor, shërbimet e zjarrfikësve, shërbimeve të parandalimit të krimtit dhe menaxhimit të shërbimeve të përgjithshme. Qëllimi i këtij studimi ishte të dinin, se si menaxherët dhe administratorët kanë perceptuar dhe zbuluar faktorët

kryesorë, në përdorimin me produktivitet të shërbimeve të dhëna nga qeverit lokale (Kopczynski dhe Lombardo 1999). Ne vitet 1980 ishin disi pasiv në fushën e përdorimit si metod matje “performancën krahasuese”, por në vitet 1990 interes i angazhimi për matjen e performancës krahasuese u ringjall.

2.2.8 Vlerësimi i performancës dhe qasjet e saj

Në një përkufizimi të thjeshtë "performance" është "mënyra në të cilën dikush vë në funksion diçka. "Ky kuptim i termit duket se ka dalë gjatë Revolucioni industrial, ku ajo ishte e lidhur fillimisht me aftësitë dhe funksionimin e pajisjeve mekanike" (Oxford Angli 1989:544). Por në kontekstin e operacioneve të qeverisë, performance është përcaktuar si veprimitari e agjencive të shërbime publike, programe të kërkesave të komunitetit dhe si aftësi e komunitetit për të paguar (Epstein 1988). Matja e performancës thjesht do të thotë metoda për matjen e performancës së aktiviteteve, programeve ose shërbime që qeveritë jepin. Por matja e performancës përmban një numër të definicioneve (Greiner 1996). Matja e performancës në sektorin publik është vlerësimi i performancës së problemeve në organizata, njësive organizative dhe programeve (Poister 2003). Nyhan dhe Martin (1999b: 348) e përcaktojnë atë, si "mbledhjen dhe raportimin e rregullt të informacionit në lidhje me efikasitetin dhe cilësinë e programeve qeveritare. Më në përgjithësi, matja e performancës në sektorin publik, është përcaktuar shpesh si një vlerësim sistematik dhe i vazhdueshëm i shërbimeve publike, që agjencitë sigurojnë (Epstein, 1988, Holzer dhe Halachimi 1996; Ammons 1996; Hatry 1999). Edhe pse ka disa qasje për matjen e performancës të tillë, si eficiencë, efikasitet operativ, produktivitet, cilësi shërbimi, kënaqësi konsumatori ose kosto-eficencë (Hatry 2001; Poister 2003), një qasje e përbashkët bazohet në një model “proçes-orientues” i cili e sheh punën, si një input, proces, prodhim, rezultat. Matja e

performancës mund të kategorizohet në input, output, eficencë, dhe e efektivitet (Ammons 1995b; Swiss 1995; Foltin 1999). Për shembull, matjet që japid sasinë e burimeve të përdorura në ofrimin e shërbimeve publike; matjen e prodhimit që tregojnë sasinë e punës së kryer; matjen e eficencës do të thotë lidhje midis hyrjeve dhe daljeve; dhe matja e efektivitetit ka të bëj me rezultatet e synuara ose efektet e shërbimeve të ofruara (Greiner 1996). Matja e eficencës është shpjeguar si rapport i rezultateve të inputeve; ndërsa matja e efektivitetit është përshkruar si krahasim i rezultateve me pritjet dhe standartet përkatëse (Collahan 2004; Berman 2006). Megjithatë, për shkak të vështirësive në identifikimin dhe matjen e rezultateve për shumë shërbime tipike publike (Kloot 1999; de Brujin 2002), shumica e studiuesve sot priren të përdorin matjen e eficencës në vend të efektivitetit (Mayne dhe Zapico-Goni 1997). Ky studim përdor konceptin e eficencës, si metodë për matjen e performancës së qeverisë lokale në ofrimin e shërbimeve publike për arsyet e mëposhtme: së pari, matja e eficencës është e thjeshtë dhe e qartë për t'u kuptuar, sepse është e bazuara në marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis hyrjeve dhe daljeve. Në të kundërt matja e efektivitetit, nuk do të përshtatet në një model të thjeshtë input-output, si dhe në rezultate të drejtpërdrejta, sepse procesi me të cilin inputet janë konvertuar në pasojave nuk është i qartë dhe i drejtpërdrejtë (Worthington dhe Dollery 2000); së dyti, matja e eficencës mund të perceptohet më lehtë në organizatat publike për shkak, se organizatat publike kanë më shumë kontroll mbi inputet që çojnë në rezultate të drejtpërdrejta dhe në këtë mënyrë mund të ndikojnë në eficencë më shumë, se në efektivitetin e tyre; së fundi, nga një perspektivë praktike, ajo është zakonisht më e lehtë për të matur (eficencia) se efektiviteti (Pollanen 2005). Efektiviteti është shumë i vështirë për tu matur sepse ai (psh, rezultati i shërbimeve) ndonjëherë është i paprekshëm dhe kërkon analizë të ndikimit social.

2.2.9 Arsyet për ndërtimin e një njësie të madhe vendore

Autorë nga të gjitha vendet e botës (Gabler 1971, Katsuyama 2003, Mabuchi 2001, Byrnes & Dollery 2002) japid arsyen për madhësin e një njësie vendore, e cila çonë në rritjen e eficencës në shërbimet vendore. Nuk është e drejt të themi, që ka një madhësi optimale të njësive vendore, sepse diferenca në aktivitetet e bashkive nuk përputhet me hapësirën e shtrirjes optimale të tyre (Sankton, 2000, p. 74). Reforma duhet të synojë (Dollery1997:p.10):

1. Ristrukturimin dhe zhvillimin territorial, funksional dhe organizimin institucional të qeverisjes vendore, si dhe zhvillimin e lidhjeve më efektive me institucionet.
2. Ekzekutimin dhe zhvillimin e procedurave demokratike dhe mekanizmave të organizimit dhe funksionimit të vetqeverisjes vendore.
3. Mbrojtjen e sigurisë dhe interesave kombëtare, aq më tepër sot pas situatës në Krime vendet që kanë konflikte me minoritetet duhet të jenë më të kujdesëshëm.
4. Integrimin e strukturave rajonale dhe vendore me strukturat analoge europiane, sidomos për rajonet që janë të pazhvilluara në Shqipëri, për të ulur pabarazine për të përfituar nga fondi i zhvillimit rajonal europian.

Madhësia e një njësie vendore ka qenë objekt i diskutimit të autorëve të shumtë, në vendet e Europës perëndimore pas viteve 50-të, por dhe i autorëve nga vendet e Europes Lindore pas viteve 90-të. Pas viteve 90-të pothuajse të gjitha vendet e Europes Lindore u përfshinë në riorganizimin e pushtetit vendor sipas parimeve demokratike duke patur si orientim “Kartën Europiane të Autonomise vendore”.

Byrnes dhe Dollery, (2002: 74) arritën në përfundimin se, në përgjithësi 39 % e studjuesve gjetën prova të efektit të kurbës në formë –U, 29 % nuk gjetën asnjë lidhje statistikore ndërmjet

uljes së shpenzimeve për fryshtat e madhësisë së njësisë vendore, 24% gjetën ekonominë e shkalles, 8% gjeten disekonomin e shkallës. Më poshtë kemi katër arsyesh që favor të njësive të mëdha (Dollery 2004, Janno Reiljan, Aivo Ulper, 2010: 7, Gabler 1971, Mabuchi 2001, Byrnes & Dollery 2003):

1. Njësitë e mëdha vendore janë në koncepte ekonomike më eficent.

Ka dy rrugë për të rritur eficencën në një njësi vendore: *së pari*, rruga ekonomike, është ulja e shpenzimeve operative të administratës vendore, nëpërmjet përdorimit efektiv të fondeve, por dhe nëpërmjet uljes së shpenzimeve të panevojshme të bëra nga administrata; *së dyti*, rruga politike dhe vetë riorganizimi i njësive vendore duke ndryshuar kufijtë, redukton sipas rastit administratës e njësive që shkrihen. Njësia e redon të ketë më pak shpenzime për administratën. Ekonomia e shkallës është një justifikim për bashkimin e njësive vendore (Dollery, Auster & Marshall, 1997).

Ekonomia e shkalles, është një arsyë tjetër që rrit eficencën në shpërndarjen e shërbimeve, duke ulur koston/njësi dhe si rezultat bën të mundur rritjen e volumit të prodhimit të shërbimeve (Bailey, 1999: 25). Në rastin e ekonomive të shkallës, njësitë e mëdha janë më të afta për të cuar më shumë shërbime tek komunitet, duke reduktuar shpenzimet, duke rritur profesionalizmin në punë dhe duke ulur koston/njësi. (Deller, et al, 1992, Deller dhe Halstead, 1994), arrijnë në përfundimin: "Qeveritë e vogla mund të përshtaten më mire me komunitetet lokale në afrimin e shërbimeve, por me kosto të lartë".

Por në zonat rurale për shkak të hapesirës dhe specifikës së shërbimeve, është e vështirë patja e një suksesi në përfitimet që sjell ekonomia e shkallës, si dhe shërbimet e dublimit të shërbimeve (Bailey 1999: 27). Për disa shërbime, ekonomia e shkallës mund

të rrisë koston/njësi ose të sjell efekt të kundert të mos patjes së ekonomisë së shkallës (Dollery, Crase 2004: 269).

Në kushtet e shqipërisë ku terreni është 60% malor, është e vështirë të realizohet për shumë shërbime ekonomia e shkalles, sepse fshatra të shumtë janë të shpërndarë si nga njeri-tjetri, por dhe në vetevete. Për këtë arsy me mirë është që njësitë vendore të kooperojnë më njëra-tjetrën, se sa të bashkohen në një njësi të vetme (Friedrich Reiljan 2010). Në shumë raste mund dhe të bashkëpunohet më sektorin privat dhe të privatizohen disa shërbime, se sa të shkrihen njësitë vendore. Por nga ana tjetër nuk duhet neglizhuar, se kur zmadhohet shumë ajo e humbet këtë avantazh sepse shtohen kosto të tjera si transporti i diversifikuar, largësia nga qëndra për shërbime, etj.

Nga ana tjetër një arsy për të rritur eficencën nëpermjet njësive të medha është dhe veprimtaria ekonomike në ato zona. Sipas Dollery dhe Crase (2004: 269) kosto e veprimtarise për ofrimin e shërbimeve nga një organizatë është më e vogel, se kur shërbimet e të mirat sillen tek qytetaret, nga shumë organizata ose operator. Për këtë problem Dollery (2006: 279) jep disa arsy, *së pari*, bashkimi në inpute; *së dyti*, bashkimi në outpute; *së treti*, bashkeveprimi ndërmjet furnizimit të shërbimeve dhe procesit të prodhimit të të mirave. Centralizimi i shpërndarjes së shërbimeve mund të krijojë kosto në marrjen e shërbimeve; së fundi kosto sociale mund të rritet më shumë së sa të zvogelohet. Pushteti vendor nuk është biznes, por një agjenci shtetërore që ka për qëllim shërbimin ndaj qytetarëve dhe demokratizimin e jetës së tyre. Eficenca ka rëndësi kur demokratizimi dhe administrimi janë të zgjidhura si procese të pushtetit vendor (Reiljan, Timpann 2001: 433). Bashkimi i njësive vendore është një rritje në drejtim të

cilësisë së administritimit të qeverisjes ndaj qytetarëve, për të marrë shërbimet e nevojshme në kohë e më cilësi.

2. Njësitë e mëdha vendore janë më të mundëshme për promovimin e zhvillimit ekonomik.

Nje arsyet tjetër pro krijimit të njësive të mëdha vendore është, se njësitë e mëdha kanë më tepër mundësi nga pikëpamja e mundësive financiare për të mbështetur një zhvillim më të mundshëm të rajoneve (Aalbu et al. 2008: 41). Një njësi e madhe mund të këtë punonjes më të specializuar për të drejtuar punën e administratës në një mënyrë më efektive së në njësitë e vogla. Në Shqipëri sidomos në zonat rurale, për shkak të lëvizjes demografike dhe kushteve të këqija të infrastrukturës, punonjësit e specializuar kanë braktisur zonat e rurale. Njësitë e mëdha kanë hapësirë territori më të mëdhë dhe kanë mundësi që të bejne projekte më eficent dhe më efektiv. Po në të njëjtën kohë, njësitë e mëdha kanë në varësi pasuri më të madhe për të nxjerrë të ardhura, e për të krijuar aktivitet ekonomik më qëllim shfrytëzimin e këtyre pasurive në shërbim të nxjerjes së të ardhurave

3. Njësitë e mëdha vendore do të përmirësojnë afrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve publike, si dhe mbledhjen e të ardhurave.

Kjo nuk varet shumë nga madhësia e njësisë vendore se sa nga rregullimi i marrëdhënieve midis pushteti vendor dhe atij qëndror në dhënien e më shumë kompetencave dhe bazën financiare mbështetëse për të shpërndarë shërbime në kohën dhe më cilesinë e duhur. Por, sot në vendin tonë ka qenë e pa qartë ndasia e kompetencave si dhe mundësia për realizimin e atyre që kanë pushtetet vendorë. Qartësimi i kompetencave si dhe realizimi i tyre do të jetë një sfidë e së ardhmes. Reforma territoriale më rritjen e madhësise së njësive vendore është e

nevojshme që të shoqërohet dhe me thellimin e decentralizimit të pushtetit vendor, duke bërë të mundur plotësimin e mangësive të mëparshme.

4. Njesitë e mëdha janë më demokratike në funksionimin e tyre politik.

Nje arsyet tjetër pro njësive të mëdha vendore është dhe ai që argumenton së procesi politik është më demokratik në njësitë e mëdha. Në lidhje më zhvillimin e demokracise në njësitë e mëdha duket se është kontradiktor ky argument, sepse njësitë e vogla mendohet se janë më shumë demokratike se sa njësitë e mëdha (Aalbu et al. 2008: 34). Reilain dhe Timpani (2001: 434) thekson se zhvillimi i demokracisë është i rëndësishëm në nivelet e ulta të administratës publike në trajtimin e qytetarëve.

Distanca optimale ndërmjet banorëve dhe niveleve të administratës varet nga niveli i mendimit demokratik midis qytetarëve dhe së fundi në kulturën demokratike të tyre. Në Shqipëri demokracia është e brishtë dhe njerëzit janë shumë të lidhur me politikën, për shkak të problemeve sociale të pranishëm, niveli të lartë të varfërisë, familjariteti sidomos në zonat rurale është shumë i pranueshëm.

Sipas Sootla et al. (2008: 19), një votë prej qytetarëve që jetojnë në një njësi të madhe llogaritet me peshë specifike më të vogël në procesin e vendimit politik, se një votë prej qytetarëve që jetojnë në një njësi më të vogël. Por, sidoqoftë rritja e numrit të njësive ul influencën e çdo vote dhe redukton potencialin e çdo qytetari për influencimin në vendimarrjen vendore dhe interesin e pjesëmarrjes në procesin politik. Njerëzit jetojnë së bashku në një zonë të caktuar, gjithashtu të orientuar drejt një interesi dhe identiteti të përbashkët. Kjo i frikson në krijimin e një njësie të re, që të mos humbasin identitetin. Debatet politike dhe papajtueshmëria është më efektive në njësitë e vogla, sepse ajo

justifikohet më interesin social dhe në unitetin e njësisë (Newton 1982, 2003). Me rritjen e njësisë rritet niveli i demokratizimit të jetës së komuniteteve, shkëputen lidhjet e ngushta të krijuara për shkak të lidhjeve natyrore dhe i hapin rrugën zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore për një interes më të madh, në bazë të llogarive racionale në komunitet. Nëse njësitë më të vogla janë subjekt të monitorimit më të ngusht dhe banorët janë më te informuar, atëherë ato janë në presion të madh, për të afruar të mira publike më efikase (Boyne, 1998, Bailey, 1999).

5. Njësitë e mëdha do të kenë mundësinë e decentralizimit të shërbimeve të ndryshme për të rritur afërsinë dhe fuqinë e shërbimeve publike. Ajo që vihet re sot në punën dhe veprimtarine e njësive vendore, është së ato janë të paafta të ofrojnë me cilësi dhe në kohën e duhur disa shërbime.

2.2.10 Tendenca Negative të Rritjes së Madhësisë së Njësisë dhe thellimit të Decentralizimit

Problemet urbane dhe zhvillimi i komuniteteve të qyteteve moderne, nuk do të zgjidhet duke zgjeruar monopolin e autoritetit të qeverisë. Në të kundërt, interesave të komunitetit ka të ngjarë t'u shërbehet më mirë, duke rritur detyrat dhe përgjegjësitë e një sistemi të decentralizuar të fragmentuarë qeveritarë (Staley, S. 1992: 19). Studimet empirike dhe raste studimore sugjerojnë: Së pari, se qeveritë lokale që politikëbërja qendrore i detyron të zvogëlojën numrin e qeverive, apo konsolidimin e përgjegjësive në nivelet më të larta qeverisje, janë joefikas dhe mund të minojë përgjegjshmërinë politike që është thelbësore për një qeverisje demokratike. Së dyti, qeveritë lokale duhet të vazhdojnë përpjekjet për të privatizuar shërbimet publike dhe funksione e tyre. Së treti, Qeveritë lokale duhet të jenë të afta, për të hyrë në kontrata dhe për të shmangur

konsolidimet e padëshiruar, kjo nënkupton se duhet të decentralizohen edhe më tej. Së fundi, konsolidimet e qeverisjes vendore duhet të dekurajohen për shkak se ata kanë gjasa për të shkatërruar themelet e shoqërisë demokratike. (Stanley,S., 1992:22)

Nëse njësit më të vogla, janë subjekt të kontrollit më të ngusht, sepse banorët janë më të informuar, atëherë ato janë në presion për të afuar të mira publike më efikase (Boyne, 1998, Bailey, 1999). Rritja e madhësisë së njësise vendore kërkon domosdoshmërisht dhe shoqërimin e këtij procesi me thellimin e decentralizimit në dimensionin e autonomisë politike dhe financiare. Por, kjo sjell dhe disa pasoja negative (Todorovski.I, Stanley, S., 1992: 5) si:

- 1- Niveli i lartë i autonomisë së pushtetit vendor çon në heqjen e mundësisë së shtetit për të koordinuar veprimtarinë ekonomike në shkalle vendi, në uljen e zhvillimit ekonomik dhe konkurrencën e pamjaftueshme, sidomos në tregjet e huaja;
- 2- Autonomia financiare pothuajse e plotë e njësive vendore, i heq shtetit mundësinë e përdorimit të instrumentave efiçent për të ndihmuar njësitë vendore më pak të zhvilluara ekonomikisht;
- 3- Numri i madh i kompetencave dhe i madhësisë së njësise vendore nënkupton një administratë të madhe vendore, dhe kërkon më shumë taksa pagues për të përballuar shpenzimet burokratike;
- 4- Njësitë vendore të mëdha nuk mund të krijojnë afërsi më qytetarët.

Për modelet e zbatuara në vende e tjera (Plostajner,Z:62, Dollery, 2002) nuk ka një model standart përsa i përket përmasave të një njësie vendore, akoma ka disa pyetje mbi përmasat dhe rolin e strukturave territoriale të vetqeverisjes vendore: së *pari*, përmasat e nivelit më të ulët të qeverisë ndryshon ndërmjet vendeve të ndryshme. Vëndet që kanë

qeveri shumë të vogla vendore, përballen me potencialin e shpërndarjes së shërbimeve i cili është i copëtuar dhe i paefektshëm. *Së dyti*, qeverive të vendeve të vogla, shpesh i'u mungojnë kapaciteti për manaxhimin dhe përmirësimin e funksioneve të caktuara.

Një ndër parimet shumë të rendesishem të Kartes Europiane të autonomisë vendore, eshte ai i subsidiaritetit që nënkupton sigurimin më të larte të shërbimeve publike, në një nivel shërbimi sa më pranë banorëve dhe vlerësohet si një nga synimet bazë të gjithe reformës në shkallë Europiane në fushen e qeverisjes vendore.

Në vijim të kesaj llogjike, sot pushteti vendor sidomos në zonat malore nuk është eficent në ofrimin e shërbimeve tek komunitetet përkatëse, duke lënë të hapur debatin për të rishikuar ndarjen territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Përmirësimi në ndarjen administrative - territoriale është një mekanizëm që rrit burimet financiare, rrit aftësinë për programimin dhe zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit në shkallë vendi, ul shkallën e korruptionit, rrit aftësinë profesionale të personelit.

2.2.11 Decentralizimi – Mësime dhe Rezultate

A i përbush decentralizimi premtimet e saj teorike? Megjithëse matja e decentralizimit është e vështirë (Ebel dhe Jilmaz, 2003), në vijim përmblidhet një njohje empirike në lidhje më marrëdhëniet ndërmjet autonomisë së decentralizuar fiskale dhe përbushjen e objektivave të gjera ekonomike dhe fiskale të një kombi.

Një korrelacion i fortë midis decentralizimit dhe rritjes së produktit të brendshëm bruto (GDP) për qytetarë, mbështet argumentin se, kur njerëzit bëhen më të arsimuar, më të informuar në

lidhje më qeverinë e tyre, më shumë të vetëdijshëm për problemet që ndikojnë në jetën e tyre, dëshira e tyre për të ushtruar sa më shumë kontroll mbi funksionet e qeverisë rritet.

Pushteti dhe kontrolli në Evropën Qëndrore dhe Lindore është i centralizuar (Bird, Ebel dhe Œallich 1995), nga ana tjetër, vendet e zhvilluara janë të lidhur më sistemet e konsoliduara të decentralizimit dhe shkallët e autonomisë fiskale (p.sh., Akai dhe Sakata, 2002).

Nëse, argumentimet teorike do të ishin të vërteta, decentralizimi do të rrisë efikasitetin në shpërndarjen e shërbimeve publike, kjo duhet të shfaqet si rritje ekonomike. Dhe, më të vërtetë, të dhënat empirike e mbështesin këtë, Martinez-Vazquez dhe McNab (1997) e zbuloi një marrëdhënie të tillë në lidhje me të ardhurave e buxhetit. Ebel dhe Yilmaz (2003) arritën në një përfundim të ngjashëm, variabli i decentralizimit përcaktohet në terma të ngushta apo të gjëra të të ardhurave (një përkufizim i gjerë përfshin grantet e pakufizuara), në lidhje më normën e rritjes së prodhimit real për fryshtë. Një lidhje e ngjashme mbi autonominë e të ardhurave konkludon së “decentralizimi i shpenzimeve i kombinuar më të ardhura të kontrolluara nga qëndra duket se është një pengesë për rritjen ekonomike” (Meloche, Vaillancourt dhe Yilmaz 2004).

Mbi çështjen e stabilitetit makroekonomik, ka prova se autonomia e të ardhurave në nivel lokal përmirëson pozicionin fiskal të qeverive subnacionale, por që mbështetja për transfertat ndërqeveritare mund të përkeqësojë atë pozicion fiskal (Ebel dhe Jilmaz 2003).

Marrëdhënet ndërmjet decentralizimit fiskal dhe madhësisë së sektorit publik janë mikse (Oates 1985), ndërsa në vendet postsocialist dhe në tranzicion, pjesa e GDP-së e dedikuar shpenzimeve të sektorit publik zgjedhohet më rritjen e autonomisë lokale të taksave (Ebel dhe Jilmaz 2003).

2.3 Decentralizimi në Nivele të Ndryshme

2.3.1 Decentralizimi në Vendet në Trazicion e zhvillim: Probleme të Përbashkëta

Vëndet në trazicion vinin nga një sistem politikë i centralizuar dhe rrjedhimisht problematikat do të ishin të vështira në prespektivën afatshkurtër të proçesit të realizimit të decentralizimit, këto dobësi janë më të dukshme në marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare ku do të përfshijmë: struktura qeveritare vendore inadekuate, kalimi i paqartë i përgjegjësive tek qeveritë vendore, mungesa e një autonomie të plotë mbi të ardhurat dhe sistem transfertash ndërqeveritare problematike. Problematika e mësipërme është një pasoje e disa faktorëve (World Bank, 2008):

E mungesës së një strategjie të decentralizimit; mungesa e mekanizmave të koordinimit të politikave. Dobesitë e shfaqura në veprimtarinë e pushtetit vendore është dhe pasoje e mos mbështetjes nga ana financiare e kompetencave me të cilat është ngarkuar pushteti vendor. Për këtë nevojitet një decentralizim më i thelluar i koordinuar më politika mbeshtetese politikisht dhe ekonomikisht.

Fragmentizimi i tepruar i strukturave të qeverive vendore. Duke trashëguar një sistem të centralizuar dhe duke u bazuar në ndarjet e sistemit të mëparshëm administrative këto sollën pasoja në thellimin e decentralizimit fiskal, duke sjellë dhe probleme sociale dhe ekonomike në zonat rurale. Me të vërtetë komunat e vogla janë më afer qytetareve, por janë në minimumin e arritjes së eficencës dhe efektivitetit ekonomik të përdorimit të burimeve të tyre.

Nënvlefësimi i rëndësisë së politikave në rezultate të caktuara të proçesit të decentralizimit. Decentralizimi fiskal ndikon në marrëdhëniet e autoritetit vertikal dhe në

alokimin e burimeve, ndërmjet qeverive qëndrore dhe vendore. për këtë arsyе qeveria qëndrore duhet të mbështes politikisht sidomos në vendet në trazicion.

Rreziqet e kryerjes së decentralizimit në mënyrë të gabuar. Përfitimet nga decentralizimi sjellin rritjen e nivelit të shërbimeve në mënyrë më të paanshme, më eficiente dhe më të sigurta në shperndarje, për ato shërbime të nevojshme, të rrit zhvillimin ekonomik vendore, të ule nivelin e pabarazise, të forcoj besimin tek pushteti, si dhe të zbus diferencimet për shkak të politizimit të qeverive qëndrore në investimet sipas preferencave të saj elektorale. në mënyrë që decentralizimi fiskal të jete i suksesshem duhet që të këtë një strategji të perbashket zhvillimi koherent më decentralizimin politik dhe administrativ. në rast se pergjegjshmeria e qeverive qëndrore nuk do të jete në nivelin e duhur ndaj komunitetit, ashtu sic ka ndodhur deri më sot dhe reformat e mevonsheme do të dështojnë.

Ka një mori të literaturash për decentralizimin bazuar në çështjet teknike, që kanë të bëjnë me rishpërndarjen e autoritetit, përgjegjësisë dhe burimeve financiare për ofrimin e shërbimeve publikë ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes (Manor 1998, Grook 1999). Autorë të tjerë (Nemayer, 2003) të cilët argumentojnë se këto procese duhet të shihet përmes lenteve politike, në qoftë se qëllimet e vlerësimit të projekteve të decentralizimit janë për të vlerësuar shkallën e demokracisë, duke u promovuar nga decentralizimi në nivel lokal. Gjendja e Karnataka në Indi është përmendur si një histori suksesi për decentralizimin. Sekreti prapa suksesit të saj, sipas Manor (2002) është qeverisja e fortë bazuar në një sistem konkurruesh partiake, shypin e lirë, shërbim profesional civil, si dhe mekanizëm të qëndrueshëm të kontrollit publik të pushtetit (Nemayer, 2003). Pavarësisht nga pikat e forta të saj, rasti Karnataka gjithashtu ka mangësit e veta në dështimin për të shërbuer si një mjet efektiv, për të nxitur pjesëmarrjen në nivel vendor .

Në vende si Bregun e Fildishtë dhe Gana, procesi i demokratizimit dhe decentralizimit ka qenë i dobët (Parsons, 1951). Awortwi (Pauls, 2001) thuhet se në rastin e Ganës u krijuar një qeveri e dobët lokale, sepse decentralizimi fiskal dhe politik nuk u shoqërua nga reformat administrative e cila përfundimisht çoi në ricentralizimi. Në rastin e Bregut të Fildishtë, lidhjet e dobëta në mes këshilltarëve të zgjedhur dhe popullsisë rezultuan në një rritje të profitit publik të Komunës në kurriz të zhvillimit lokal (Parsons, 1951). Crook dhe Manor argumentoi se pa një vullnet të fortë të forcës politike qendrore, krijimi i qeverive të forta lokale nuk është i mundur. Decentralizimi në Argentinë, dhe Etiopi gjithashtu nuk mundën të kenë sukses, pasi (Garmanc, 2001:205-2020) këto vende nxituan për të bërë atë shumë shpejt.

Në Azinë Jugore, decentralizimi në vende si Bangladeshi dhe Pakistani, po ashtu paraqesin një pamje të zyrtë. (Crook,Manor, Chang 2002: 23) Bangladeshi tregon performancën zhgënijuese të qeverive locale, sepse nga decentralizimi është rritur ndjeshëm korruptionin. Udhëheqja lokale ishte më aktive në vendosjen e lidhjeve të tyre me pushtetin qendror, sesa forcimin e lidhjeve të tyre me zonat përkatëse. Kjo ka ndodhur pikërisht, sepse qeveria qendrore mbikëqyrur nga afër financat, mund të fitojnë pushtetin duke zvogëluar ose rritur grant-in-ndihmë në organet lokale (Rosenan, 1995: 15-21). Nga ana tjetër, shembulli më i mirë i decentralizimit në Pakistan gjatë periudhës së gjeneralit Musharraf gjithashtu nuk mundi të përbushë premtimin e saj. Institucionet moderne të qeverisjes vendore, në vend që t'u shërbejnë fshatarëve të zakonshëm, kanë forcuar më tej prestigjin dhe fuqinë e pronarëve lokale (Rostow, 1990). Kjo ishte për shkak, se në shumicën e rasteve kryetarët e zgjedhur lokale nuk ishin qytetarët e thjeshtë, por pronarë të fuqishëm.

Decentralizimit në Brazil, dhe Afrikën e Jugut nuk ishin gjithashtu inkurajuese. Në Brazil, kushtetuta i dha një rol të fuqishëm qeverive lokale (Schouwalder, 1997: 761-769), kjo solli një federatë ku politikat e shteteve dominojnë dhe qeveria qendrore është e dobët.

Në rastin e vendeve të Azisë Lindore, si Indonezia dhe Filipinet, decentralizimi nuk mundi të përmbush qëllimet e parashikuar. Në Indonezi, ndikimi fillestar në perceptimet e qeverisjes dhe rezultateve të përzgjedhura nuk ishte pozitiv (Conyers, 2007: 23-27). Besohet gjërësisht se decentralizimi ka rritur ndjeshëm korruptionin dhe pasigurin e politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes (Samudavamja 1991, Theresa 2004).

Vëzhgimet e mësipërme bien në kundërshtim me supozimet e literaturës neo-liberal për decentralizimin. Organizatat e ndërtuar rreth marrëdhënieve padron-klient, kartelet e drogës, dhe rrjetit grabitqare e korruptionit që përfshijnë institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore kanë provuar të jetë më e fortë, se rrjetet e ashtuquajtura vullnetare që do të duhej për të zgjidhur problemet e veprimit kolektiv përfitim shoqëror (Hadiz, 2010: 513-515).

Raporti i Bankës Botërore thotë, se suksesi i decentralizimit shpesh varet shumë në ofrimin e trajnimeve për zyrtarët kombëtare dhe lokale. Është e qartë se ka shumë gjëra të përbashkëta mes stilit të vjetër dhe teorive moderne që janë bazuar në racionalitet, vullnetit të mire, elitave perëndimore të trajnuar, moderne, teknokratike dhe një besim se suksesi apo dështimi përcaktohet në fund të fundit nga cilësia e planifikimit dhe ekzekutimi i programeve të decentralizimit, dhe jo nga mjedisi ekonomik, kulturor, apo politike (sistemet, strukturat, traditat) në të cilën ato janë vendosur. Ky dokument është përpjekur të analizojë qeverisjen e mirë dhe decentralizim në dritën e këtyre koncepteve të ndërlidhura dhe teorive. Ajo gjithashtu reflekton shfaqjen e sfidave të reja bindëse një ndryshim në prioritetet në kuadër të politikave sociale,

politike dhe ekonomike të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe vendet donatore për të mbështetur pushtetin dhe dominimin e tyre në mbarë botën.

Duke pasur parasysh ritmin e shpejtë të ndryshimeve ekonomike dhe sociale në post-periudhën e Luftës së Ftohtë, si dhe sfidat dhe detyrat që mbeten në riorganizimin e botës, sipas parimeve të neoliberalizmit, nuk duhet të ngutemi nga ana e politikëbërësve ndërkombëtare për të zbatuar politikat e tyre sociale, politike dhe ekonomike. Ndërsa evolucioni i decentralizimit në vendet e zhvilluara u shtri gjatë shekujve dhe pëershpejtar në dekadat e fundit, në vendet më pak të zhvilluara "procesi ka qenë më i ri, më i shpejtë dhe më traumatike '(Sten, Goldin, Rogers 2002). Kjo megjithatë nuk po jep rezultate të dëshirueshme, në këtë kontekst, (Stoka, Mohan, 2000: 249) një nga arsyet pas dështimit të decentralizimit në Argjentinë dhe Etiopi është, se këto vende u përpoqën për të bërë atë shumë më shpejt.

Analiza e më sipër është njëra anë, ana tjetër janë praktikat aktuale dhe motivet e shteteve më pak të zhvilluara në botë, për zbatimin e programeve të decentralizimit, ku paraqet një tension midis teorisë dhe praktikës (Serdar, Yakup, Rodrigos 2008). Për shkak të faktit se këto shoqëri janë ende të drejtuar në bazë të sistemeve hibride ekonomike (një përzierje të sistemeve fisonore, agrare dhe kapitaliste), rezultati është që këto vende paraqesin një tablo të shtrembëruar të qeverisjes së mirë dhe decentralizimit. Në vend që të vendosin nga lart-poshtë për mjetet dhe instrumentat për forcimin e qeverisjes lokale, hartuesit e politikave do të bëjmë më mirë që të marrin në konsideratë faktorët historike dhe mjedisin ekonomik, kulturor dhe politik (sistemet, strukturat, traditat) mbi të cilën institucionet e qeverisjes vendore duhet të jenë të organizuar (Yilmaz, Varsha 2013:235-239).

2.3.2 Decentralizimi në Vendet e Zhvilluara: Decentralizimi Fiskal dhe Zhvillimi Ekonomik

Problemi i reformimit të pushtetit vendor i cili vetveti lidhet më decentralizimin politik dhe ekonomik ka qënë dhe mbetet dhe sot i pranishëm dhe në vendet e zhvilluara. Metropoli amerikan përbëhet nga një mozaik të qyteteve, fshatrave dhe zonave të inkorporuara në depresion me qytetet qendrore. Efektet e ndryshime i përmblodhi politologu David Walker (!987: 15), zona metropolitane e sotshëm është e ndryshme në (a) madhësinë e popullsisë dhe territorit, (b) përzierjen e funksioneve private ekonomike me gamen e shërbimeve publike të ofruara, (c) kompleksitetin në llojet e juridikSIONVE (Staley,S., 1992: 23).

Vetë zhvillimi ekonomik dhe shoqëror është në një transformim të vazhdueshëm për arsyet e teknologjise së informacionit dhe pasojave të globalizmit. Si në Europë dhe në SHBA kemi krijimin e autoriteteve rajonale dhe kthimin e disa shërbimeve sociale drejt rajonit dhe qeverive lokale. Çështja themelore ekonomike për decentralizim i drejtohet sigurimit me shërbime publike të një klase për të cilën përfitimet dhe kostot janë të kufizuar gjografikisht(Stanley, 1992: 22). Ka një sërë shërbimesh publike si psh: rrugët lokale, grumbulli i plehrave, mbrojtja nga zjarri, dhe të tjera, që janë kryesisht në dobi të interesave lokale. Kërkesa për këto shërbime dhe koston e tyre ka mundësi të ndryshojë në bazë të juridikzionit, po aq sa niveli i kënaqëshëm ekonomik dhe forma e shërbimit të ndryshoje nga një zonë në tjetrën. Për të tilla shërbime (të mira publike lokale) një shpërndarje efektive e burimeve do të barazoj kostot marxhinale në secilin zonë. Sigurisht në parim asgjë nuk do ta ndalonte një qeveri qëndrore nga sigurimi i modelit efektiv të prodhimeve publike mes provincave ose bashkive, por në praktikë ndodh. Ka dy pengesa kryesore që të çojnë drejt një rezultati të tille: *së pari*,

është një problem informativ, nuk është e lehtë për një agjensi qëndrore të bashkojë informacionin specifik të juridiksonit, me preferencat lokale dhe kostot e furnizimit; *Së dyti*, ekziston dhe një lloj detyrimi politik. një agjensi qëndrore nuk mund të ndryshoj lehtë shërbimet midis zonave, duke siguruar nivel më të lartë të shërbimeve publike në disa zona krahasuar me disa të tjera.

Dimensioni politik është më esenciali në realizimin e decentralizimit pasi nëpërmjet tij zhvendoset pushteti i vendimarrjes sa më afër mendimit të qytetarëve për t'u qeverisur sa më afër por dhe për të marrë ato masa dhe politika zhvillimore që komuniteti i sheh më të nevojshme , për të realizuar kushte më të mira mirëqënie. Dimensioni politik është primari në realizimin e decentralizimit pasi ai është realizuesi në praktik dhe i decentralizimit fiskal.

Realizimi i decentralizimit është një proçess i vështirë sepse transferimi i kompetencave kërkon që organeve më të uleta t'u krijohet dhe baza e nevojshme administrative, financiare për ta realizuar atë. Në praktikë përdoren tre forma të decentralizimit të cilat ndryshojne nga njëra-tjetra për shkak të mënyrës së realizimit por dhe të operimit dhe përgjegjshmërinë e organeve.

Per të realizuar afrimin dhe dhenien e shërbimeve komunitetit, pushteti vendor i ka të përcaktuara fushat e veprimtarise së tij, por dhe detyrat dhe përgjegjësit për këtë le të shohim ç'jane funksionet dhe kompetencat.

“Funksion” është fusha e veprimtarisë për të cilën pushteti vendor është përgjegjës nga një organ i caktuar. Funksionet i ndajmë si më poshte:

“Funksione të deleguara” janë funksione të pushtetit qëndror ose të ndonjë institucioni qëndror që më ligj ose më marrëveshje, caktohen të realizohen nga pushteti vendor në mënyrën dhe masën e caktuar nga pushteti qëndror.

- Funksionet e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme, si ndihmat sociale;
- Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë të përcaktuara më ligj;
- Institucionet qëndrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë njësinë vendore të kryejne funksione të caktuara të institucioneve qëndrore;
- Njësive vendore mund t'u delegohen kompetenca jo të detyrueshme mbi bazen e një marreveshje përkatese;
- Ne çdo rast qeverisja qëndrore u garantojne njësive të qeverisjes vendore mbeshtetjen e nevojshme financiare, per ushtrimin e funksionit dhe kompetencave të deleguara;
- Me synim ngritjen e nivelit të sherbimit njësitëvendore mund të perdonin dhe burimet e veta për ushtrimin e funksionit dhe kompetencaver të deleguara.

” Funksione të përbashketa” janë funksione për të cilën njësia e qeverisjes vendore ka masën e saj të përgjegjesisë të dallueshme nga pjesa e pergjegjësise të dhëne pushtetit qëndror, si dhe bashkeshoqerohen përpjesetimisht më kompetenca, te cilat i ushtron në mënyrë autonome. Komunat dhe bashkitë kanë këto funksione të përbashkëta:

- Arsimin parashkollar dhe parauniversitar;
- Sistemin e shërbimit parësor shëndetsor dhe mbrojtjen e shendetit publik;
- Kujdesin social, zbutjen e varferisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse;
- Rendin publik dhe mbrojtjen civile;

- Mbrojtjen e mjedisit;

Ne rastet kur pushteti qendror i kerkon pushtetit vendor kryerjen e një funksioni të perbashket, ai i siguron mbështetjen e mjaftueshme financiare dhe materiale.

3.”Funkzionet e veta” janë funksione të dhëna më ligj njësisë së qeverisjes vendore, për të cilat ajo është përgjegjëse për realizimin, si dhe ka liri dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda hapësirës së normave, kritereve e standardeve të pranuara përgjithesisht më ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi, rregullatore nevojsh.

Njësitë vendore ushtrojnë këto funksione të veta:

1. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
 - Furnizimi me ujë të pijshëm;
 - Funksionimi i kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza dhe kanaleve mbrojtëse;
 - Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve më karakter vendor, trotuarëve dhe shesheve;
 - Ndrizimi i mjediseve publike;
 - Funksionimi i transportit publik urban;
 - Administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit;
 - Shërbimi i dekorit;
 - Administrimi i parqeve lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
 - Planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe i strehimit sipas ligjive;
2. Shërbimet më karakter social dhe kulturore sportive:
 - Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore, historike vendore, organizimi i veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse;

- Organizimi i veprimtarive sportive, clodhëse e argëtuese dhe administrimi i institucioneve përkatëse;

3. zhvillimi ekonomik vendor:

- Përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor;
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të trëgtisë;
- Zhvillimi i biznesit të vogël, dhe veprimtarive të tjera ndihmëse;
- Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme;
- Shërbimi veterinar;

5. “Kompetenca” është autoriteti i dhënë më ligj një organi për kryerjen e një funksioni.


6. “Kompetencat e veta” janë autoritete ekskluzive që u janë dhënë me ligj njësive të qeverisjes vendore për realizimin e funksioneve të veta.

7. “Kompetenca administrative” është kompetenca për manazhimin e strukturave dhe personelit, (ngritja dhe shkrirja e strukturave, emërimi, shkarkimi, transferimi, përcaktimi i pagave dhe shpërblimeve të personelit), në përputhje më legjispcionin në fuqi.

8. “Kompetencë e deleguar” është kompetenca e pushtetit vendor që më ligj ose marreveshje i është transferuar pushtetit vendor, si të tillë do të përmendim shpërndarjen e ndihmave sociale.

9. “Kompetencë investuese” është kompetenca për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e investimit. Ku pushteti vendore bënë projektet më të domosdoshme dhe qeveria qëndrore i plotëson këto nevoja financiarisht me fondet e veta

Figura 1 Skema e kompetencave të pushtetit lokal



Burimi: (Gjonaj, 2015)

Megjithëse qëllimi i kompetencave të organeve (Ananieva.N) të vetqeverisjes vendore duket i qartë dhe i mjaftueshëm dhe situatat konfliktuale ndermjt këtyre organeve janë ato që terheqin më tepër vemendje, në fakt rrënjet e verteta të problematikave në pushtetin vendor janë diku tjetër, rrënjet e problematikave janë të lidhura me:

1. Zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko - shoqëror të vendit, pikërisht sepse krizat e zhvillimit prekin drejtperdrejtë njësitë e pushtetit vendor, duke zvogëluar ndjeshëm aftesitë e tyre për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve të tyre.
2. Mungesa e ekuilibrit ndërmjet centralizimit dhe decentralizimit të pushtetit dhe burimeve, me dominimin e dukshëm të centralizimit.

Parimet e financimit të njësive vendore⁵ :

- Politikat kombëtare financiare garantojnë funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumllojshmerisë së burimeve të të ardhurave.
- Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhura të tjera vendore, nga fondet e transferuara nga pushteti qëndror dhe fondet që u vijnë derjtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare.
- Njësive vendore u garantohet më ligj autoriteti i mjaftueshëm për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
- Pushteti qëndror u jep njësive të qeverisjes vendore fonde për përbushjen e të gjitha standardeve dhe kërkesave që ai vendos për funksionet dhe kompetencat e deleguara.
- Cdo qeverisje vendore miraton çdo vit buxhetin e vet pa deficit në perputhje me ligjin nr. 8379, date 29. 7.1998. “per hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së shqipërisë”.

Të ardhurat e veta të njësive Vendore;

1. Njësitë vendore krijojnë të ardhura nga:
 - a) Taksat dhe tatimet vendore mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
 - b) Taksat dhe tatime vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël, të shërbimit hotelor, të restoranteve, bareve dhe shërbime të tjera;

⁵ Fletore Zyrtare,Ligi nr. “ për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,dt.31.7.2000, fq.1277.

- c) Taksat dhe tatimet vendore mbi të ardhurat vetjake të krijuara me dhurim, trashëgimi, testamente ose llotari vendore;
 - d) Taksa e tatime të tjera të përcaktuara me ligj.
2. Baza e teksave dhe e tatimeve vendore, si dhe kufijtë maksimal dhe/ose minimal të nivelistë tyre vendosen me ligj të vecant.
 3. Komunat dhe bashkit krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:
 - a) Shërbimet publike që ato ofrojnë;
 - b) Të drejten e përdorimit të pronave publike vendore që ato zotërojnë;
 - c) Dhënien e licensave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilën ato kanë autoritet të plot.
 4. Njësitëvendore vendosin vete për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në perputhje më politikat kombëtare.
 5. Njësitë vendore marrin hua për qëllime publike vendore, në bazë të ligjit.
 6. Ato krijojnë të ardhura nga veprimtaria e tyre ekonomike, qirate dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat dhe donacionet.

Të ardhurat nga burimet kombëtare

1. Njësitë vendore financohen nga këto burime: a) taksat dhe tatimet e ndara, në të cilën përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat vetjake, si dhe një pjesë e tatimit mbi fitimin e subjekteve ekonomike jo më pak së tre herë në vit; b) transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit, bazur në funksion të kompetencave të veta e të përbashkëta; c) transfertat e kushtëzuara nga buxheti i shtetit.

2.3.3 Decentralizimi: Eksperiencia e Vendeve Nordike në Ndarjen Administrative-Territoriale

Ne këtë syth do të shikojmë eksperiencën dhe praktikën e ndjekur nga vendet e Europës Veriore (vendet Nordike), Finlandës, Suedisë, Norvegjisë, Danimarkës. Kjo do të shërbej për të studuar faktorët që duhet të ndikojnë në reformimin e pushtetit vendor në Shqipëri duke patur parasysh këto praktika.

Përsa i përket organizimit të qeverisjes në **Finlandë** ai është i ndërtuar në dy nivele, në ate qendror dhe local, pra pushteti vendor është autonom, vihet re së bashkitë janë të vogla. Por, kemi dhe krijimin e kooperativave speciale për shërbime të përbashkëta, për shërbime të përkohshme. Disa shërbime si shëndetesia janë përqëndruar nga 21 rajone në 19 rajone (Aalbu et al.,2008:19) pas bashkimit të bashkive, janë 6 njësi agjensi shteterore dhe 15 qendra për zhvillimin ekonomik, tansportin dhe mjedisin që kanë filluar aktivitetin në vitin 2010. Këto agjensi dhe qëndra shërbimi janë provizore si shërbime “nationale”, në nivel rajonal.

Njësitë vendore në finlande janë zvogeluar në 30% të numrit të tyre, në vitin 1955 Filanda kishte 547 njësi, në vitin 1977 kishte 464, në vitin 1996 kishte 455 njësi, në vitin 2007, 416 njësi, në janar të vitit 2010 i bëri 342 njësi (Oitmaa, Roigas 1998: 88-89), Ekonomia e zhvilluar dhe mbështetja qevritare bëri që njësitë vogla të bashkoheshin vullnetarisht me njësitë e mëdha dhe të pasura.

Suedia, ndarja e pushteti në Suedi është qëndrore dhe lokale për afrimin e shërbimeve dhe drejtimin administrative të komuniteteve si dhe afrimin e shërbimeve qytetarëve, pushteti lokal ndahet në, bashki niveli i parë dhe rajone, si nivel i dytë. Shërbimet publike

më të shumtata ofrohen nga pushteti lokal, përveç shërbimit shëndetësor që kryesisht mbulohet nga rajonet.

Pushteti qëndrore është përgjegjës për rajonet, sipas kufijve administrative dhe autoriteteve të tyre në organizimin sektorial dhe rajonal (Aalbu et.2008: 28), legjislacioni Suedes i vendos bashkitë dhe rajonet në një nivel, por rajonet mbulojnë më shumë hapësire se bashkitë, por këshilli rajonal nuk është autoritet superior mbi njësinë e bashkisë (Lokal Guvernment në Suedi 2005: 4). Në vitin 1946, Parlamenti Suedes vendosi si limit për të qënë njësi vendore jo më pak së 2000 banorë (Gustafsson 1983: 28), si rezultat numri i bashkive u redukrua nga 2496 në 1037 njësi në vitin 1952 (Oitma,Roigs 1998: 82). Në vitin 1964 parlamenti ngriti numrin limit për banore në njësi jo më pak se 8000 banorë (Scandaloë 1978: 773) si rezultat kemi 821 bashki, në vitin 1969 në 675 njësi me detyrim, në vitin 1974 në 278 njësi (Oitma Roigas 1998: 83). Një argument për shkrirjen e detyrueshme ishte së aktiviteti politik ishte shumë i lartë (Oitma Roigas: 83) në bashkitë e vogla, si një nevojë për të demokratizuar jetën në zonat rurale. në vitin 2009 kemi numrin e bashkive, të këshillave rajonal,në 290 njësi.

Reformimi i pushteti vendor në Suedi ndoqi rrugën e bashkimit të detyruar, në vitet e fundit numri i njësive vendore është zgjedhur në 2 herë nga ato të para viteve 90, (Montin 2000: 3).

Danimarka, e cila ashtu si dhe Suedia e ka të organizuar pushtetin vendor në dy nivele, në bashki niveli i parë dhe rajone (qarqe) niveli i dytë. Niveli i dytë rajonet janë më shumë përgjegjes për Shërbimet shëndetësore të përqëndruara. Bashkitë janë përgjegjëse për atrimin e shërbimeve të tjera lokale dhe vecanërisht për arsimin dhe zhvillimin lokal (Aalbu et al.

2008: 16). Bashkitë dhe rajonet aplikojnë sistemet përkatëse për taksat lokale dhe rajonale (Qeverisja vendore Danimarkës 2009: 4).

Proçesi i reformimit të pushtetit vendor në danimarkë është bërë në dy etapa: *e para* në vitin 1970 duke ulur numrin e bashkive nga 1387 në 275, dhe numrin e rajoneve nga 24 në 14 (Qeverisja vendore Danimarkës 2009: 3); *etapa e dytë* përkon me periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2006, duke sjell si pasojë reduktimin e njësive nga 271 në 98 njësi, dhe numrin e rajoneve nga 14 në 5 (Aabu et al. 2008: 17-18).

Norvegjia, ka qënë pak e përfshirë në reformimin e pushtetit vendor i cili është i organizuar në dy nivele: niveli parë bashkitë; niveli i dytë Rajonet (Qarqet). Norvegjia ka 430 bashki si nivel të parë, dhe 19 rajone si nivel i dytë (Qevrisja lokale në Norvegji 2008: 7). Në norvegji ka patur një stabilitet në organizimin e pushtetit vendor, vetem një numër i vogël njësish janë bashkuar deri në vitin 2000 (Aabu et al. 2008: 22).

Islanda, Pushteti vendor është i organizuar vetem në një nivel, si Finlanda ndryshe nga Suedia dhe Danimarka që e kanë organizuar pushtetin vendor në dy nivele. Veçoria e njësive vendore është se ka raste dhe me 50 banorë për njësi. Kjo sepse banorët merren me kultura bujqësore, në formën e kooperativave. Islanda është një vende ku popullsia më e madhe jeton në qytet, vetem kryeqyteti i Islandes ka 75 % të popullsisë së vendit (Aalbu et al. 2008: 25). Qeveria e Islandës si ka mbështetur njësitë vogla vendore për tu bashkuar, por në qofte së Suedia dhe Danimarka ndoqën rrugën e bashkimit të detyruar, Islanda ashtu si Finlanda dhe Norvegjia ndoqën rrugen e bashkimit vullnetar. Në vitin 1950 Islanda kishte 229 njësi vendore, në vitin 1990 u bën 204 njësi, sot ajo ka 78 njësi vendore është karakteristike numri i vogël i banorëve, ku 14 njësi kanë 200 banorë (Aalbu et al. 2008: 25). Duke u nisur nga përdorimi i rrugës vullnetare nga Finlanda dhe Norvegjia, si dhe asaj të

detyrueshme nga Suedia dhe Danimarka, mund të themi se kjo është për arsyet e kushteve ekonomike, terrenit, dendësisë dhe vizionit të ndryshëm që kanë keto shtete për organizimin e pushtetit vendor. Arsyet tjetër është sepse, Danimarka dhe Suedia kanë një sistem shtetëror qëndror të fortë, dhe nuk duan të coptojnë atë, pasi ato në të shkuarën mund të kenë qënë shqetesim për shërbimet publike.

Tabela 1 Tabela e të dhenave për organizimin e pushtetit vendor të vendeve Europiane

	Finlanda	Suedia	Norvegjia	Danimarka	Islanda
Popullsia	5 326 314	9 256 374	4 799 252	5 511 451	319 368
Siperfaqa(km ²)	338 145	450 295	323 802	43 094	103 368
Dendësia popullsise/km ²	16	21	15	128	3
Nr. Njësive	342	290	430	98	78
Mes. e popullsisë për njësi	15 574	31 918	11 161	56 239	4094
Mes.e siperfaqes për njësi (km ²)	989	1 553	753	440	1 321
Numri I Rajoneve	4	21	19	5	-
Mes. Poullsise për rajon	-	440 778	252 592	1 102 290	-
Mes. Siperfaqes për Rajon (km ²)	-	21 443	17 042	8 619	-

Burimi: (Gjonaj, 2015)

2.3.4 Decentralizimi: Eksperiencia e Vendëve të Europës

Debati rreth madhësisësë njësise vendore nuk është i ri .Olson (1966) diskutoi mbi parimet e barazisë fiskale mes vendimarresve, përfituesve dhe taksapaguesve në ndarjen e përgjegjësive, midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Duke ndjekur këtë linjë Oates

(1972) dhe Kings (1984), në teorit e tyre të federalizimit fiskal u kushtuan vëmëndje promovimit të “madhësisë optimale” të shërbimeve lokale. Por, kjo nuk ndihmoi organizimet territoriale për të pakten tre arsyet: *së pari*, teoria u propozua vetëm për një shërbim publik; *së dyti*, merrte në konsideratë vetem argumentet ekonomike duke krijuar një harte të sheshtë; *se treti*, shkrirja apo bashkimi është një process politik dhe demokratik dhe jo thjesht një argument ekonomik dhe teknokratik.

Praktika tregoi rrugë të tjera që u ndoqën nga studiues si Sëianieëicz, 2002; Dollery and Roboti (2008).

Debati e ndau Europen në dy blloqe territoriale që ishin gjithashtu dy opsione politike (Daflon, 2003; 276-77).

Periudha (1952 -1972) solli përdorimin e rrugës së bashkimit /shkrirjes së detyrueshme nga pushteti qëndror, dhe u bë një ekskluzivitet i vendeve të Europes Veriore, me një reduktim drastik të numrit të njësive të vogla të njësive vendore, koha tregoi se që rezultative pa problem të ndryshme sociale apo lokale.

Përdorimi i rruges së bashkimit të detyrueshëm ose radikal nga larte poshtë, tregoi të kundërtën në botën latine, sepse nuk që i suksesshëm duke u shoqëruar më probleme të ndryshme sociale, sepse vendet nuk kanë kushte të njejta sociale dhe ekonomike.

Periudha që pasoi u shoqërua nga ndryshime të legjislacionit që lejonin bashkimet vullnetare, perfshi këtu vende si Franca dhe Gjermania.

Një numrë shumë i madh njësish vendore shumë të vogla është një prokupacion i vërtetë për shumë vende të Europes (Marcou, 2000; Sëianieëicz, 2002). Kjo për arsyet së fragmentizmi kishte krijuar inefiqënce në prodhimin e shërbimeve publike.

Praktika tregoi së disa ndryshime ishin të domosdoshme, kryesisht të lidhur më fakte që nuk kundërshtonin bashkimin, por bashkimin e detyruar duke i dhënë më tepër frysë bashkimit vullnetar.

Disa vende të Europes kanë ndjekur politika më liberale (Franca, Spanja, Finlanda, Italia) përmes adaptimit të rregullave që nxisin bashkëpunimin dhe shoqërizimin midis pushteteve vendore ekzistuese, si dhe nënkontaktimin dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Modeli i reformës së shkrirjes/bashkimit të detyrueshëm ka mundësinë e të qënët më efektiv dhe më praktik për t'u realizuar dhe funksionuar. Nga ana tjeter, ka mundësi të mos krijojë stabilitet e të jetë konfliktual në praktike, për shkak të arsyeve etnike, sociologjike dhe historike, që bien ndesh më disa tradita lokale .

Modeli liberal/vullnetar ka avantazh më shumë në respektimin e dokeve dhe të zakoneve dhe përputhet më shumë më të drejtën për të vendosur vet komuniteti me kë do që të jetë në një njësi administrative, në bazë të së drejtës ndërkombëtare dhe kushtetutës dhe legjislacionit. Një formë në thelb demokratike në roport më rrugën tjeter radikale, si dhe krijon marrëdhënie të natyrshme administrative për komunitetin, por ka disavantazhin e të qënët më kompleks, monitorohet nga qëndra.

Një variant mund të jetë afrimi i stimujve financiar /fiskal dhe mbështetje teknike nga ana e qeverisë qëndrore, që do të nxiste bashkimin e komuniteteve të vogla kurdoherë që kjo të ishte e mundur, rasti i Lativise. Kjo mund të bëhej përmes shoqërizimit vullnetar të bashkive dhe komunave (ligji Nr. 5682/2000) për afrimin e shërbimeve të përbashkëta, apo përmes një shkrirje definitive të vete juridiksioneve me anë të referendumit të njësive që duan të përfshihen në proces, duke qartësuar përfitimet që do të kenë.

Hungaria : e ndërtoi bazën ligjore (Balas.G,&heugeus.J:100) prej një sistemi qeverisës prej dy nivelesh, duke eleminuar nivelin ndërmjetës. Nga viti 1990 numri i njësive të qeverisjes është shumëfishuar prej 1523 (në vitin 1990) në 3154 (në vitin 1999), përgjithësisht nga ndarja e vullnetshme e njësive vendore ekzistuese. Sa më sipër ishte një reaksion i politikës shtrënguese dhe detyruese të viteve 70 të regjimit komunist.

Ne vitin 1996 qeveria Hungareze miratoi ligjin për zhvillimin dhe planifikimin rajonal, duke patur si qëllim të siguronte, që politika rajonale e Hungarisë të ishte në përputhje me politikën, sistemin dhe instrumentat e zhvillimit të BE-se, (Balas.G,&heugeus.J:100).

Hungaria bëri një program 6-vjecar që coj në krijimin e 7 rajoneve, me synimin për të shmangur problematikën e ndarjes në dy niveleve qeverisës por, dhe për të përfituar nga fondet e vëna për zhvillimin rajonal nga Bashkimi European. Konkluzioni që duhet të nxjerrim nga Hungaria është se niveli i dytë ndërmjetës midis pushtetit vendor dhe qendror është i domosdoshem për mirë administrimin në hapësira të ndërmjetme.

Gjermania: trashegoi një sistem të pushtetit vendor mjaft të fragmentarizuar (Buloë,J:116), n.q.s Gjermania Perëndimore kishte në vitin 1990, një popullsi prej 60 miljon dhe njësi vendore, qytete dhe komuna 8500, Gjermania Lindore më popullsi 17 milion kishte më shumë së 7500 qytete dhe komuna, dhe më e veçanta pothuajse tre të katertat kishin më pak së 1000 banorë.

Shembulli i Saksonise: reforma në saksoni filloi në vitin 1994 dhe u perfundua në vitin 1999 (Buloë,J:116). Si kriter u caktua numri i banorëve për komune jo më pak së 1000 banore, dhe si rezultat numri i komunave u pakësua në një të treten e numrit të mëparëshëm. Por vetëm një pjesë e vogël e komunave të reja kishin mundësi të mbanin personel të punësuar në mënyrë të përhershëm. Duke parë dobësit dhe fuqinë e pakët u

caktua nga qeveria qëndrore numri i banorëve për njësi, jo më pak së 5000 banorë për njësi. Kjo i detyroi komunat e vogla të bashkoheshin më të ashtuquajturin bashkime administrative ose komunitete administrative, ku punonjësit komunar janë të pavarur (ka një këshill dhe një kryetar të vetin), por mbajnë të njëjtin aparat administrative që u shërben të gjithëve. Për të eleminuar zhvillimin e periferive dhe shmangur qëndrën historike të qyteteve (Buloë,I:116), u vu re dobësimi qyteteve dhe forcimi i periferive, për këtë arsyе periferit (komunat) u bashkuan më qytetet, sepse pengonin gjallërimin e qyteteve. Kjo beri që 75% e njësive të vogla të bashkoheshin vullnetarisht jo me detyrim nga qeveria qëndrore, por më dokorëtsi me njëri tjetrin në bazë të ligjshmërisë.

KAPITULLI III. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor në hqipëri

3.1 Analizë e Shqipërisë në Terma të Strukturës Administrativo – Territoriale

3.1.1 Decentralizimi: Rasti i Shqiperisë

Funksionimi dhe organizimi i pushtetit vendor në Shqipëri ka qenë historikisht rezultat i vullnetit të klasave politike, sipas sistemeve politike që kanë udhëhequr shoqërinë Shqiptare përgjatë një kohe një shekulliore. Në përgjithësi ka zotëruar praktika e centralizimit të këtij pushteti nga qëndra. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë së Vlorës⁶ që kishte si projekt modelin Francez të organizimit të pushtetit vendor, ngelet e vetmja përpjekje përgjatë një shekulli për demokratizimin e pushtetit në Shqipëri deri në vitin 1992.

Ndarja e Pushteteve në Republikën e Shqipërisë

Në bazë të sistemeve politike që aplikojnë shoqëri të ndryshme, kanë të përcaktuar dhe elementet demokratik të këtyre sistemeve. Një parim i rëndësishëm i organizimit të këtyre sistemeve politike është dhe ndarja e pushtetit.

Ndarja vertikale e pushtetit: pushteti legjislativ (parlamenti), i cili është organi i zyrtarëve të Zgjedhur që përfaqësojnë publikun dhe, që në shumicën e sistemeve politike, i ngarkuar me nxjerrjen e ligjeve themelore, ligje të cilat mund të përpunojen më tej nga hallkat qeveritare. Organet ligjevënëse kryejnë dhe funksione të tjera të rëndësishme në kontrollin e ekzekutivit, dhe reduktimin e shanseve për gabime nga ana e zyrëtareve politik dhe nënpunesve të tjerë.

Pushteti Ekzekutiv (qeveria), pasi nxirren dispozitat më karakter të përgjithëshëm ato duhet zbatuar, sepse ligjet kanë karakter të përgjithëshëm gjë, që kërkon konkretizim për raste të


⁶“ Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqiperi”Tirane,1994,fq.71-73.

vecanta. Karakteri abstrakt i normave ligjore e bënë të domasdoshëm zbërthimin dhe përshtypjet e tyre për marrëdheënie shoqërore konkrete. Veprimtaria ekzekutive është veprimtaria që ka për detyrë të vërë në jetë ligjet dhe aktet e tjera të organit ligjvënës.

Gjyqësori (kontrollues i ligjshmërisë), zgjidh kontradiktat midis pushteteve, institucioneve, subjekteve shteterore e privat.

Por këto funksione pushteti ekzekutiv nuk i kryen vetëm, por në bashkëveprim më pushtetin lokal, që është pushtet që rrjedh nga ndarja horizontale e pushtetit ekzekutiv. Pushteti ekzekutiv përbëhet nga këshilli i ministrave dhe nga pushteti vendor, nga këtej rrjedh se pushteti vendor është dhe operon si pjesë e pushtetit ekzekutiv.


Figura 2 Skema e ndarjes së pushteteve në republikën e Shqipërisë



Burimi: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Qeverisja vendore, pavarësishët nga sistemi politik dhe mënyra e krijimit dhe e funksionimit të tij, organizimi i pushtetit vendor ndërtohet si rregull në një, por në raste të shumta në dy e më shumë nivele, mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të vendit. Në sistemin demokratik organet e pushtetit vendor janë të pavarura dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tij e bënë efektiv në realizimin e misionit vetëqeverisës, për të përballuar problemet vendore. Strukturat administrative e të dy dy pushteteve kanë si objekt të përbashkët pikërisht çuarjen e shërbimeve cilësore tek banorët, duke e shtrirë veprimtarinë e pushtetit lokal në territorë të përcaktuara dhe funksionale për realizimin e detyrave (Keith, L. Miller. 2002).


Figura 3 Skema e decentralizimit dhe dekoncentrimit të shërbimeve publike



Burimi: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Njesitë e qeverisjes vendore⁷ janë bashkitë niveli I-rë dhe qarqet, niveli i dyte. Njësia vendore bazë (bashkitë): është niveli i parë⁸ dhe përfaqëson një unitet administration-territorial dhe bashkësi banorësh në zona rurale dhe në zona urbane. Organi përfaqësues i bashkisë është Këshilli i bashkisë, ndërsa organi ekzekutiv është Kryetari i bashkisë. Të dy këto organe janë të zgjedhura në zgjedhje të përgjithëshme, me votën e fshehtë të komuniteteve të saj. Nëndarjet në komunë quhen fshatra dhe në raste të vecanta qytete⁹. Përcaktimi i territorit të nëndarjeve bëhet nga këshilli i bashkisës. Nëndarjet e bashkisë në zona urbane quhen lagje. Lagjet krijohen në teritore me mbi 15,000 banorë më vendim të këshillit bashkiak. Kur bashkia përfshin zona rurale, nëndarja quhet fshat. Fshati krijohet në një territor më mbi 200 banorë. Qytet, shpallet një qendër banimi e cila ka një plan perspektiv zhvillimi urban të miratuar. Shpallja e qytetit bëhet më ligj.

Figura 4 Struktura organizative e njesise vendore(komune,bashki),



⁷Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ,neni 108,fq .37.

⁸ Fletore zyrtare Nr.25,dt.31.07.2000.fq.1271

⁹ Po aty,neni 5,fq.1271

Qarku¹⁰: është njësi e nivelistët të dytë të qeverisjes vendore, qarku përfaqëson një unitet administrativë- territorial, të përbërë nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkëta. Shtrirja territoriale, emri dhe qëndra e qarkut përcaktohen me ligj.

Proçesi për decentralizimin e pushtetit vendor, në vitin 1999 shënon një hap të rëndësishëm me shpalljen e Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit dhe të Autonomisë lokale, dhe miratimin e ligjit Nr. 8652, dt. 31.07. 2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

Ky ligj suprimoi rrëthet (Shqiperia kishte 36 rrëthe) deri atehere si niveli i dyte i organizimit të pushtetit vendor dhe miratoi krijimin e 12 Qarqeve si nivel i dytë në të gjithë Shqipërinë. Pavarësisht suprimimit të rrëthit si nivel i dytë, ai dhe sot e kësaj dite e kryen mirë funksionin e vet në raporte me afrimin e shërbimeve qëndrore të dekoncentruara, si për administrimin e tyre dhe afrimin tek qytetarët.

Qarku si funksion të vet ka hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, ushtrimin e funksioneve të deleguara nga disa njësi të qeverisjes lokale, brenda rajonit të qarkut, si dhe të funksioneve të deleguara nga qeverisja qëndrore. Burimet Financiare të qarkut janë të ardhurat e veta, nga ndarja e të ardhurave kombëtare, si dhe transfertat e kushtëzuara e të pakushtëzuara për funksione dhe kompetenca të deleguara, tarifa për shërbime në nivel qarku.

¹⁰Po aty

Misioni i pushtetit vendor

Misoni i pushtetit vendor përcaktohet nga neni 3 i ligjit¹¹ “për funksionimin dhe organizimin e pushtetit vendor”, duke përcaktuar qëllimin e ekzistences së tij. Pushteti vendor në republikën e shqipërisë siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: Njohjes së ekzistencës dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; Respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në kushtetutën ose në ligje të tjera; Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të sherbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; Ushtrim efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizim të detyrave nga organet e qeverisjes vendore; Realizim të shërbimeve në forma të përshtatshëme; Nxitjen efektive të pjesemarrjes së bashkësive në qeverisjen vendore.

3.1.2 Parimet e Organizimit dhe Funksionimit të Pushtetit Vendor në Shqipëri

Ndryshimi i sistemit politik në Shqiperi solli si domosdoshmeri riorganizimin e pushtetit vendor për tu pershtatur me keto ndryshime si dhe për ta organizuar ate mbi baza demokratike, sipas koncepteve të “Kartes Europiane e Autonomise Vendore”. Në përgjithësi jo vetëm vendi jone por, të gjitha vendet ishkomuniste e bënë riorganizimin e qeverisjes vendore. Parimet e organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore përcaktohen nga Kushtetuta¹² e vitit 1998 miratuar nga parlamenti si dhe në bazë të ligjit¹³, 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

1. Autonomia vendore: shprehet me autoritetin e pavarur të njësive vendore për të marrë nisma në dobi të komunitetit. Autonomia përbën një të drejt politike, e cila pasqyrohet

¹¹ Fletoer zyrtare,Nr 25,dt. 31.07.2000,fq.1270

¹² Kushtetuta e Republikës së Shqiperise,Pjesa e gjashte,v 1998,fq. 37-39

¹³ Fletore Zyrtare Nr.25,dt.31.07.2000.

tek autoriteti ligjor i organeve të qeverisjes vendore, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimine kompetencave.

- a) E drejta e qeverisjes: kjo e drejt i jep mundësi njësisë vendore për tu organizuar si institucion i pavarur në vendimarrje.
- b) E drejta e pronës: e drejta e pronësise ushtrohet nga këshilli i Bashkisë si organe përfaqësues, dhe nuk mund ta delegoje këtë të drejt askujt tjetër.
- c) E drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe e shpenzimeve: njësit e qeverisjes vendore krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përbushjen e funksioneve.
- d) E drejta e kryerjes së veprimtarise ekonomike: për të realizuar shërbime në interes të komunitetit që përfaqësojnë ushtrojnë veprimitari ekonomike.
- e) E drejta e bashkëpunumit: njësit vendore për të përbushur interesat e komuniteteve mund të bashkëpunojnë me dy e me shumë njësi të tjera vendore.
- f) Edrejta e personit juridik: si person juridik, njësit e qeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil.
- g) Të drejta të tjera: japidit tituj nderi dhe stimuj, vodosin emërtimet e objekteve dhe institucioneve nën juridikacionin e tyre, sipas kriterit të përcaktuar me ligj.

2. Subsidiariteti¹⁴: është një parim shumë i rëndësishëm i Kartës Europiane, i cili nënkupton sigurimin e shërbimeve në kohë e me cilesi të lartë komunitetit, në një nivel pushteti sa më afër banorëve.

3. Respektimi i kushtetutës dhe legjislacionit në tërësi: duke qënë se organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor ka autonomi të njohur nga kushtetuta dhe legjislacioni.

¹⁴ "Karta Europiane e Autonomise Vendore", botim I Keshillit te Europe, Strasburg, shkurt 1991

4.Sigurumi i vazhdimësisë: nëpërmjet organeve të zgjedhura me ligj, e cila nënkupton, vendimet dhe projektet në vazhdimësi nuk priten nga ndërimi i mandatit.

3.1.3 Përbledhje Teorike e Momenteve më të Rëndësishme Historike të Reformimit Admimistrativo - Territoriale

1912 – 1924

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga Perandoria Osmane, qeveria shqiptare pranoi organizimin administrativ të sankzionuar në “Kanunin e Përshtatshëm të Administratës Civile të Shqipërisë” të shpallur më 22 nëntor 1913, sipas të cilët vendi ndahej në prefektura me në krye prefektin. Më tej ishin nënprefekturat të drejtuara nga nënprefekti dhe krahina e drejtuar nga krahinori. Prefekturat ishin tetë: Berati, Dibra, Durrësi, Elbasani, Gjirokastra, Korça, Shkodra dhe Vlora.

1925 - 1945

Organizimi dhë funksionimi i administratës vendore u përcaktuan sipas “Ligjit organik të bashkisë” të miratuar më 1921 dhë më pas, me Kodin Civil të miratuar në shkurt të vitit 1928. Njësia fillestare ishte fshati që drejtohej nga kryeplaku, i cili përgjithësisht zgjidhej nga mbledhja e popullit të fshatit. Bashkia ngrihej në qytete ose qendra rurale banimi me mbi 200 familje. Bashkia kishte në krye këshillin bashkiak të zgjedhur nga populli për çdo tre vjet. Bashkia drejtohej nga kryetari i zgjedhur nga populli. Në vitin 1928 u shtua edhe komuna si njësi e administrimit vendor. Ajo përfshinte disa fshatra dhe drejtohej nga kryetari, pranë të cilët qëndronte këshilli i komunës i përbërë nga kryepleqtë e fshatrave. Nënprefektura ishte njësia administrativo-territoriale me funksione civile administrative. Prefektura ishte njësia më e madhe e qeverisjes vendore e drejtuar nga prefekti, i cili emërohej nga Ministri i Brendshëm dhe aprovohej nga Presidenti e më pas nga Mbreti. Prefekti kishte funksione ekzekutive. Në prefekturë e nënprefekturë

mungonin organet e zgjedhura. Këshilli Administrativ i prefekturës përbëhëj nga shefat e zyrate dhe nga disa (si rregull 2) anëtarë të zgjedhur nga populli për dy vjet. Këshilli Administrativ dekretohej nga Ministri i Brendshëm. Paralelisht më përpjekjet e mbretit Zog për centralizimin e vendit, ndryshime të ndjeshme u bënë dhe në administratë. Në fillim të vitit 1930, administratat vendore u riorganizuan duke siguruar një kontroll më të madh mbi to. Ligji mbi shpalljen e komunave ishte emëruar “Ligja mbi Katundarin u miratua në 11 prill 1929¹⁵, komuna të formuara më vete dhe komuna të formuara nga bashkimi i disa fshatrave, të parat me mbi 2500 banorë dhe të dytat me fshatra të bashkuara, që nuk ishin largë nga njëri-tjetri jo më shumë së 15 km. Struktura e pushtetit lokal ishte: Prefektura, nënprefektura, bashki për qytetet, komuna për fshatrat. Në vitin 1927 Shqipëria kishte 10 prefektura, 39 nënprefektura, dhe 69 krahina me 2351 fshatra. Në vitin 1934 kishte 10 prefektura, 30 nënprefektura, 160 komuna me 2351 fshatra. Në vitin 1940 kishtë 10 prefektura, 30 nënprefektura, 23 bashki, 136 komuna dhë 2551 fshatra.

1945 - 1992

Pas vitit 1945, u bënë shumë ndryshime në strukturën e ndarjes administrative dhe në numrin e çdo elementi strukturor të kësaj ndarjeje. Në vitin 1945 u ruajt ndarja administrative me 10 prefektura dhe 61 nënprefektura, por u suprimuan komunat dhe bashkitë. Në vitin 1946 u bë ndarja e re administrative me 10 prefektura, 39 nënprefektura dhe u fut në mënyrë të pjesshme lokaliteti. Në vitin 1947 lokaliteti mori përparësi duke zëvendësuar komunën. Kështu, ndarja përbëhej nga prefektura, rrathi, lokaliteti me fshatra e qytete. Në vitet pas Çlirimt pushteti vendor ishte i centralizuar

¹⁵ Mbreti Zog dhe perpjekja për stabilitet, ne shqiperi, Bernard J. Fischer, Botim Cabej 2004, pq. 184

administrata u organizua me ligjin Nr.684, dt.11.03.1949, prefektura, nënprefektura, rrrethe (qytetet), lokalitete (fshatrat).

Në vitin 1953 qarku zëvendësoi prefekturën, kjo ndarje e re përfshinte dhjetë qarqe. Brenda qarqeve u caktuan 26 rrrethe dhe çdo rrreth kishte tre ose më shumë lokalitete.

Në mes të viteve '50 u bë riorganizimi i ndarjes administrativo-territoriale në katër qarqe, me nga 3-4 rrrethe në çdo qark. Ndarja vazhdoi me lokalitetet, fshatrat dhe qytetet.

Në korrik të vitit 1958 u suprimua qarku dhe u krijuan 26 rrrethe. Qyteti i Tiranës ruajti nivelin e rrrethit. Sipas kësaj ndarje, kishte 26 rrrethe, 203 lokalitete, 2655 fshatra, 39 qytete dhe disa nga këto kishin lagje.

Pas vitit 1967 shfaqet emërtimi i ri fshati i bashkuar, kjo lidhej me organizimin ekonomik të ndërmarrjeve bujqësore. Në vitin 1968 kishtë 26 rrrethe, 437 fshatra të bashkuara, 2641 fshatra, 65 qytete dhë 178 lagje qytetesh.

Në vitin 1990 kishte 26 rrrethe, 539 fshatra të bashkuara, 2848 fshatra, 67 qytete, 306 lagje qytetesh. Qyteti i Tiranës përbëhëj nga 3 rajone, të cilat përfshinin disa lagje.

1992 - 2013

Në vitin 1992, në bazë të nëniti 1 të ligjit nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhë funksionimin eë pushtetit lokal” Këshilli i Ministrave në qershor 1992 bëri ndryshime në ndarjen administrativo-territoriale. Ai përcaktoi 36 rrrethe, 44 bashki dhe 313 komuna. Në nivel rrathi, bashkie dhe komune u ngritën këshillat lokalë më të zgjedhur nga populli dhe kryetarët e bashkive dhe komunave si organ ekzekutiv të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Më pas, në bazë të ligjit nr.7608, dt.22.09.1992 “Për prefekturat” u krijuan 12 prefektura si njësi që drejtohen nga prefekti i emëruar nga Këshilli i Ministrave. Çdo prefekturë përfshinte 2 - 4 rrrethe. Nga viti 1992 deri në vitin 2000 janë bërë disa

ndryshimë të pjesshme në ndarjen administrativo-territoriale pa ndryshime strukturore. Në vitin 2000 Shqipëria kishte 36 rrethe, 65 bashki dhe 309 komuna. Në vitin 2000 me ligjin nr.8653, dt.31.07.2000 u suprimuan rrethet si njësi administrative dhë u krijuan rishtas qarqet. Pas vitit 1992, bashkitë ngrihen me bazë qyteti.

Disa karakteristika

Duke analizuar zhvillimet në ndarjen administrativo-territoriale të Shqipërisë pas vitit 1945, mund të vëmë re se:

- Numri i prefekturave dhë i qarqeve ka mbetur thuajse i njëjtë (nga 10 në 12).
- Me krijimin e qarqeve në vitin 2000 u suprimuan prefekturat si njësi territoriale.
- Numri i fshatrave të bashkuara, qyteteve, komunave dhe bashkive ka pësuar ndryshime të shumta për arsyen nga më të ndryshmet.
- Numri i rretheve për afro 40 vjet ka qënë konstant. Në 10-vjeçarin e fundit është rritur numri i rretheve me 10 rrethe të reja.

3.1.4 Analize dhe Hulumtim i Reformës Administrativo – Territoriale në Shqipëri e Vitit 2013-2015

Në Ligjin Nr.30 Per Qeverisjen Vendore – “Nr. 30/ 2015 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 8652, Datë 31.7.2000, “Për Organizimin dhe Funksionimine Qeverisjes Vendore”, të Ndryshuar.”

3.1.4.1 Një Reformë Gjithëpërfshirëse

Strategjia Ndersektoriale E Decentralizimit 2015-2020 i jep përgjigje pyetjes: pse u ndërmorr reforma për ndarjen e re Administrativo – Territoriale?

Në vitin 2013 u mbajt një konferencë me temë: “Ndarja e re Administrativo - Territoriale fuqizon ekonominë”, Argumenti “Situata aktuale e strukturës administrative territoriale ishte pengesë për decentralizimin e plotë të shërbimeve e përgjegjësive si rezultat i mungesës së kapaciteteve e mos-garantimit të ekonomisë së shkallës, pra eficiencës ekonomike në ofrimin e funksioneve, duke shërbyer kështu edhe si kundër argument për demokratizimin.” (Relacion Për Projektligjin “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale Të Njësive Të Qeverisjes Vendore Në Republikën E Shqipërisë”, Ministria E Brendshme, 2014). Më tej akoma, në propozimin e projektligjit në parlament shkruhet në mënyrë eksplikite: “Reformat administrativo – territoriale nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë, disa më pak, e disa më shumë, përgjithësisht qeveritë e tranzicionit, dështuan në sfidën e menaxhimit të territorit.

U dështua në adresimin e sfidës së kuptimit të:

1. socio-demografisë së vendit, për ta kthyer atë në një aset zhvillimi;
2. sfidës së analizës statistikore të këtyre dallgëzimeve demografike dhe tensioneve social - ekonomike, për t'i menaxhuar dhe transformuar në forca ndërveprimi social.
3. U dështua në sfidën e cilësisë, për të gërshetuar në qasjen ndaj trupit të vendit,
4. efektivitetin dhe eficencën e një bashkëpunimi sa më të gjërë,
5. për të pasur sa më shpejt rezultate të prekshme nga qytetarët në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.” (Parlament, Prill 2014)

Si u arrit të ngrihej reforma për ndarjen e re Administrativo – Territoriale?

Sipas Ministrisë së Çështjeve Vendore (2015) në konsultimet e planifikimit të reformës territoriale u përfshinë 20,341 qytetarë, përfaqësues të institucioneve publike dhe agjencive të

pavarura, qeverisë vendore, shoqërisë civile, sektorit privat, medias si dhe organizatat dhe programet ndërkontinentale (Ministria E Cështjeve Të Brendshme, 2014).

Nëse i referohemi: Projektit “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale Të Njësive Të Qeverisjes Vendore Në Republikën E Shqipërisë” (23 Korrik, 2014), citohet se më këtë ligj shfuqizohet, ligji nr.8653, datë 31.7.2000 “*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar dhe me ligjin nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”,

Cfarë është zona funksionale? Le ti referohemi, Ministrisë së Brendshme (Korrik, 2014), koncepti i “zonës funksionale” do nënkuqtojë një hapësirë territoriale ku ka një *ndërveprim* të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. Në këtë kuptim “**zona funksionale**” është njësia vendore e organizuar rrith një *qendre urbane* që ka numrin më të lartë të popullsisë, krahasuar me qendrat e tjera brenda zonës dhe ka mundësi për ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve publike që duhet të ofrojë një njësi vendore, duke zbatuar edhe eficencen e “ekonomisë së shkallës”.

Çdo njësi e re e qeverisjes vendore bazuar në konceptin e “zonës funksionale” duhet të garantojë funksionimin e njësisë vendore duke filluar nga ekzistanca minimalisht e një *qendre urbane* që të ketë:

1. **infrastrukturën** e nevojshme social-ekonomike si psh. ekzistencën e rrjetit të shkollave, spitaleve, qendrat e kujdesit social, shërbimet e policisë, të shërbimit zgjarrfikës, të shërbimeve të transportit interurban, të shërbimeve shtetërore apo private në funksion të qytetarëve dhe bizneseve, si degët e tatimeve, postave, të rrjetit bankar etj.,

2. **zhvillimin policentrik** të njësive të qeverisjes vendore, që presupozon së brenda NJQV-së ekzistojnë disa qendra zhvillimi përtej qendrës kryesore urbane.
3. shkëputet njëherë e mirë nga koncepti aktual i **ndarjes artificiale** të zonave urbane dhe atyre rurale në bashki apo komuna.
4. Njësitë e reja vendore nën këtë koncept presupozohen si hapësira administrative të mëdha nga pikëpamja e territorit dhe popullsisëqë përfshin si zona urbane ashtu dhe zona rurale duke lejuar një harmonizim të politikave zhvillimore dhe duke ulur **pabarazitë e thella** midis zonave urbane dhe rurale.
5. “Zona funksionale” lejon gjithashtu ofrimin e **shërbimeve me cilësi të njëjtë** për banorët e zonave urbane dhe rurale duke garantuar “ekonominë e duhur të shkallës” për ofrimin e shërbimeve publike.
6. Analizat dhe studimet paraprake tregojne së “zonat funksionale” përkojnë apo dhe në shumicën e rasteve mbivendosen me territoret administrative të ish-rretheve.
7. Të dhënat statistikore tregojnë gjithashtu së bashkitë qendër rrëthi janë edhe qendrat e gravitetit ekonomik, social dhe të shërbimeve publike në pjesën më të madhe të vendit dhe mbeten pike referimi në politikat zhvillimore dhe në arritjen e ekonomisë së shkalles.

Nga pikëpamja e qeverisjes vendore “rrëthi” si njësi administrative:

1. ish-rrethet identifikohen në ligjin organik të qeverisjes vendore si koncept i nëndarjes administrative të Qarkut apo edhe në shpërndarjen e shërbimeve të dekoncentruara të ministrive të ndryshme.
2. “ish-rrethet” vazhdojnë të kenë edhe sot një rol referues

3. qartazi njihet si përbashkues i identitetit kulturor dhe tradicional të banorëve.
4. shkak së bashkitë kryesore sot janë të vendosura në qendrat e ish-rretheve
5. mund të ofrojë të gjithë gamën e shërbimeve publike për të gjithe qytetaret e saj,
6. duke mbajtur parasysh ate çka synohet: konsolidimin territorial apo thënë ndryshe zmadhimin e NJQV-ve aktuale për të siguruar performancë më të mirë të funksioneve dhe cilësi në ofrimin e shërbimeve.

3.1.4.2 Argumentat Pro Reformës dhe Kriteret

1. Pra një nga modalitetet e sugjeruara është që koncepti i “zonave funksionale” ta fillojë zbatimin nga territoret administrative të **ish-rretheve**. Nga pikëpamja e qeverisjes vendore “rrethi” si njësi administrative nuk është më i zbatueshm si nivel organizimi administrativ, por
 - a. ish -rrethet identifikohen në ligjin organik të qeverisjes vendore si koncept i nëndarjes administrative të Qarkut apo edhe në shpërndarjen e shërbimeve të dekoncentruara të ministrive të ndryshme.
 - b. Gjithashtu qartazi në memorien institucionale dhe të komuniteteve, “ish-rrethet” vazhdojnë të kenë edhe sot një rol referues.
 - c. Rimarrja e konceptit të madhesise territoriale të “rrethit” do të ishte alternativë shumë e mirë për shkak së bashkitë kryesore sot janë të vendosura në qendrat e ish-rretheve.
2. Kriteri tjetër i propozuar lidhet me **distancën e qendrës së NJQV-së me territorin**.

- A. Nga një anë kjo distancë nuk duhet të jetë e tillë (SHUMË E MADHE) sa të pengojë ofrimin e shërbimeve për komunitetin,
- B. por nga ana tjetër nuk mund të krijohen NJQV të reja nëse ato gjenden shumë pranë NJQV të tjera, të cilat mund të ofrojnë më mirë shërbimet.
- C. Po ashtu NJQV-të në ndarjen e re do duhet të përfshinin të gjitha ato territoret kufitare që për nga afërsia janë më pranë qendrës së saj administrative sesa qendrat e NJQV të tjera.
3. Një tjetër kriter i rëndësishëm është parimi i vazhdimësisë territoriale. Ky parim nënkuption që territori i një njësie të qeverisjes vendore është i vazhdueshëm dhe nuk ka „ishuj” territorialë që i përkasin një njësie tjetër vendore.
4. Kriteri I **numrit të popullsisë** rekomentohet të jetë si një kriter referues për NJQV-të e reja të propozuara. Duke marrë parasysh gjeografinë e territorit dhe shpërndarjen e popullsisë do ishte e rekmandueshme që NJQV-të e reja të kenë një numër të konsiderueshëm banorësh, që mund të nënkuptojë një popullsi mesatarisht mbi *30.000 banorë* në zonat me densitet të lartë popullsie, mbi *20.000 banorë* në zonat me densitet të mesëm popullsisë dhe mbi *10.000 banorë* në zonat me densitet të ulët popullsie.
5. Kriteri i rëndësishëm (dhe kërkosë ligjore) është edhe garantimi i lidhjeve historike dhe tradicionale të NJQV-ve të reja.

3.1.4.3 Problemet me Ndarjen e Vjetër

1. Ndryshimet demografike- Rreth 2/3 e NJQV-ve pësojnë një ndryshim të popullsisë me rrëth 25%. Kjo lëvizje ka patur efektet e saj në njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri, një pjesë prej të cilave është dashur të akomodojë nevojat në rritje të

banorëve për shërbime, ndërsa një pjesë e njësive vuajnë pasojat e largimit të banorëve të tyre.

2. Fragmentimi i nivelit vendor të qeverisjes
 - a. *ofrimit të shërbimeve*- 235 NJQV (63% e NJQV-ve) rezultojnë me një dendësi të popullsisë më të ulët se mesatarja nënivl vendi prej 97,4 banorë/km² (INSTAT, Census 2011).
 - b. ashtu edhe përsa i pëket **përfaqësimit demokratik** – ndërkohë që 45% e popullsisë përfaqësohenet prej 18 kryetarëve të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe 620 keshilltarëve të zgjedhur në sistemin proporcional (I referohemi NJQV-ve me më teper se 20,000 banorë).
 - c. Madje më tepër së vetë fragmentimi ajo që tërheq vëmendjen është madhësia shumë e variueshme e NJQV-ve, në sipërfaqe, popullsi dhe sidomos në dendësi. 35 NJQV (63% e NJQV -ve) rezultojnë me një dendësi të popullsisë më të ulët së mesatarja në nivel vendi prej 97,4 banorë/km² (INSTAT, Census 2011),
3. Mungesa e eficiencës në ofrimin e shërbimeve nënivl vendor - Duke iu referuar të dhënavë të Ministrisë së Financës për vitin 2012, vemë re së 70 NJQV (19% e totalit) nuk kanë bërë asnjë shpenzim për investimet gjatë vitit 2012, shpenzojnë 27% të buxhetit të tyre për investime kapitale dhe 37% për pagat e punonjësve.
4. Pamundësia për të nxitur dhe mbështetur zhvillimin ekonomik vendor dhe niveli i lartë i pabarazive mes njësive të qeverisjes vendore.

3.1.4.4 Reforma Administrativo – Terroriale në Shqipëri: Post Reformim

Por, si mund të matet ndikimi i reformës administrative në zhvillimin e pushtetit vendor?

Shteti shqiptar ka mekanizmin e auditit që zhvillohet nga KLSH-ja.

Nga auditet e KLSH del në pah së Shqipërisë i nevojitet ndarja administrative, duke u bazuar në evidenca të qarta mbi studime të eficiencës dhe efektivitetit të njësive vendore në realizimin e objektivave për rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit. Ky pohim dëshmon së pyetja e duhur nuk është: “A kishte nevojë Shqipëria për një reformë administrativo territoriale?”, por “A po bëhet sic duhet reforma administrativo territoriale në Shqipëri?”

KLSH auditon zbatimin e politikave por nuk krijon politika.

Sipas KLSH-së ka rezultuar së reforma administrative – territoriale ka sjellë ngadalësim të shërbimeve vendore. “Nuk janë kryer në cilësinë e duhur shërbimet ndaj qytetarit”.

Nga ana tjetër një shkrim i gjërë argumentues dhe meditues është: “Reforma E Ndarje Administrative” nga Niko Nako (2013). Ky studiues e hap punimin e tij me fragmentin: Jo bashkime mekanike dhe aritmetike.” Autori rendit një sërë arsyesh për të argumentuar qëndrimin e tij kundër. Së pari, sipas tij asnjë institucion përgjegjës nuk ka mare përsipër dhe të sqarojë opinionin publik, komunat dhe bashkitë që do bashkohen.

Nëse i referohemi draft studimeve dhe draft – sugjerimeve për reformën nga ana e komisionit të reformimit rezulton, se vërtet dobia e uljes së kostos është trajtuar por vetëm në terma teorikë dhe jo me demonstrime të evidencave dhe parashikimeve shifrore financiare.

Së dyti, autori pohon së të ardhurat lokale edhe pas reformimit do vuajnë mënyrën e organizimit dhe mungesën e strukturave për mbledhjen e të ardhurave, pasi njësitë administrative (rajonet) nuk kanë asnjë kompetencë.

Së treti, autori argumenton së mendohet kryerja e një reforme administrative territoriale do kryhet bazuar në kriterin gjeografik, social dhe kulturor e së fundmi kriterin e numrit të popullsisë dhe kriterin ekonomik.

Së fundmi, autori përmend sipërfaqen e tokave, sipërfaqen e pyjeve, kullotave që ka komuna në pronësi, ujerat dhe kanalet që përdoren për vaditje, pa përmendur këtu numrin e blegtorisë dhe faktorë të tjera që mund të dalin gjatë procesit të bashkimit.

Të gjitha këto cështje nuk janë adresuar ende nga institucionet përgjegjëse për performancën e reformës së implementuar.

3.1.4.5 Variantet e Qeverisës për Ndarjen e re Territoriale

Argumentat në favor të konsolidimit territorial, që con në krijimin e njësive të medha rajonale, janë si me poshte:

- ✓ Krijohet një ekonomi e shkallës, e cila mundëson që njësitë më të mëdha të qeverisjes vendore të ofrojne shërbime me kosto më të ulta.
- ✓ Duke qenë së njësi më të mëdha të qeverisjes vendore mund të ushtrojnë më shumë funksione, ka më shumë mundesi që qytetaret të jenë të interesuar të marrin pjesë në proceset politike.
- ✓ Një organizim territorial me njësi më të medha të qeverisjes vendore krijon më pak pabarazi në të ardhurat e bashkive.

- ✓ Njesi më të medha të qeverisjes vendore mund të jenë më efektive në planifikimin dhe politikat për zhvillim ekonomik.
- ✓ Në sisteme të konsoliduara territoriale është më e lehtë që të adresohen çështjet e përfituesve (free-riding), dmth, situatë kur banues që jetojne në një njësi të qeverisjes vendore konsumojnë shërbime që ofrohen dhe nga një njësi tjetër vendore.

Këto argumentë të lartë- përmendur janë shqetësimë të shprehura nga drejtues të njësive vendore, në bazë të studimit “Reforma territoriale në Shqiperi”, për Shoqatën e Komunave të shqipërisë me fonde nga SIDA, botim i vitit 2012.

Co – Plan i prezantuar përpara Ministrit të Shtetit për Çështjet vendore, së bashku me Programin e Zhvillimit Rajonal (RDP) dhe institutin për Zhvillimin e Habitatit, dy harta administrative të territorit të Shqipërisë. Në hartën e parë, Dritan Shutina si drejtor i studios propozoi një ndarje në 4 rajone të mëdha të vendit ne: Rajonin e Veriut, ku Qarkut aktual Shkoder i bashkohet Qarku i Lezhës, Kukësit dhe Peshkopisë; Rajoni Qendror ku Qarkut të Tiranes i bashkohet Durrësi dhe Elbasani; Rajoni Lindje - Perendim, ku Qarkut të Korçës i bashkohet Qarku i Beratit, Fierit, Lushnjës; dhe Rajoni i Jugut në të cilën përfshihet e gjithë pjesa jugore e vendit: Vlore, Gjirokastër.

Në Harten e dyte, Shutina propozoi një variant tjetër për ndarje rasonale, në të cilën Shqipëria ndahej në 6 Rajone, duke ju referuar baseneve ujore të vendit në bazë të zonave ujëmbledhëse të lumenjeve më të mëdhenj, të cilët jepin mundësi për zhvillimin e infrastrukturës e për lidhje sociale ekonomike, tradicionale. Këto rajone janë : Rajoni i Drinit, Rajonin Mat- Drin, Rajonin Shkumbin-Erzen, Rajoni i Devollit, Rajoni i Semanit dhe Rajoni i Vjosës. Sipas tij, rajoni është si niveli i dytë i qeverisjes vendore politik -

bërës dhe zbatues, i cili merr kompetenca që tashmë i takojnë pushtetit vendor. Harta zgjedhore në këtë ndarje nuk ka luajtur rol thelbësor. Nuk respektohet ndarja e qartë politike, janë partitë që përcaktojne pushtetin (Shutina, 2014).

Një nga propozimet ishte dhe ndarja rafionale horizontale dhe jo vertikale (Shutina 2014), për shkak se rajoni lindor i shqipërisë është i varfër e me probleme në infrastrukturë dhe një ndarje vertikale do të rriste problemet.

Në debatin për rajonalizimin apo gjendjen aktuale qarqet (Shtetiweb, 2014) argumenton së “Me krijimin e qarqeve si ngrehina burokratike dhe anti-demokratike, u largua pushteti vendor nga populli”, bëhet fjalë për suprimimin e rretheve me kushtetutën e miratuar nga parlamenti Shqiptar në 1 korrik 1989. Rrethi, (shtetiweb,2014) si strukturë solide historike dhe demokratike, ku populli zgjidhte drejtpërdrejtë përfaqësuesit e vet në këshillat e rretheve, mbështetej plotësisht në traditën vendase të pleqësisë dhe të vetëqeverisjes vendore. Rrethi ngjizte harmonishëm fshatin me qytetin, sipas përbashkësisë së interesave ekonomik, tregtar, shoqëror, kulturor, social, juridik, mjedisor e zakonor dhe sigurante shërbimet themelore njëtrajtësisht për të gjithë banorët. Rrënjet e rrethit shkojnë thellë në histori si rasti i Mirditës, Kolonjës (Ducellieri, 1981, fq.94, 98, 100; Xhufi, 2006, fq. 179, 189).

Kalimi nga rrethi si nivel i dytë në qarqe solli vështirësi për marrjen e shërbimeve që më parë merreshin në rrethe, si vendore por dhe qëndrore, kishin të dyja nivelet e shërbimeve të njejtën hapsirë veprimi në terren por dhe në drejtimin administrative të tyre. Shpërndarja e kompetencave të rrethit në komunat dhe qarqet solli keq manaxhim në mjeshtë, pyje,kullota.

Qarku apo kantoni në thelb, është strukture e huazuar nga vendet me tradita të ndryshme, me përberje shumë etnike dhe me sipërfaqe dhe popullsi shumë më të madhe se sa Shqiperia.

Një studim më të plotë prsa i përket ndarjes së Shqipërisë në rajone, e gjejmë në studimin e Profesor Arqile Berxholli (2014,fq 45): “Mendime rreth problemit të morfologjisë së organizimit administrativo -territorial në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë studim ai jep arsyet e vështirësisë së trajtimit të problemit të reformës: *së pari*, ky proces gjithmonë ka qënë në varësi të politikës dhe ideologjisë së tyre përfaqësuese, dhe për shkak të pragmatizmit ata nuk do të heqin dorë nga ndikimi në ndarjen për qëllime elektorale, duke e deformuar procesin; *së dyti*, çdo propozim bie ndesh me Kushtetutën, e cila njeh organizimin e pushtetit vendor në dy nivele: qarqe dhe komuna/ bashki.

Që të ofrosh një alternativë të vlefshme është e domosdoshme që të vlerësosh traditat, mentalitetet, interesat e publikut, veçoritë e mjedisit fiziko - gjeografik, të atij social, mundësitë ekonomike për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë. Nëse do të nisemi që të forcojme urbanizimin e rajoneve do të krijojmë problem në boshatisjen e zonave rurale, gjë që u provua në Greqi në zonën Veriore të saj (Berxhulli,A.Prill 2014:31).

Propozimet e grupeve të interesit

Shoqata e autonomeve vendore në një séancë dëgjimore me komisionin e posaçëm parlamentar, përgjegjës për realizimin e reformës kishte mendimet e veta, por në një

formë unike për kthimin në strukturen e rrëthit. Kjo séance u zhvillua në dt. 29. 04. 2014. Tre ishin idet kryesore që u propozuan në këtë takim¹⁶:

1. Vendi të ndahet në rrethe, sipas modelit shqiptar përpara vitit 1990
2. Për njësitë e vogla apo komunat që do të shkrihen të vendosen administratorë nën varësinë e kryetarit të njësisë funksionale për të ushtruar detyra ekzekutive
3. Në zonat minoritare, administratorët të jenë të zgjedhur nga populli, për me shumë të drejta dhe kompetenca
4. Të ulet numri i këshilltarëve të këshillit bashkiak
5. Anëtarët e këshillave bashkiakë të jenë prefesioniste dhe jo përfaqësues të njësive që do të shkrihen
6. Për zgjedhjen e anëtareve të te këshillave bashkiake të perdoren “listat e hapura” zgjedhore
7. Një pjesë e të ardhurave nga tatim-fitimi i kompanive që ushtrojnë aktivitet në një njësi të caktuar, t'i kaloje buxhetit të kësaj njësie.

Ajo që vihet re në propozimet e kryebashkiakeve, së pari është përdorimi i zgjedhjes së administratoreve në zonat minoritare, por pse kjo duhet të kufizohet vetem për minoritetin kur të gjithë shtetasit sipas kushtetutës duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë? Aplikimi i minibashkive në Tirane është një praktike që për mendimin tim duhej të përdorej në të gjitha njësitë vendore ku do të këtë administrator.

¹⁶ Gazeta panorama, dt. 30.04.2014,fq. 7

Se dyti, propozimi që këshillëtarët bashkiakë të mos jenë nga komunat që shkrihen, është gabim sepse u mohohet e drejta e zgjedhjes¹⁷ gje që është në kundershtim me kushtetuten e vendit.

Se treti, propozimi i administratoreve të emëruar, bie ndesh me Karten Europiane të Qeverisjes vendore duke u hequr qytetarëve të drejten e realizimit të saj nëpërmjet votimit por dhe përfaqësuesëve të vet, nuk mund të këtë vetëqeverisje me emërim nga lart.

Së katërti, për problemet e infrastrukturës që kanë sot zonat rurale si dhe vet problematikat e tjera të mbarsura për pronën, e bëjnë jo funksionale rritjen e madhësisë së njësive vendore deri në shkalle rrithi në përqëndrimin e vendimarrjes, sa probleme mund të trajtojë administrata në ditë, kur distanca dhe mundësia e lëvizjes është e kufizuar.

Ky variant përputhet me variantin e parë të propozuar nga ministri për cështjet vendore Bledi Cuci, në Komisionin parlamentar për reformen.

Ministri i shtetit për çështjet vendore, Blendi Cuci¹⁸ paraqiti disa nga studimet e realizuara gjatë këtyre muajve dhe që konsistonë në ndarjen e re të njësive vendore, duke marrë si bazë ndarjen e vitit 1992 me bazë rrethin. Ndërsa në variantin e dytë, numri i njësive vendore është 39, në variantin e tretë është 47, në variantin e katërt 57, dhe variant i pestë është me 63 njësi. Është për t'u theksuar së në të gjitha variantët e hartës së Shqipërisë së ndarjes së re, minoritetet etnike janë caktuar si njësi vendore në nivel bashkie me vetë, si Bashkia Pustëc (Pogradec me popullsi maqedonase); Bashkia

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqiperise, Neni 45, fq.16

¹⁸ Gazeta Panorama, dt. 17.05.2014, fq.4-5.

livadhja (me popullsi minporitare greke), me komunat që i bashkohen: Mesopotami, Finiq, Aliko, Dhiver; Bashkia Dropull (me minoritet greke) që i bashkohen komunat: Dropull i Siperm, Dropull i Poshtem, Pogon. Në trajtimin e ndarjes së re minoritare është mbajtur parasysh është ajo e vitit 1992 dhe ka pasqyruar të gjitha levizjet demografike, dhe shpërndarjen e popullsisë rurale dhe urbane të vitit 90.

Në vitin 92 nga 26 rrethe që kishtë Shqipëria u bene 36 rrethe dhe duke marrë parasysh propozimin e Kryetareve të Bashkive¹⁹ të drejtuara nga forcat e mazhorances u bën së bashku me zonat minoritare 39 bashki në bazë rrathi. Ndërsa në variantin me 63 zona funksionale krijuhet një bashki e madhe duke bashkuar Himaren me Lukoven. Nga kjo ndarje pritet të reduktohen vetëm në zonën e Tiranes 21% shpenzimet administrative²⁰ dhe personeli, dhe nga miradministrimi i burimeve do të shtohen fondet në masën 45% për investime. Kurse investimet për fryshtë do të rriten në masën nga 2.3 leke në 5.4 leke për fryshtë²¹.

Varianti i pestë: Ndaria administrative-tërritoriale sipas variantit me 63 njësi funksionale.

është përpunim i katër varianteve të para²², ku zonat funksionale shtohen me:

1. Fushë Arrëz, bashkia Fushë Arrëz, Komunat Fierzë, Blerim, Qafë- Mali, Iballe,
2. Klos, Bashkia Klos, Komunat Xibër, Kastriot, Lurë,
3. Belsh, bashkia Belsh, komunat Grekan, Kajan, Fierez, Rasë,
4. Ura Vajgurore, bashkia Ura Vajgurore, komunat Poshnje, Kutalli, Cukalat,
5. Konispol, Bashkia konispol, Komunat Xarre, Markat

¹⁹Po aty

²⁰Po aty.

²¹Po aty.

²²Rëferojuni shtojcës

6. Libohove, Bashkia Libohove, Komunat Qender Libohove, Lunxhëri, Zagori, Odrie, Antigone

3.1.5 Trajtimi i Minoriteteve në Shqipëri

Në përgjithësi në rajonin e Ballkanit problematika është më e pranueshme, për shkak të lëvizjeve të popullsisë në periudha të ndryshme të historive, nën sundimin e perandorive Bizantine dhe Turke. Vetë organizimet e pushtetit të këtyre perandorive kanë krijuar një kulturë rajonale dhe zonale në administrimin e pushtetit. Kjo kompaktësi del në pah, në periudha të hershme nga studiues të huaj. Në sanxhakun e Gjirokastres kishtë 13,178 greqisht-folës, si rrjedhojë mund të themi së ky komunitet ka qenë i organizuar në njësi me vetë administrative. Në periudhën e viteve 1924, sipas dokumentave të kohës së gjetur në prefekturën e Gjirokastres, komunat e Dropullit kanë qënë një nën njësi komunare e përbashkët, pra dhe në kohët më të hershme të shtetit shqiptar ka patur trajtim demokratik të këtij problemi. Por, dhe në periudhen e sistemit totalitar, pas viteve 45 ka patur një trajtim vazhdimësie në ruajtjen e kompaktësise së këtij minoriteti, duke qënë nën një njësi të vetme që quhej lokalitet.

Tabela 2 Tabela e popullsisë në Republikën e Shqiprisë sipas përkatësisë etnike

Perkatësia etnike dhe kulturore	Popullsia banuese	Perqindja e popullsisë banuese
Shqiptare	2 312 356	82,58
Greke	24 243	0,87
Maqedonase	5 512	0,20
Malazase	366	0,01
Arumune	8 266	0,30
Rome	8 301	0,30
Egjiptiant	3 368	0,12
Tjetër	2 644	0,09
Preferoj të mos pergjigjem	390 938	13,96
E pavlefshme	44 144	1,58
Gjithsej	2 800 138	100

Burimi: INSTAT, 2011, fq. 71

Proçeset demokrafike që ndodhen në Shqiperi lane një sistem vendor të fragmentizuar të bazuar mbi ndarjen administrative të kooperativave bujqesore, e cila sot pas kaq vitesh për arsyе të ineficences dhe dobësise financiare duhet rishikuar. Kjo trashegimi administrative dhe tërritoriale është një kusht i fortë për të bere të mundur jo tjetërsimin e kësaj praktike, pavarësisht ligjit që mund të praktikoje mazhoranca.

Sot mazhoranca sipas projektëve të shpallura kërkon si kusht për të qendruar një njësi vendore është numri i popullsise, por në faktë ajo nuk merr parasysh faktoret e tjera, si: mungesen e infrastrukturës, terrenin e vështirë, koston e shërbimeve që rritet me rritjen e largësissë nga qendra, fluksin e shërbimeve të përditshme që rriten, mundësinë për të mbështetur njësitë e reja, si dhe problemet e shumta të komuniteteve. Pra, madhësia e pa studiuar mund të coj në inefektivitet, dhe dështim, si edhe rritjen e problemeve sociale.

Një opinion i përgjithshëm e përcakton rritjen e madhësisë së njësive vendore një proces demokratik, por e ngatërrojnë me decentralizimin, sepse vetëqeverisje do të thotë sa me afér banorëve, gjë që madhësia e humbet. Eshtë tjetër gjë ndryshimi i kushteve politike e shoqërore, ekonomike të cilat mund të sjellin transformim dhe domosdoshmërisht dhe ndryshimin e njësisë vendore.

Vetëqeverisja është një element thelbesor i “Kartës Europiane të Autonomise Vendore”, si qeverisja më e aftë, e realizuar dhe nga Ligjshmeria e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet decentralizimit të pushtetit vendor. Ky proces demokratik është me kuptimplot në rastin e minoritetit. Praktikat e përdorura në Kosovë për të ruajtur vlerat e minoritetit duke mundësuar krijimin e njësive vendore me shumicë, në përshtatje me ligjin e shumicës, është një process demokratik.

3-Analiza e elementit traditës kulturore


Një njësi vendore klasifikohet nga katër elementë bazë: lidhjet tradicionale kulturore, lidhjet ekonomike dhe sociale, terreni unik pa pengesa natyrore, ndër këta elementi i traditës është me shumë për t'u diskutuar. Nga konkluzionet e mësipërme këto dy komuna: Dropulli i Sipërm dhe i Poshtëm kanë një trashëgimi të historisë dhe të traditës së përbashkët.

Përkufizimi i termit kulture është i gjerë dhe i larmishem, një studim i Murphy, Hiderbrandt dhe Thomas (1997) tregojnë se ekzistojne shumë përkufizime, por në përgjithesi, termi “kulturë” i referohet sjelljeve karakteristike të një grupi. Një term tjetër që duhet njojur është “etnocentrizmi”, i cili presupozon gjykimin mbi grupet dhe vëndet e tjera. Të dy komunat e Dropullit të Sipërm dhe të Poshtëm, duke u nisur nga supozimet e mësipërme kanë vecoritë e veta zonale të cilat duke përfaqësuar një grup etnik, krijojnë dallimet dhe të përbashkëta me grupet e tjera shoqërore që i rrrethojnë.

KAPITULLI IV: Metotologjia e Kërkimit

Në zgjedhjen e metodologjisë së punimit, jam bazuar në qasjen epistemologjike konkretisht tek qëndrimet pozitiviste, e cila na jep mundësinë që një dukuri shoqërore mund të vëzhgohet dhe rregistrohet jo mbi të kuptuarin subjektiv (Bob Mathewes dhe Liz Ross, 2010: 25). Kjo metodologji na lejon që dhe vrojtimet për ngjarjet shoqërore, mund të mblidhen dhe të përpunohen, analizohen me metoda statistikore.

Figura 5 Kuadri logjik i Metodologjisë së punimit



4.1 Qëllimi I Punimit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij disertacioni është të analizojë reformën e fundit madhore administrativo – territoriale që ka ndodhur brenda Shqipërisë. Në këtë kontekst, disertacioni kërkon të shqyrtojë korrektësinë dhe funksionalitetin e implemetimit të modelit të përdorur në reformim si edhe karakteristikat kryesore strukturore të koordinimit të qeverisë qëndrore me atë lokale.

Ky hulumtim do të kontribuojë në kuptimin më të mirë të modelit më të përshtatshëm të reformimit administrativo – territorial në Shqipëri.

Ky studim përpinqet të analizojë me baza shkencore qeverisjen administrativo – territoriale nga perspektiva e qarkut të Gjirokastrës, por edhe të shqyrtojë në mënyrë më konkrete reformën që ka përfshirë çdo qark të vendit. Analiza e përqasjeve teorike dhe praktike mbi madhësinë e bashkive kërkon të nxjerrë në pah nëse njësítë aktuale administrativo – territoriale janë të fragmentarizuara dhe të papërshtatshme.

4.2 Objektivat e Kërkimit. Pjetjet e ngritura dhe hipotezat.

Ky punim ka tri objektiva themelore:

- Të matet rëndësia dhe përshtatshmëria e modelit të ngritur nga Ministria e Çështjeve Vendore Shqipëtare për kryerjen e reformës territoriale - administrative.
- Të testohet nëse modeli i zonave funksionale është zbatuar siç duhet në Gjirokastër.

- Të adresohen hendekët e implementimit të modelit të zonave funksionale në Gjirokastër dhe sugjerimi i një modeli alternativ të ndarjes së re administrativ-territoriale.

Disa nga pyetjet që i vijnë në ndihmë arritjes së qëllimit janë :

1. A ka sjell reforma administrativo-territoriale në Shqipëri, rritjen e eficencës dhe thellimin e decentralizimit të pushtetit vendor?
2. A ka rritur reforma performancën e shërbimeve të NJ.Q.V-të e Rajonit të Gjirokastrës?
3. A është i përshtatshëm modeli i “zonave funksionale” në të gjitha njësitë?

Hipotezat që kërkojmë të hetojmë në këtë studim janë:

H1: Modeli i zonës funksionale zbatuar nga Qeveria Shqipëtare është modeli më përshtatshëm për reformimin e pushtetit vendor, rrit të ardhurat/ frymë, zvogëlon shpenzimet administrative/frymë, mundëson thellimin e nivelit të decentralizimit.

H1.a : Rritja e madhësisë së zonës funksionale ka lidhje positive me të ardhurat për frymë, dhe negative me zvogëlimin e shpenzimeve administrative/frymë.

H1.b : Rritja e madhësisë në popullsi dhe sipërfaqes ka lidhje pozitive me thellimin e decentralizimit.

H2 : Performanca e NJ.Q.V-ve të konsoliduara (lidhje ekonomike, infrastruktur shërbimesh, lidhje tradicionale, vazhdimësi terreni) është më e mirë se performanca e NJ.Q.V - ve të të pakonsoliduara.

H3: Hipoteza e tretë, Modeli “Zonës Funksionale” është më i realizuar në bashkitë e konsoliduara sesa në ato të pakonsilodura.

H3.a: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e shërbimeve publike.

H3.b: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e numrit të njësive të biznesit.

H3.c: Rritja e popullsisë ndikon pozitivisht në rritjen e numrit të shërbimeve shëndetësore.

Hipoteza tre nënkupton se pavarësisht reforma aktuale administrativo – territoriale është udhëhequr nga kritere të përshtatshme për realizimin e ndarjes territoriale eficiente, ka vend për përmirësimin e mënyrës aktuale të implementimit të modelit të aprovuar të ndarjes administrativo - territoriale dhe modele alternative duhet të sygjerohen.

4.3 Dizenjimi i Kërkimit

Një studim pilot është një studim i vogël i cili do të ndihmojë dizenjin e studimit të mëvonshëm total. Për qëllime të këtij studimi është kryer një studim në miniaturë për të matur vlefshëminë e studimit. Për këtë punim u krye një studim pilot duke e testuar pyetësorin në një kampion 80%, më e vogël sesa masa e kampionit final të përfshirë në studim. Studimi pilot tregoi se instrumenti i kryerjes së këtij studimi është i vlefshëm dhe se mund të vijonte të implemenohej në një masë më të madhe pjesëmarrësish me qëllim marrjen e rezultatëve më të besueshme.

4.4 Kampioni i marrë në studim

Masa e kampionimit është zgjedhur duke zbatuar parimin e proporcionalitetit. Përbërja e zgjedhjes së mostrës së këtij studimi paraqitet në tabelën si në vijim:

Në tabelën e mëposhtëme paraqitet popullsia totale e ndarë në të gjitha njësitë e pushtetit vendor, vetëm për kategorinë e tretë të kampionit: popullsia masive.

Tabela 3 Tabela e llogaritjes së masës së kampionit për populatën masive në Gjirokastër sipas ndarjeve territoriale.

	<u>POPULLATA E STUDIMIT</u>			MASA E KAMPIONIT
Nr.	Njësit e pushtetit vendor	Popullsia sipas censusit	Pesha	Numri I kampionit të zgjedhjes
1	Gjirokastër	28,673	38.19%	641
2	Përmet	12,127	16.15%	271
3	Tepelenë	8,958	11.93%	200
4	Memaliaj	10,657	14.19%	238
5	Këlcyrë	7,495	9.98%	168
6	Dropull	3,504	4.67%	78
7	Libohovë	3,667	4.88%	82
	TOTAL	75,081.00	100.00%	1678

Burimi: Hysi, 2015

$$n = \left[\frac{z_{\alpha/2} \sigma}{E} \right]^2$$

Përcaktuar në bazë të formulës “ Sample Size”

Në këtë studim në shqyrtimin e hipotezave dhe vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë nuk është marrë në konsideratë gjinia e pjesëmarrësve dhe është marrë parasysh numri i viteve të përvjoes në punë si faktorë të lidhur me kënaqësinë e tyre në punë.

Për të realizuar këtë punim është zgjedhur metoda e kërkimit: metoda cilësore dhe sasiore.

4.5 Pritshmëria

Variablat e zgjedhur për studim janë: faktori ekonomik, aksesi në shërbim, tradita e historisë dhe kulturës së përbashkët, teknikë të përgjithshme, performanca e zonës funksionale. Synimi i punimit është vlerësimi dhe interpretimi i koeficentëve B_1 , B_2 , B_3 , B_4 .

Ndër këto variabla: performanca e zonës funksionale është variabël i varur, lidhjet historike dhe tradicionale, lidhjet ekonomike, akses në shërbime, teknikë e përgjithshme, janë variablat e pavarur. Në fund të analizës do të konkludohet për:

1. Cilat janë kriteret e ndarjes tekniko administrative statistikisht të rëndësishëm për të arritur një nivel sa më efektiv decentralizimi?
2. Si ndikon çdo kriter i ndarjes administrative territoriale tek stimulimi i decentralizimit efektiv?
3. Cilat janë variablat që ndikojnë më pak në decentralizimin efektiv? Pra, cilat janë ato kriterë të cilat nuk janë menaxhuar siç duhet apo që duhet të hiqen nga metodologjia dhe procesi i ndarjes administrative - territoriale?

4. Cilat janë variablat që ndikojnë më së shumti në decentralizimin efektiv? Pra, cilat janë ato kritere të cilat janë menaxhuar siç duhet dhe të cilave u duhet kushtuar prioritet në metodologjinë dhe procesin e ndarjes administrative - territoriale.

4.6 Instrumenti i Mbledhjes së të Dhënave

Konstrukt i pyetësorit të strukturuar të përdorur në këtë studim paraqet lehtësishët dhe qartëson mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve të mbledhura nga ky instrument kërkimi. Një grup i caktuar pyetjesh në këtë instrument kërkimi shërben si indikator në përcaktimin e një modeli të përshtatshëm të reformimit administrativo –territorial. Ai tregohet në shtojcë.

4.7 Justifikimi i Instrumentit të Studimit

Ky seksion është pjesa më e rëndësishme e kapitullit të metodologjisë, pasi i jep përgjigje pyetjes se përse është zgjedhur kjo metodologji dhe jo një tjetër.

Instrumenti i mbledhjes së të dhënave nga kampioni shumë përfaqësues i studimit, është zgjedhur të jetë pyetësori, pasi ai mundëson: (1) objektivat në mbledhjen e të dhënave, (2) të dhëna të strukturuarra dhe të lehta për përpunim dhe (3) përputhjen e qëllimit të kërkimit me atë çfarë i kërkojmë kampionit të studimit.

Pyetja e dytë e rëndësishme e këtij seksioni është: përse pikërisht këto pyetje të pyetësorit dhe jo një gamë tjetër?

A është ky pyetësor i ndërtuar vetë apo një pyetësor i huazuar nga studime të tjera të mëparshme? Si mund ta dijmë vlefshmërinë e tij?

Pyetësori i këtij studimi, është ndërtuar nga zero, vetëm duke u bazuar në kriteret e reformës. Për çdo kriter apo grup kriteresh është ngritur një pyetje dhe më tej ajo është indeksuar për të bërë të matshme performancën (Dong Jim Lim, 2008, 53) e shërbimeve. Arsyja përsë pyetësori nuk u huazua nga studime të mëparshme është së është dëshiruar që të krijohet një instrument tërësisht i dedukuar kontekstit të Shqipërisë dhe reformës së kryer sistemit tonë Administrativo – Territorial.

Më poshtë shpjegohet lidhja ndërmjet pyetjeve të pyetësorit të përdorur për mbledhjen e të dhënave të studimit dhe variablate më të rëdësishëm të identifikuar nga literatura. Ecuria ka qenë e tillë: fillimisht janë identifikuar variablat më të rëndësishëm nga literatura, më tëj janë krijuar indikatorët për matjen e këtyre variablate. Si përfundim këta indikatorë janë transformuar në pyetje për tu integruar në pyetësorin e kërkimit.

Në këtë mënyrë secila pyetje është e mirëbazuar dhe e mbështetur nga literatura

Tabela 4 Indikatorët për përcaktimin e variablate

1=Aspak ; 2=Pak ; 3=Mesatarisht ; 4=Dakort ; 5=Shumë Dakort

		Pyetjet	Përgjigjet				
1.FAKTORËT EKONOMIKË	1	ka ndërmarrje me numër të madh punonjësish që tërheqin njerëz nga NjQV-të e tjera	1	2	3	4	5
	2	punëdhënësit më të mëdhenj janë të vendosur në bashkinë qendër dhe ofrojnë një numër të konsiderueshëm vendesh pune.	1	2	3	4	5
	3	njerëzit në shumicën e rasteve blejnë mallrat e përditshme dhe mallrat jetëgjatë ne NjQV-së ku ata jetojnë.	1	2	3	4	5
	4	njerëzit në NjQV-ku jetojnë shesin produktet e tyre.	1	2	3	4	5
2.AKSESI NDAJ SHËRBIMEVE	1	vendndodhja e spitaleve dhe qendrave më të mëdha shëndetësore është në bashkinë ku jetojnë	1	2	3	4	5
	2	objektet shëndetësore të përdorura më shumë nga njerëzit ndodhen në bashkinë ku jetojnë	1	2	3	4	5
	3	njerëzit zakonisht shkojnë në spital në NjQV-në ku ata jetojnë.	1	2	3	4	5
	4	qendrat shëndetsore të zonave periferike ofrojnë shërbim shëndetësor të reduktuar	1	2	3	4	5
	5	njerëzit zakonisht shkojnë për të ndjekur arsimin e mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) në NjQV-në ku ata jetojnë.	1	2	3	4	5
	6	njerëzit zakonisht shkojnë për të ndjekur arsimin e mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) në NjQV-në tjetër më të afërt dhe jo në NjQV-në ku ata jetojnë	1	2	3	4	5
	7	objektet e ndërtesave të arsimit të mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) Jane, te pershtatshme.	1	2	3	4	5
3.Tradita e historise dhe kulures se perbashket	1	terreni lejon bashkëveprimin ekonomik social dhe kulturor dhe me bashkitë brenda modeli te zonës funksionale rrëth	1	2	3	4	5
	2	kanë histori të përbashket administrative në sisteme të ndryshme politike në njësin ku jetojnë	1	2	3	4	5
	3	Kanë tradita kulturore të përbashkëta në njësin ku jetojnë	1	2	3	4	5
	4	Kanë besim të njëjtë fetar në njësinë ku jetojnë	1	2	3	4	5
	5	Kanë gjuhën e perbashët në njësitë ku jetojnë	1	2	3	4	5
4. TEKNIKE TË PËRGJITHSHME	1	njësia qëndër urbane ka numër më të lartë popullsie, krahasuar me njësitë e tjera në periferi të njësisë qëndër (bashkia qendër).	1	2	3	4	5
	2	njësia qëndër urbane është qëndër graviteti për bashkëveprim institucionl, ekonomiko shoqëror	1	2	3	4	5
	3	njësia qëndër urbane ish rrëth ka infrastrukturë më të volitsh për të afruar shërbime,	1	2	3	4	5

5. Performance e zones funksionale	1	vlerësoni profesionalizmin e personelit të bashkive në trajtimin e problemeve që keni kërkuar zgjidhje në bashki	1	2	3	4	5
	2	merrni të gjitha llojet e shërbimeve ne bashkinë ku jetoni	1	2	3	4	5
	3	vlerësoni cilësin e shërbimeve që merrni në bashkin ku jetoni	1	2	3	4	5
	4	është zvogëluar kostoja për shërbimet që merrni në bashki	1	2	3	4	5

4.8 Variablat

Variablat paraqesin një koncept të matshëm, variabli na tregon se pyetjet për të cilat ne pombledhim të dhëna, kanë një numër të pafundëm dallimesh në dimensione të ndryshme.

Variablat , duke ju referuar tabelës së mësipërme i masim me shkallë Likert-i , të përcaktuar përkatesisht me vlerat nga 1 deri në 5 , ku 1-Aspak , 2-Pak , 3-Mesatarisht , 4-Dakort , 5-Shumë Dakort.

Variablat ndahen në : Variabla të pavarur, janë variabla që mendohet se influencojnë fenomenin që kemi objekt studimi.

Variabla të varur, reagimi i variablave të varur ku duam të shohim dhe të masim në një studim kërkimor.

Çdo pyetje në studimin tonë merret si një variabël, variablat në studimin tonë i ndajmë :

Tabela 5 Tabela e Variablate

V-Variabël I Varur P-Variabël I Pavarur

1.FAKTORëT	1	ka ndërmarrje me numër të madh punonjësish që tërheqin njerëz nga NjQV-të e tjera	P
-------------------	---	---	---

EKONOMIKË	2	punëdhënësit më të mëdhenj janë të vendosur në bashkinë qendër dhe ofrojnë një numër të konsiderueshëm vendesh pune.	P
	3	njerëzit në shumicën e rasteve blejnë mallrat e përditshme dhe mallrat jetëgjatë ne NjQV-së ku ata jetojnë.	P
	4	njerëzit ne NjQV- ku jetojne shesin produktet e tyre.	P
2. AKSESI NDAJ SHËRBIMEVE	1	vendndodhja e spitaleve dhe qendrave më të mëdha shëndetësore është në bashkinë ku jetojne	P
	2	objektet shëndetësore të përdorura më shumë nga njerëzit ndodhen në bashkinë ku jetojne	P
	3	njerëzit zakonisht shkojnë në spital në NjQV-në ku ata jetojnë.	P
	4	qendrat shëndetësore të zonave periferike ofrojnë shërbim shëndetësor të reduktuar	P
	5	njerëzit zakonisht shkojnë për të ndjekur arsimin e mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) në NjQV-në ku ata jetojnë.	P
	6	njerëzit zakonisht shkojnë për të ndjekur arsimin e mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) në NjQV-në tjetër më të afërt dhe jo në NjQV-në ku ata jetojnë	P
	7	objektet e ndërtesave të arsimit të mesëm (profesional dhe të përgjithshëm) Jane, të përshtatshme.	P
3. Tradita e historise dhe kulures se perbashket	1	terreni lejon bashkëveprimin ekonomik social dhe kulturor dhe me bashkitë brënda modeli të zones funksionale rreth	P
	2	kanë histori të përbashkët administrative në sisteme të ndryshme politike në njësinë ku jetojnë	P
	3	Kani tradita kulturore të përbashkëta në njësin ku jetoni	P
	4	Kani besim të njëjë fetar në njësin ku jetoni	P
	5	Kanë gjuhën e përbashkët në njësitë ku jetojnë	P
4. TEKNIKE TË PËRGJITHSHME	1	njësia qëndër urbane ka numër më të lartë popullsie, krahasuar me njësitë e tjera në periferi të njësisë qëndër (bashkia qëndër).	P
	2	njësia qendër urbane është qëndër graviteti per bashkeveprim institucionl,ekonomiko shoqeror	P
	3	njësia qendër urbane ish rreth ka infrastrukturë më të volitsh per te afruar sherbime,	P
5. Performanca e zones funksionale	1	vleresoni profesionalizmin e personelit të bashkive ne trajtimin e problemeve që keni kerkuar zgjidhje në bashki	V
	2	merrni të gjitha llojet e shërbimeve në bashkin ku jetoni	V

	3 Si e vlerësoni cilësin e shërbimeve që merrni në bashkin ku jetoni	V
	4 është zvogëluar kostoja për shërbimet që merrni në bashki	V

Variablat me të dhënrat sekondare për vërtetimin e hipotezës së parë :

Variabla të varur :

- 1.a. Fuqia financiare e pushtetit vendor.
- 1.b. Të ardhurat për frym në NJ.Q.V-të e reja pas reformës.
- 1.c. Kostot administrative në NJ.Q.V-të e reja pas reformës.

Variabël i pavarur , madhësia e zonës funksionale

1.d Grandet specifike për thellimin e nivelit të decentralizimit në të gjitha NJ.Q.V , variabël i varur, variabël i pavarur madhësia e popullsisë dhe sipërfaqes së zonës funksionale.

Variablat me të dhënrat primare për vërtetimin e hipotezës së dytë :

-Variabël i varur performanca e zonës funksionale .

-Variabla të pavaruar : Faktorët Ekonomikë , Aksesi në Shërbime , Tradita Historiko-Kulturore , Teknike e Përgjithëshme.

Variablat me të dhënrat primare për vërtetimin e hipotezës së tretë :

Variabël i pavarur , madhësia e popullsisë ,

Variabël i varur : Institucionet e Shërbimeve Publike , Bizneset , Institucionet Shëndetësore .

4.9 Metodologja Statistikore e përdorur

Teorikisht modelet e regresionit përdoren për të ekzaminuar lidhjet përbërëse, midis variablate në termat e rëndësive krahasuese të variablate të pavarur dhe vlerave të parashikuara në variablat e varur. Studimin e ndikimit të variablate shpjegues mbi variablin e varur e kemi realizuar duke përdorur 2 (dy) metoda statistikore, **regresionin linear** dhe **regresionin logistik** në varësi të të dhënave, bazuar në qasjen epistemologjike pozitivizmi (Bob Matheus dhe Liz Ross, 2010, p.144). Të dhënat e vrojtuara i kemi grupuar në dy grupe:

Grupi i parë, variabla me të dhëna numerike.

Grupi i dytë, variabla me të dhëna ordinale dhe nominale.

Për *grupin e parë* kemi përdorur metodën e regresionin linear, ndërsa për *grupin e dytë* metodën e regresionit logistik.

4.9.1 Ngritja e Modeleve Statistikorë

Testimi i hipotezave statistikore në një studim kërkimor përbën një procedurë shumë me rëndësi. Mbi bazën e tyre mbështeten objektivat kryesorë të kërkimit.

Hipoteza përcakton se çfarë kërkon vëmendje të mëtejshme studimi. Gjithashtu ajo ofron një kornizë për organizimin e konkluzioneve që do të rrjedhin nga studimi.

Marrëdhënen midis variablit të varur dhe variablate shpjegues, në kuptimin e ekzistencës do ta quajmë pozitive nëse koeficientët e regresit janë të ndryshëm nga 0, me një nivel rëndësie të paracaktuar ($p\text{-value} < 0.05$).

Metoda statistikore që kemi ndjekur është kontrolli i hipotezave për ato variabla shpjegues të cilat janë statistikisht të rëndësishëm në model. Pra do të trajtohen në model ata faktorë të cilët nga të dhënat e vrojtuara sigurojnë nivel rëndësie ($p\text{-value} < 0.05$) ose në raste të veçanta ($p\text{-value} < 0.1$).

4.9.2 Vlerësimi dhe Testimi i të dhënave statistikore

Për kryerjen e analizave të nevojshme të mardhënieve , objekt i këtij studimi, jemi mbështetur në këta tregues statistikor:

- *Niveli i signifikancës*, i cili ruan në model vetëm variablat statistikisht të rëndësishëm.
- *Koeficientët e regresionit* me anë të të cilëve provojmë qëndrueshmërinë e hipotezave statistikore.
- “*Odd radios*” me anë të të cilëve kemi arsyetuar shkallën e ndikimit të secilit.

Zgjedhja e modeleve më të përshtatshëm për të bërë analizat e nevojshme është bazuar kryesisht në testet kryesore që matin përshtatshmërinë e modeleve si:

- F-statistikore*, për të testuar përshtatshmërinë e modelit,
- T-test*, për të testuar rëndësinë e lidhjes midis variablate,
- R-katror*, si matës i shpjegueshmërisë së variacionit të rentabilitetit nga variablat e marrë në studim në model.
- Si edhe teste të tjera diagnostikuese që do të vërtetojnë formën e përshtatshme të lidhjes, korrelacionet midis tyre.

Metoda e analizës deskriptive : metodat që kanë të bëjnë me mbledhjen , prezantimin dhe pasqyrimin e të dhënave me qëllim të përshkrimit të karakteristikave të ndryshme të atyre të dhënave në mënyrën më të mirë.

Koeficienti i variacionit tregon raportin e devijimi standart në krahasim me mesataren e të dhënave dhe deviacioni ekstrem tregohet prej vlerave minimum dhe maksimum. Varianca $Sd^2 = \sum (x_i - \bar{x})^2 / n$; Deviacioni Standart $Sd = \sqrt{Sd^2}$; Koeficienti i Variacionit = Sd/\bar{x}

4.9.3 Modeli i regresit linear të shumëfishtë

Qëllimi i metodës së regresit të shumëfishtë është analiza e lidhjes mes variablate të pavarur dhe një variabli të varur. Metoda e regresit kontrollon nëse një lidhje e tillë ekziston, e nëqoftëse ajo ekziston, synon të përdoret informacioni ekzistues për variablat e pavarur, që të përmirësohet saktësia në parashikimin e vlerës së variablit të varur. Për analizën e variablate përdorim mesataren e faktorëve që mdikojne tek variabli i pavarur.

$$Y = \alpha + \beta X + \epsilon$$

α =termi konstant

Y = variabli i varur

$X = X_1, X_2, X_3 \dots X_n$, vektori i variablate të pavarur (shpjegues)

$\beta = \beta_1, \beta_2$, koeficientët e variablate të pavarur (shpjegues)

ϵ = termi i gabimit

Ky është ekuacioni i funksionit të regresionit linear që përcakton lidhjen midis variablate të marrë në studim. Ku α është termi konstant i modelit dhe β është koeficienti i funksionit të regresionit linear. Vlera e funksionit të regresionit linear varet nga koeficientët β , që do të thotë që nëse koeficienti β është negativ atëherë variabli parashikues ose i pavarur ndikon

negativisht tek variabli i varur: një rritje me një njësi në variablin e pavarur do të ulë variablin e varur me vlerën e koeficientit përkatës.

Në të njëjtën mënyrë nëse koeficienti β është pozitiv, variabli i varur do të rritet me vlerën e koeficientit përkatës. a është vlera e konstantes për të cilën parashikohet të ketë variabli i varur nëse te koeficientët β të variablave të pavarur janë të barabartë me 0 (nëse $\beta_1 = \beta_2 = \dots = \beta_n = 0$) atëherë $\mathbf{Y} = a$. Ndërsa ϵ është termi i gabimit, i cili shpreh efektin e të gjithë variablave të tjera, përvèç variablave të varur dhe të pavarur të marrë në shqyrtim në funksionin e regresionit.

Kontrolli i hipotezave për koeficientët β_1, \dots, β_p ndahet në tri kategori: *Së pari* kontrollojmë hipotezën $H_0: \beta_1 = \beta_2 = \dots = \beta_p = 0$ (pra praktikisht që variablat x_1, x_2, \dots, x_p s'ndikojnë në vlerësimin e y). Në regresin e shumëfishtë standart të gjithë variablat e pavarur futen njëkohësisht në model. Vlerësimi i R dhe R^2 përcaktojnë fortësinë e lidhjes mes variablave të pavarur dhe variablit të varur.

Testi **ANOVA** përdoret për të përcaktuar nëse kjo lidhje e përcaktuar nga zgjedhja mund të përgjithsohet, apo jo.

Testi **T-TEST** përdoret për të vlerësuar lidhjen individuale mes çdo variabli të pavarur dhe variablit të varur. Në modelin e regresit, β përcakton shkallën e ndryshimit të Y në varësi të X , kur, vlerat e $X, j = 1, \dots, p, j \neq i$ janë mbajtur të pandryshueshme.

Statistika F paraqet shpërndarjen e shkallës së lirisë, po qe se F është më e madhe se **FKR < F** atherë **Ho** nuk pranohet, pra modeli regresiv ka ndikim statikisht të rëndësishëm mbi varacionin e \mathbf{Y} .

R^2 – është koeficienti i determinacionit (përcaktimit) dhe merr vlera $0 > R < 1$ dhe tregon se si variabli i pavarur shpjegon atë të varur . $R^2 = 0.99 \times 99\%$ sa më e madhe vlera statistikore .

Interpretimi i Regresionit

$$Y_1 = B_1 + B_2 X_2 i + B_3 X_3 i + U_i$$

B2 – mat ndryshimin në vlerën mesatare të Y_i për një njësi të rritjes së X_2 , duke mbajtur X_3 konstant. në dy regresione të thjeshta (dy variabla) vlerësuesit e **B2** dhe **B3** nuk janin parametra të njëjtë si në regresionin multivariabël, sepse nuk mbajanë variabël tjetër konstant. Prandaj përfshijmë të gjithë variablat e pavarur, që mendon se janë me rëndësi në vlerësimin e regresionit. Sa më shumë variabla të përfshihen në model, aq më të saktë jemi.

- Koeficienti i korelacionit të shumëfishtë ρ përcakton masën e lidhjes lineare ndërmjet Y dhe bashkësisë së variablate X . Koeficienti i korelacionit të shumëfishtë merr vlera $0 \leq \rho \leq 1$. Një vlerë zero tregon që Y është I pavarur nga bashkësia X ndërsa një vlerë 1 tregon varësi perfekte lineare, pra që, Y mund të shprehet saktësisht si një kombinim linear i X .
- Për të analizuar fortësinë e modelit të regresit linear të shumëfishtë, përdoret zakonisht ky rregull. Nëse koeficienti i korelacionit është më e vogël se 0.2, lidhja e variablate sipas modelit te regresit konsiderohet shumë e dobët; nëse koeficienti I korelacionit është më i madh se 0.2 dhe më i vogël se 0.4, atëherë thuhet se lidhja sipas modelit të regresit është e dobët, për vlerën e koeficientit nga 0.4 në 0.6 modelimi quhet i moderuar. Modeli i regresit linear quhet i fortë dhe shumë i fortë përkatësisht në rastet kur ky koeficient i korelacionit, i llogaritur si mësipërm, ka vlera përkatësisht nga 0.6-0.8 dhe nga 0.8 në 1.
- Katrori i koeficientit të korelacionit të shumëfishtë përcakton pjesën e variancës së Y që “shpjegohet” nga relacionin e regresit me X .

- Koeficienti i korelacionit të shumëfishtë është jonegativ.
- Koeficienti i korelacionit të shumëfishtë nuk varet nga shkalla e matjes së ndryshoreve të rastit të Y ose X.

4.9.4 Modeli i regresit logistik të shumëfishtë

Analiza e regresionit logistik ekzaminon ndikimin e faktorëve të ndryshëm në një rezultat dikotom duke vlerësuar probabilitetin e ndodhjes së ngjarjes. Kjo realizohet nëpërmjet analizimit të lidhjes midis një apo më shumë variablate të pavarur dhe logaritmit të mundësive (logit) të rezultatit dikotom, duke llogaritur ndryshimet në logaritmin e mundësive të variablit të varur dhe jo të vetë variablit të varur. Logaritmi i raportit të mundësive është rapporti i dy mundësive dhe është një matës përbledhës i lidhjes midis këtyre dy variablate. Përdorimi i raportit të logaritmit të raportit të mundësive në regresionin logistik mundëson një përshtakim më të thjeshtuar të lidhjes probabilitare të variablate dhe të rezultatit në krahasim me regresionin linear, nëpërmjet të cilit mund të ndërtohen lidhje lineare dhe informacion më i pasur.

Fakti që shumica e variablate janë nominal, sigurisht që pengon për analizë regresive empirike sasiore por nuk kufizon mundësitë për një regresion logistik.

Në rastet kur komponenti i rastit merr një numër të kufizuar vlerash, propozohet të përdoret metoda e modelimit të regresit logistik. Në analizën e variablate përdorim të dhenat ordinale dhe numerike të matur në shkallën Likert nga 1-5.

Në këtë model , kur variablat e rastit Y_1, Y_2, \dots, Y_n , janë të pavarur dhe kanë shpërndarje Bernuli (π), lidhja mes x_i dhe π kërkohet në formën :

$$\ln\left(\frac{p_i}{1-p_i}\right) = \beta_0 + \beta_1 x_{i1} + \beta_2 x_{i2} + \cdots + \beta_p x_{ip} = \text{logit } (p_i)$$

Kjo metodë pranon, që variablat në bazë të së cilës ndërtohet modeli, të jenë variabla kategorikë dhe të vazhdueshëm.

- o Nëse tërë variablat që marrin pjesë në modelim janë kategorikë, metoda është shumë efektive.
- o Nëse ndonjë nga variablat e modelit është i vazhdueshëm, ai mund të përcaktohet 'covariate', dhe modelimi bëhet duke punuar me variablin si në rastin e Analizës së Kovariancës .
- o Koeficjentët e kësaj metode përdoren për të vlerësuar raportet e mundësive për secilin nga variablat e pavarur në model, nëse individi, subjekti i takon një grupi të përcaktuar nga vlera të caktuara të variablave të tjera, që marrin pjesë në modelim. Intervalet e besueshmërisë jepin më shumë informacion se sa kontrolli i hipotezave. Një interval për β sigurohet duke u përshtatur statistikën që do të duhej për vlerësimin e testit $H_0: \beta = \beta_0$.

KAPITULLI V : REZULTATE DHE INTERPRETIME

Reforma administrative territoriale është ende në fazën e parë të implementimit, për këtë arsyе nuk ka të dhëna zyrtare të mjaftueshme për të vlerësuar në kuptimin empirik se sa kanë ndikuar dimensionet e reformimit drejt arritjes së objektivit të decentralizimit. E thënë ndryshe është ende shumë herët për të vlerësuar në praktikë nëse reforma administrative – territoriale është efektive dhe e suksesshme. Në këtë fazë në mund të japim vetëm vlerësimë për mënyrën së si po zbatohen në realitet parimet udhëheqëse të procesit të menaxhimit të ndarjeve të reja administrative – territoriale e sidomos për efektet e kësaj reforme. Vlerësimet në vijim dhe vëzhgimet janë të bazuara në të dhënat sasiore nga Prefekitura Gjirokastër në nivel rajonal, dhe në nivel makro nga fletoret zyrtare, për vitet 2014, 2015, 2016. Të dhëna cilësore nga pyetësorët e përdorur për këtë punim në Qarkun e Gjirokastrës. Ky kapitull ka për qëllim që hap pas hapi të hetojë ndikimin dhe rezultatet e reformës së fundit administrative territoriale.

Në vijim do të paraqitet analiza e detajuar statistikore e të gjitha të dhënavë të mbledhura nëpërmjet instrumentit të kërkimit. Hapi i parë do të jetë analiza deskriptive e të dhënavë, për të matur nivelin e secilit prej variablate të integruar në studim. Hapi i dytë dhe më i rëndësishëm do të jetë kryerja e detajuar e analizës së regresionit të shumëfishtë linear duke interpretuar secilin prej indikatorëve të analizës me qëllim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet e ngritura në fillim të këtij studimi dhe për nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse.

5.1 Analizë e situatës post reformës 2016 në nivel makro

Pothuajse po afron dy vjet nga realizimi i reformës administrativo- territoriale, dhe mund të shikojmë disa fakte për anët pozitive dhe negative.

Së pari reforma solli eleminimin e fragmentizimit të njësive vendore, nga 378 njësi në 61 njësi, pas një procesi të gjatë diskutimesh, ku më në fund u zgjidh politikisht në Korrik 2014 me miratimin e ligjit për realizimin e reformës me bërjen e zgjedhjeve në maj 2015. Së dyti sipas burimeve të Ministrisë së Financave për vitet para reformës (2014), pas reformës (2016), kemi disa rezultate për rritjen e peshës së buxhetit të njësive vendore shih,(tabela 6).

Tabela 6 Pesha e buxhetit të NJQV-ve në vite

Viti	Para viti 2014	2015	Pas reforme 2016	Parashikim 2017
Buxheti në %, PBB	2.1	2.3	3.2	3.1

Për periudhën afro një vit e gjysëm kemi, një rritje në 1.1 % të buxhetit vendor në raport me PBB-në. Nga qeveria qëndrore në ato vendore si më poshtë:

Së treti Eshtë rritur grandi i specifikuar për arsyen e transferimit (tabela

- a) Për arsimin parashkollar dhe atë parauniversitar;
- b) Për mbrojtjen nga zjarri;
- c) Për administrimin e pyjeve

Së katërti, grandet vendore janë ulur për arsyen sepse në bashkitë e reja përfshihen zona urbane dhe rurale, por më parë zonat rurale merrnin më shumë grande , sipas një koeficienti për terrenin malor, gjë që s'u transmetua në bashkitë e reja. Kjo ulje tejkaloitet nga shtimi i grandit specifik që u është shtuar bashkive për shkak të kompetencave të reja.

Po të krahasojmë buxhetet në vite shohim se kemi një rritje nga viti 2014 në vitin 2016 prej 13865 në miljon rritje ose 31%.

Tabela 7 Krahasimi në zëra i rritjes së buxhetit pas reformës , në milion

Viti	Buxheti NJQV-ve	Grandi pakuştëzuar	Grandi specifik	Fondi i zhvillimit	Të ardhura të tjera
2014	33,129	19,156	0	0	13,973
2015	41,207	24,644	0	0	16,563
2016	47,201	14,300	7,494	10,000	16,152
2017	49,000	16,300	7,000	9,7000	23,141

Nga tabela e mësipërme shikojmë, që të ardhurat e tjera nga vet pushtetet vendore janë rritur në krahasim me periudhën para reformës, për vitet në 23%. Kjo për shkak të rritjes së fuqisë vepruese të njësive të reja.


5.2 Analiza e Qarkut Gjirokastër në nivel rajonal

Qarku Gjirokastër përbëhet nga Bashkitë: Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Këlcyrë, Libohovë, Dropull, si dhe nga 32 njësi të qeverisjes vendore nga këto: në Bashkinë Gjirokastër 10, në Bashkinë Libohovë 2, në Bashkinë Permet 6, në Bashkinë Këlcyrë 4, në Bashkinë Tepelenë 4, në Bashkinë Memaliaj 6, në Bashkinë Dropull 3.

5.2.1 Analiza e lëvizjeve demografike

Kjo lidhje shpjegohet në tabelën përbledhese të koeficientëve.

Tabela 54 Koeficientët e regresionit , analiza e regresionit linear , Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë


Model	Coefficients ^a						
	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	T	Sig.	95.0% Confidence Interval for B	
	B	Std. Error	Beta			Loëer Bound	Upper Bound
1 (Constant)	2.420	1.777		1.362	.245	-2.513	7.354
Popullesia	.001	.000	.947	5.913	.004	.000	.001

a. Dependent Variable: Institucionet e Sherbimit Shendetesore

$$\text{Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë} = 2.420 + 0.001 * \text{Popullsia}$$

Për të vlerësuar nëse ky model regresioni ishte i vlefshëm apo jo, u ndërmorr analiza ANOVA (shih tab. 7.11, shtojcë). Sipas vlerave që tregohen në tabelë, Nëse të gjithë koeficientët bi janë të barabartë me zero ($H_3.c: \beta_1=0$), hidhet poshtë. Sipas hipotezës $H_3.c$, në ekuacionin e regresionit, koeficienti pranë variablit të pavarur është \neq zero, ç'ka nënkupton se ndikimi i popullsisë në performancën e **Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë** do të jetë i përfillshëm. Në ketë model, $H_3.c$ qëndron. Kjo vërtetohet nga vlera statistikore e treguesit F me shkallë lirie k (numri i variablate të pavarur) dhe $n-k-1$. Pra, vlera kritike e $F(1, 3)= 10.12$. Në modelin tonë, vlera $F=34.967 > 10.12$ rezultoi domethënëse për nivelin e kontrollit 0,05 (sepse $p=0,000$ është më e vogël se 0,05).

Figura 25 Regresioni i Institucionet e Shërbimit Shëndetësorë me Popullsinë



Duke parë grafikun edalim në konkluzion se, sjellja e vrojtimeve faktike ka një qasje shumë të mirë kundrejt vijës së regresionit linear të shprehur ne ekuacionin e mësipërm.

Si rezultat, vlera e R^2 e barabartë me 0.897 është rezultat i shansit dhe variabli i pavarur është ‘i aftë’ për të shpjeguar varacionin në variablin e varur.

Vlerat statistikore t për kontrollin e koeficientëve të regresionit, duke treguar se këta koeficientë janë të ndryshëm nga zero dhe domethënës ($\text{sig.} < 0.05$).

Popullsia $\beta=0.001 > 0$, $p=0.004 < 0.05$

Hipoteza H3.C pranohet. Koeficienti *beta* i variablit të pavarur - popullsia, ka vlerë pozitive dhe jep kontribut domethënës në model.

5.3.8.3.1 Përbledhje analizës hipoteza H3

Si rezultat, vlera e R^2 e barabartë me 0.927 është rezultat i shansit dhe variablat e pavarur janë ‘të aftë’ për të shpjeguar variacionin në variablin e varur.

Vlerat statistikore t për kontrollin e koeficientëve të regresionit, duke treguar se këta koeficientë janë të ndryshëm nga zero dhe domethenës ($sig.<0.05$).

Popullsia $\beta=0.02 >0$, $p=0.002 < 0.05$

Hipoteza H3.a pranohet. Koeficienti *beta* i variablit të pavarur - popullsia, ka vlerë pozitive dhe jep kontribut domethënës në model.

Si rezultat, vlera e R^2 e barabartë me 0.912 është rezultat i shansit dhe variabli i pavarur është ‘i aftë’ për të shpjeguar variacionin në variablin e varur.

Vlerat statistikore t për kontrollin e koeficientëve të regresionit, duke treguar se këta koeficientë janë të ndryshëm nga zero dhe domethenës ($sig.<0.05$).

Popullsia $\beta=0.048 >0$, $p=0.03 < 0.05$

Hipoteza H3.b pranohet. Koeficienti *beta* i variablit të pavarur - popullsia, ka vlerë pozitive dhe jep kontribut domethënës në model.

Si rezultat, vlera e R^2 e barabartë me 0.897 është rezultat i shansit dhe variabli I pavarur është ‘i aftë’ për të shpjeguar variacionin në variablin e varur.

Vlerat statistikore t për kontrollin e koeficientëve të regresionit, duke treguar se këta koeficientë janë të ndryshëm nga zero dhe domethenës ($sig.<0.05$).

Popullsia $\beta=0.001 >0$, $p=0.004 < 0.05$

Hipoteza H_{3.c} pranohet. Koeficienti *beta* i variablit të pavarur - popullsia, ka vlerë pozitive dhe jep kontribut domethënës në model.

Konkluzion:

Hipoteza **H3** vërtetohet për të tre nënhipotezat si rrjedhim mund të themi se modeli “Zona funksionale” është më i përshtatshëm në bashkitë ish rrethe.

5.3.9. Sygjerimi i një modeli

Nga ana tjetër, paraqitja grafike lejon të krahasohet drejtëpërdrejtë indikatori i grandeve për fymë në 2014 dhe 2016. Siç vërehet nga dy përpunimet, diferencat në grand për fymë para dhe pas reformës, rezulton të jetë negative në 6 prej 7 bashkive të studiuara. Kështu, vihet re një shkurtim drastik i transfertave të pakushtëzuara për bashkinë e Gjrokastrës. Nga ana tjetër, kemi një shkurtim me 17% të grandit për fymë në Bashkinë Tepelenë, një përkeqësim të këtij indikatori për Libohovën me 17%, për Përmetin me 15%, për Memaliaj për 3.3%, Këlcyren për 1%, vetëm për bashkinë Dropull kemi një përmirësim të indikatorit të grandeve që përfiton çdo individ me rreth 3%.

Nëse marrim për bazë eficencën ekonomike, pikërisht indikatorin e transfertave të pakushtëzuara për fymë të banorëve të secilës bashki, rezultatet tregojnë se reforma administrativo – territoriale ka sjellë një përkeqësim të eficencës ekonomike për njësitë e studiuara.

Sigurisht që për të mbështetur këtë përfundim janë të nevojshëm edhe argumenta të tjera, të cilat kërkojnë më tepër të dhëna dhe një kohë më të gjatë në të cilën reforma të tregojë

efektet e saj, por ky indikator fillestar sinjalizon keqmenaxhim të aspektit ekonomik pas ndarjes së re administrativo – territoriale. Kjo sepse është ulur përfitimi që i takon secilit banor nga totali i transfertave të pakushtëzuara pas reformës administrativo – territoriale, krahasuar me pjesën që i takone sipas ndarjes së vjetër.

Ndërveprimi ekonomik në qarkun Gjirokastër do ta vlerësojmë nëpërmjet lëvizjeve për punësim dhe përqëndrimit të bizneseve për çdo zonë funksionale.

Më poshtë analizohet përqendrimi i bizneseve në qarkun e Gjirokastrës, ku identifikohen qartë tri zona funksionale: ajo me qendër Gjirokastrën; me qendër Tepelenën; me qendër Përmetin. Veç këtyre tri qendrave, lexojmë një tjetër zonë që tenton të krijohet mes Tepelenës dhe Përmetit, e cila duhet të shqyrtohet nëpërmjet indikatorëve të tjera.

Për të qartësuar me tej zonat funksionale le të shikojmë drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarve brenda qarkut të Gjirokastrës.

Përsëri konfirmohen zonat funksionale me qendër si Gjirokastrën, Tepelenën dhe Përmetin. Ajo që vlen të përmendet në këtë analizë është, se ka një numër të madh të bashkëveprimit të disa njësive vendore të Gjirokastrës me Dropullin. Kjo e bën këtë zonë si potencial për të qenë qendër e njësisë funksionale, por ky hamendësim duhet të vërtetohet edhe nga indikatorë të tjera.

Qendrat urbane brenda zonës funksionale bëhen ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit, ndërkohë që qendrat rurale përqark tyre bëhen furnizuese me produkte bujqësore dhe kryesisht me fuqi punëtore.

Sektorët dominues në ekonominë e rajonit të Gjirokastrës janë ata të tregtisë dhe shërbimeve, si edhe sektori i pasurive të paluajtshme dhe financiar. Bujqësia prodhon rrëth 30% të vlerës së shtuar për të gjithë rajonin. Zona funksionale Gjirokastër ka gjithsej 1397

biznese, nga mbi 80% e të cilave janë të vendosura në qytetin e Gjirokastrës. Siç shihet nga të dhënrat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesish bujqësore, me përjashtim të bashkisë së Gjirokastrës.

Nga ana tjetër nëse i referohemi qarkut të Gjirokastrës, vërehet së ka një polarizim të madh të popullsisë. Përmeti ka një densitet të lartë, çka e justifikon përcaktimin e saj si qendër të zonave funksionale. Nga ana tjetër, qartazi zbulohen dy zona të tjera funksionale: Gjirokastra dhe Tepelena.

Një tjetër element që vlerësojmë për të përcaktuar zonat funksionale në qarkun e Gjirokastrës është përqëndrimi i shërbimeve dhe infrastrukturave. Materialet e mëposhtme grafike prezantojnë qendërat kryesore me nivelin më të lartë të shërbimeve, prej nga përfitojnë edhe periferitë urbane dhe rurale duke krijuar kështu një tjetër shtresë të përcaktimit/identifikimit të zonave funksionale.

Sot në Shqipëri si rezultat i organizimit më të hershëm të shtetit dhe qeverisjes qendrat e rrtheve janë përqendrimet kryesore të institucioneve qëndrore (kryesish ministrike të linjës) në nivelin më pranë qytetarit. Në qendrat e rrtheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoretë shëndetësore rajonale, drejtoretë e shërbimit pyjor, gjykata e rrëthit gjyqësor, prokuroria dhe degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrëthit janë vendosur dhe një sërë institucionesh sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e femijëve, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Kjo është ndër arsyet kryesore që bën që qendrat e rrtheve të shndërrohen në pikë kontakti për sa i përket ndërveprimit institucional (pra të institucioneve me njëra tjetrën) por njëkohësisht dhe të qytëtarit me institucionet. Bizneset po ashtu duket së preferojnë

të vendosen në qendrat e rrtheve po për të njëjtën arsy; praninë e institucioneve e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit.

Duke u bazuar në tabelën e shpërndarjes së institucioneve në qarkun e Gjirokastrës është përshtatur harta e Gjirokastrës për të treguar ndarjen e zonave funksionale sipas këtij kriteri.

Distanca kilometrike dhe kohore mes zonave funksionale janë një nga faktorët kyç i cili është përcaktuar si kriteri në ndarjet e reja administrative – territoriale. Për këtë arsy është hulumtuar distanca kohore dhe në kilometra mes njësive aktuale administrativo-territoriale për të zbuluar nëse është e justifikueshme krijimi i zonave funksionale sipas ndarjes aktuale apo zonat janë aq afër me njëra – tjetrën saqë vetëm rëndojnë kostot.

Tabela 55 Distanca kohore në NJQV Gjirokastër

	Bashkia Gjirokastër	Bashkia Tëpelene	Bashkia Libohove	Bashkia Permet	Bashkia Memaliaj	Bashkia Kelyre
Bashkia Gjirokastër						
Bashkia Tëpelene	36 min (31.1 km)					
Bashkia Libohove	21 min (20.6 km)	46 min (47.6 km)				
Bashkia Permet	1 h 12 min (61.6 km)	50 min (42.0 km)	1 h 22 min (78.1 km)			
Bashkia Memaliaj	40 min (39.3 km)	8 min (9.5 km)	54 min (55.8 km)	1 h 17 min (57.7 km)		
Bashkia Kelyre	49 min (43.1 km)	27 min (23.5 km)	1 h (59.6 km)	32 min (26.2 km)	37 min (31.7 km)	
Bashkia Dropull	22 min (22.8 km)	46 min (49.8 km)	20 min (16.5 km)	1 h 42 min (87.8 km)	56 min (58.0 km)	1 h (61.9 km)

Burimi: Google Map; Përpunim, Hysi (2016)

Nga tabela e mësipërme vihet re se distancat mes njësive qëndrore janë shumë të vogla.

Mund të vërehet se në bazë të tabelës së mësipërme, mund të dallohen qartë tri zona:


Gjirokastër, Tepelenë, Përmet në bazë të grupimit të distancave kohore.

Pikërisht për këtë arsy, duke iu referuar eficencës ekonomike, ndërveprimit ekonomik në qarkun Gjirokastër, treguesve demografik, në qarkun e Gjirokastrës identifikojmë tri zona funksionale: atë me qendër Gjirokastrën; me qendër Tepelenën; me qendër Përmetin.

Pranë Tepelenes dhe Gjirokastrës, tentojnë të krijohen 2 zona të tjera funksionale si rezultat kryesisht i ndërveprimit mes banorëve dhe rrjeteve të tjera sociale dhe ekonomike.

Bazuar në konkluzionet e mësipërme nga ky punim (faza e tretë e tij) mund të deduktohet skema ku paraqitet tre zonat funksionale të sugjeruara:

Figura 26 Derivimi i një modeli alternativtë ndarjes Administrative Territoriale të Gjirokastrës bazuar në Konceptin e Rrethit



Burimi: Hysi, 2015

Ashtu sikurse shpjegohjet nga skeda e mësipërme, ky studim në hapin e tij të fundit sugjeron se zonat funksionale aktuale të Gjirokastrës janë thjesht administrative dhe të sforcuara. Ashtu sikurse u tregua nga analiza grafike dhe e statistikës deskriptive e të gjithë kritereve të zonave funksionale, ka një sërë kriteresh të cilat këto zona aktuale funksionale nuk i përbushin. Për këtë arsy, mbështetur në këto rezultate dhe në të gjithë hapat e njëpasnjëshëm të studimit, sugjerimi i punimi është një rikthim në origjinalitet të Qarkut Gjirokastrës duke i qëndruar besnik totalisht konceptit të ish- rrerhit.

Nga pikëpamja e qeverisjes vendore “rrethi” si njësi administrative nuk është më i zbatueshëm si nivel organizimi administrativ, por ish-rrerhet identifikohen në ligjin organik të qeverisjes vendore, si koncept i nëndarjes administrative të Qarkut apo edhe në shpërndarjen e shërbimeve të dekoncentruara të ministrive të ndryshme. Gjithashtu qartazi në memorien institucionale dhe të komuniteteve, “ish-rrerhet” vazhdojnë të kenë edhe sot një rol referues dhe qartazi njihet si përbashkues i identitetit kulturor dhe tradicional të banorëve.

Varianti qeveritar nuk ndryshon kufijtë e komunave dhe të bashkive që do të bashkoheshin në njësinë e re funksionale, por do të linte në çdo njësi një administrator të emeruar dhe disa punonjës të sherbimeve ekzistuese, të cilët nesër do të merren në komunat ekzistuese si çertifikata ndihma sociale, kadastra etj. Varianti i propozuar dhe i zbatuar nga qeveria ka këto të meta: së pari duhej të praktikonte variantin e minibashkive për administrimin nga njësia e re funksionale të njësive që do të ishin pjesë e saj si efekt i shkrirjes. në minibashkit (ligji 8652, 2000) kryetari zgjidhet nga populli dhe e ka elementin demokratik për të qënë autonom në vendimarrje.

Ndërsa i emeruari kuptohet që do të jetë vetëm një urdhër zbatues i verbër i kryetarit të bashkisë dhe nuk kundershton dot, për të mbrojtur interesat e komunitetit që përfaqëson: së dyti, nuk do të ketë përfaqësues të Këshillit të Komunave që do të ekzistojnë si njësi me shërbime të kufizuara në këtë rast si demokracia përfaqësuese nëpërmjet këshillit dhe ajo direkte me zgjedhjen e kryetarit të mëparshëm do të mungojë.

Një arsyе tjetër do të ishte ajo që pjesa më e madhe e popullsisë e ka ndjenjën e identitetit të rrëthit, Çfarë perspektive ekonomike ka Memaliaj, që mund të themi se në të ardhmen ajo do të tërheq banorët e zonave rurale të zonës së Buzit dhe të Krasit, por ku do punësohen këta, as Tepelena nuk mund të tërheq banorë si zonë urbane dhe s'mund të ketë perspektive për burimet natyrore që ka. Kjo llogjikë mund të funksionojë në Zonat e Ultësirës Perëndimore si dhe në rajonet Industriale për të lidhur industrinë nxjerrëse me atë përpunuese, dhe natyrshëm do të krijohet një zonë e tillë efektive funksionale. Ndërsa në rastin e zonave rurale si Tepelena dhe Memaliaj, Këlcyra, Përmeti, Libohova, vetëm mund të forcohen si zona administrative. Ndërkohë (shih tab. 55) **Bashkitë Memaliaj** nga Tepelena është vetëm 8 km larg, po kështu dhe Këlcyra nga Përmeti dhe Libohova nga Gjirokastra jo më shumë se 20 km. Nga sa më sipër mund të themi, që Bashkia Libohovë, Memaliaj, Këlcyrë, nuk ka as 3000 mijë banorë. A kemi këtu një kriter që duke patur parasysh dhe potencialin e vet ekonomik dhe zhvillimin industrial të tyre këto nuk e plotësojnë kriterin e Zonës Funksionale? Zagoria për shembull (Berxhulli,A, 2014), nuk ka qenë ndonjëherë me Libohovën, Memaliaj s'ka qënë asnjëherë qendër administrative për zonën e re.

Në vijim paraqitet harta e ndarjes administrative e Qarkut Gjirokastër (Figura 29), sipas vendimit të ndarjes së re të reformës administrativo – territoriale.

Figura 27 Skema aktuale e ndarjes së njësive administrative , Qarku Gjirokastër




Burimi, Hysi 2016

Në hartën e mësipërme paraqiten ,me shjigjeta gjashtë zonat funksionale sipas ndarjes aktuale administrativo – territoriale në Shqipëri në Qarkun Gjirokastër.

Duke patur parasysh analizën e literaturës për madhësinë e njësive vendore, Gabler 1971, Mabuchi 2001, Byrnes & Dollery 2003, Katsuyama 2003, dien dakort që ajo është efektive, kur ka një popullsi mbi 20 mijë banorë. Po ashtu dhe nga analiza që bëmë për Qarkun e Gjirokastrës del, se njësitë e vogla vendore sidomos ato jo të konsoliduara (Libohova, Këlcyra, Memaliaj) nuk kanë kapacitetet e duhura institucionale, ekonomike, infrastrukturë. Për sa thamë më sipër duke u bazuar tek avantazhet dhe disavantazhet e njësive të mëdhaja vendore, duke u bazuar tek literatura e huaj, si dhe ajo vendase, mendojë që varianti më i përshtatshëm i ndarjes administrative-territoriale, do të ishte ai i zonës funksionale i përshtatur në formën e rrithit.

Nga ana tjetër, në vijim paraqitet harta e Qarkut të Gjirokastrës (firura 29), sipas modelit të propozuar nga ky punim i cili përkon dhe njëhsohet plotësisht me modelin e Rrethit. Ku Bashkia Memaliaj i bashkohet Bashkisë Tepelenë, Bashkia Libohovë Bashkisë Gjirokastërë, Bashkia Këlcyrë Bashkisë Përmet. Po ashtu

Figura 28 Qarku Gjirokaster



Burimi : Hysi, 2015

KAPITULLI VI . KONKLUZIONE TOTALE PUNIMI

Ky punim kërkonte të hulumtontë detaje të ndryshme të reformës administrativo – tërritoriale në Shqipëri, e konkretizuar në mënyrë specifike dhe konkrete për zonën funksionale të Gjirokastrës.

Në këtë punim nëpërmjet kërkimeve empirike, përmes shumë rezultateve dhe intepretimeve të dhëna në kapitullin paraardhës, mund të hidhet dritë mbi një sërë konkluzionesh.

Konkluzionet do të ngrihen duke iu kthyer edhe njëherë tri hipotezave themelore të punimit për reformimin e pushtetit vendor, rrit të ardhurat/ frymë, zvogëlon shpenzimet administrative/frymë, mundëson thellimin e nivelit të decentralizimit.

H1: Modeli i zonës funksionale zbatuar nga Qeveria Shqiptare është modeli më përshtatshëm për reformimin e pushtetit vendor, rrit të ardhurat/ frymë, zvogëlon shpenzimet administrative/frymë, mundëson thellimin e nivelit të decentralizimit.

Kjo hipotezë pranohet pjesërisht. Ky punim vërteton vlefshmërinë e modelit të zonave funksionale të përdorur për reformën administrative tërritoriale dhe vlerëson se ky është modeli i duhur për kontekstin e zonës së Gjirokastrës. Nga analiza të ardhurat për frymë janë rritur, këtë e verteton dhe koeficienti i kovariacionit që rritet në krahasim me vitin 2014 para reformanaliza nga 0.149 në 0.315. Për shpenzimet në frymë analiza tregon se ato jan ulur dhe kjo vërtetohet me rritjen e koeficentit të kovariacionit nga 0.381 në vitin 2014 në 0.4. Për sa i

përket analizës së shërbimeve del se ato janë ulur, për arsyen se, për bashkitë joqëndër rrethi për disa kompetenca grandet specifike ishin barabartë me zero.

Ky konkluzion, ashtu sic u shpjegua edhe në kapitullin e rezultatëve, mbështetet nga gjetjet statistikore ($R=0.959$ së shumëfishtë) kriteret e zgjedhur të reformës administrative, ku sipërfqaqa dhe popullsia ka një ndikim të fortë në thellimin e decentralizimit. Edhe kjo është një vlerë që mund të kondiderohet e kënaqshme, për të justifikuar modelin statistikor të ngritur në këtë studim.

$$\text{Transferta Specifike} = 3366.602 + 1.412 * \text{Popullsi} + 38.647 * \text{Siperfaqja} + 47205.692 * \text{Grupet}$$

Të dy këta tregues janë argumenta të mjaftueshëm për të mbështetur **konkluzionin**: Modeli i huazuar, adaptuar dhe implementuar nga Ministria e Cështjeve Vendore për kryerjen e reformës territoriale- Administrative është i përshtatshëm statistikisht duke qenë se shpjegohet pikërisht nga kriteret teknike të përzgjedhur nga komisioni i reformimit, gjen zbatim më mirë tek bashkit ish-rreth.

Ky model i nisur nga koncepti One – Stop Shop, i derivuar nga takimet shumëpalëshë ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve shqiptare dhe atyre ndërkombëtare, ka rezultuar të jetë i duhuri në tërma të nxitjes së decentralizimit për bashkit ish-rreth.

H2 : Performanca e NJ.Q.V-ve të konsoliduara (lidhje ekonomike, infrastruktur shërbimesh, lidhje tradicionale, vazhdimësi terreni) është më e mirë se performanca e NJ.Q.V - ve të pakonsoliduara.

Kjo hipotezë vërtetohet plotësisht. Duke u nisur nga treguesit statistikor koeficenti i përcaktueshmërisë, $R= 0.698$, faktorët kanë lidhje të rëndësishme me performancën, ndikimi i të cilëve jepet me ekuacionin e mëposhtëm :

Performanca e zones funksionale = $0.857 + 0.027 * \text{Bashkitë} + 0.742 * \text{Grupet} + 0.011 * \text{Arsimi} - 0.005 * \text{Gjinia} + 0.138 * \text{Faktorët_Ekonomik} + 0.389 * \text{Shërbimet} + 0.026 * \text{Kultura} + 0.111 * \text{Përgjithshme}$

Përfomanca e njesive vendore eshte me pozitive , kriteret e përzgjedhur për modelimin e ndarjeve Administrativo territoriale, i superuan testet përkatëse duke dëshmuar sinjifikancën e tyre statiskore dhe duke vërtetuar se reformatori Administrativo-Tërritorial ka zgjedhur kriteret e duhur për t'i përdorur në proçes. Duke vlerësuar lidhjen e eficencës administrative me kriteret e reformës Administrativo tërritoriale: faktorët ekonomik, aksesi në shërbim dhe bashkëpunimi mes tyre kanë ndikuar në rritjen e performancës më shume në bashkitë e konsoliduara sesa ato të rejat të krijuar rishtas.

Grupet=0, që përfaqëson variablin kontrollues, për performancën e zonës funksionale, për bashkitë e pakonsoliduara (jorreth), ka në të katër verifikimet për pyetjet ndikim negativ F5P1 Grupet 0 = -0.18; F5P2 Grupet 0 = - 3.11; F5P3 Grupet 0= -1.97; F5P4 Grupet 0 = - 1.91. Kjo vërteton që në ekuacionin performancës bashkitë pa konsoliduara (jo qëndër rrëth) kanë përfomancë më të ulët se bashkitë e konsoliduara (ishrrëth). **Hipoteza H2 vërtetohet**, Bashkitish rrëth kanë performancë më të lartë se bashkitë jo qëndër rrëth

Të gjitha këto rezultatë, vërtetojnë konkluzionin së pavarësisht së të marra si të tërë kriteret e reformës janë të duhurit, ato nuk janë zbatuar siç duhet në Gjirokastër pasi sic u dëshmuai 2 nga 4 kriteret pas reformimit kanë cuar në rënien e decentralizimi efektiv. Thënë ndryshe, keqzbatimi i Lidhjeve historike dhe funksionale, kritrit të distancës midis njësive vendore dhe territorit dhe zonës funksionale kanë cuar në ineficencë në Gjirokasternë bashkit jo qëndër rrëthi, Memaliaj, Libohovë dhe Këlcyrë.

Për këtë arsy, duhet që këto hendekë të adresohen, gjë të cilën e bën konkluzioni i tretë dhe rekomandimet e punimit.

HIPOTEZA 3: Hipoteza e tretë, Modeli “Zona Funksionale” është më i realizuar në bashkitë e konsoliduara sesa në ato të pakonsilodura.

Edhe kjo hipotezë e fundit pranohet, shpjegimi i saj është si vijon: Për bashkitë ishrreth numri i institucioneve krijon kushte më të favorëshme, se në bashkitë jo rrëth pasi nga analiza koeficenti tregon lidhje të forët $R=0.927$. Për bashkitë e konsoliduara (ishrreth) numri i bizneseve favorizon modelin, sepse lidhja është e fortë, $R=0.912$. Për bashkitë konsoliduara (ishrreth) shërbimi shëndetësor krijon kushte më të favorshme për modelin, pasi lidhja është e fortë $R=0.897$. Bashkit konsoliduara (ishrreth) kanë kapacitetet e duhura për të zbatuar modelin “Zona funksionale”.

Ky model është i bazuar në konceptin e rrëthit dhe rezultatët e këtij punimi vërtetojnë se ka probabilitet më të madh suksessi sesa mënyra aktuale e ndarjes së re tërritoriale të Gjirokastrës pas kryerjes së reformës Administrativo – tërritoriale. Duke qenë së aktualisht zonat funksionale aktuale të Gjirokastrës janë thjesht adminsittative të sforcuara dhe ka një sërë kriteresh, të cilat këto zona aktuale funksionale nuk i përbushin, Rekomandimi i këtij punimi është një rikthim në originalitet të Gjirokastrës duke i qëndruar besnikë totalisht konceptit të ish- rrëthit. Koncepti i ishrrethit ka një sërë avantazhesh, të cilat i njeh edhe drafti udhëheqës i reformës Administrativo- Territoriale.

Në mënyrë të detajuar, konkluzionet në lidhje me testimin, nëse kriteret e reformës janë ndjekur gjatë ndarjes së Gjirokastrës në Zona Funksionale, janë si vijon:

Eficencia ekonomike e zonave funksionale në Gjirokastër: Analiza e transfertave të pakushtëzuara: reforma ka çuar në një eficencë më të madhe ekonomike sepse ka reduktuar dublimin e grantëve (për bashkitë dhe për komunat), veçanërisht për Gjirokastrën. Por, vihet re një shkurtim drastik i transfertave të pakushtëzuara/frymë në 5 nga 6 zonat funksionale në shqyrtim. Janë zvogëluar kostot administrative në të gjitha NJQV-te, si dhe janë rritur të ardhurat përfryme, dhe janë shtuar kompetenca të reja përfundimtare gjithë bashkite. Nga 4 kompetenca e transferuara përfundimtare dy nga to (grandi specifik), përfundimtare Bashkitë Libohovë, Memaliaj, Këlcyrë kanë vlerën zero, sepse s'kanë infrastrukturën dhe kapacitete institucionale përfundimtare marr përgjegjësi përsipër.

Eficencia ekonomike e zonave funksionale në Gjirokastër: Ndërveprimi ekonomik në qarkun Gjirokastër: Në bazë të analizës së përqëndrimit të bizneseve në qarkun e Gjirokastrës, identifikohen qartë tri zona funksionale: ajo me qendër Gjirokastrën; me qendër Tepelenën; me qendër Përmetin dhe një tjetër zonë që tënon të krijohet mes Tepelenës dhe Përmetit. Këto tri zona kryesore funksionale përforcohen dhe në sajë të drejtimeve kryesore të lëvizjes së të punësuarve, brënda Qarkut të Gjirokastrës. Numri bizneseve: Gjirokastra 1177, Libohova 37, Tepelena 64, Memaliaj 29, Përmeti 354, Këlcyra 110)

Analiza e treguesve demografike e zonave funksionale në Gjirokastër: Në bazë të analizës së dëndësisë demografike në qarkun e Gjirokastrës, mund të identifikohen 3 zona funksionale: ajo me qëndër Gjirokastrën (ka një polarizim të madh të popullsisë); me qëndër Tepelenën; me qëndër Përmetin (densitet të lartë).

Analiza e aksesit në shërbimet sociale e zonave funksionale në Gjirokastër: Duke u bazuar në tabelën e shpërndarjes së institucioneve në qarkun e Gjirokastrës, është përshtatur

harta e Gjirokastrës për të treguar ndarjen e zonave funksionale sipas këtij kritéri. Kjo analizë ka përforcuar konkluzionet e nxjerra nga testimi i dy kritereve të mësipërme. Në bashkit ish-rrethe kemi dyfish numrin e institucioneve, në raport me bashkitë jorreh. (Girokastra 62 Institucion, Libohova 4, Përmeti 26, Këlcyra 8, Tepelenë 24, memaliaj 9)

Distanca kohore mes Zonave Funksionale në Gjirokastër: është hulumtuar distanca kohore dhe në kilometra mes njësive aktuale administrativo- tërritoriale. Distancat mes njësive qëndrore sipas ndarjes aktuale janë shumë të vogla (Memaliaj- Tepelenë 8km, Libohovë-Gjirokastër 20 km, Përmet-Këlcyrë 22 km, shih tabelen. 55), duke zbuluar se nuk është i justifikueshëm krijimi i zonave funksionale sipas ndarjes aktuale sepse kjo vetëm rëndon kostot, pasi aktualisht banorët frekuentojnë marrjen e sherbimeve publike në qëndrat rre

Duke i'u referuar eficencës ekonomike, ndërveprimit ekonomik, treguesve demografik, në Qarkun e Gjirokastrës identifikojmë tri zona funksionale: atë me qendër Gjirokastrën; me qendër Tepelenën; me qendër Përmetin. Pranë Tepelenës dhe Gjirokastrës, tentojnë të krijohen 2 zona të tjera funksionale si rezultat kryesishët i ndërveprimit mes banorëve dhe rrjetëve të tjera sociale dhe ekonomike.

6.1 Rekomandimet

Në fund të këtyre konkluzioneve mund të ngrihen disa rekomandime të rëndësishëme për politikbërësit e reformës administrativo – territoriale.

Duke qënë se një nga konkluzionet më të rëndësishme të këtij punimi është se, reforma tërritoriale është ideuar sipas modelit më të përshtatshëm për të promovuar decentralizimin dhe se kriteret e tij janë mirëselektua, rekomandimi më i rëndësishëm i këtij punimi është: fazë më e rëndësishme pas ideimit të reformës mbetet faza e implementimit.

Ky punim sugjeron, se ka hendekë relativisht të thellë në implementimin e modelit të zonës fuksionale gjatë reformimit administrativo - territorial në Qarkun Gjirokastër, rekomandimi më i fuqishëm është që të adresohen këta hendekë. Në këtë kuadër, rekomandimet në sajë të tri konkluzioneve, sikurse tregohet edhe nga figura më lartë (fig. 28). Modeli i reformimit administrativ- territorial duhet të rishikohet në mënyrë periodike në ndjekje të modelit: zonë funksionale. Nuk është me e nevojshme të rishikohen kriteret e reformës administrativo – territoriale por vetëm të ndiqet rreptësisht zbatimi i tyre. Eshtë e nevojshme që të adresohen në mënyrë të menjëhershme hendekët e hasur në zbatimin e modelit të reformës për çdo qëndër funksionale.

	HENDEKU	REKOMANDIMI
1	NDERVEPRIM: Ndërveprim i ulët i territorëve përrreth me Memaliaj, Këlcyrë dhe Libohovës si NJQV	Forcim i njësive brenda qendrave funksionale ose një riorganizim i tyre për t'iu përshatur ndërveprimeve të natyrshme dhe të zhvilluara deri më tanë.
3	KAPACITET PER GAMEN E PLOTË Të SHERBIMEVE: Memaliaj, Këlcyra, Libohova, nuk ka një kapacitet të zhvilluar për të ofruar gamën e plotë të shërbimeve publike që një qendër funksionale e ka të nevojshme të ofrojë.	Të ofrohen kapacitetet e duhura për njësitë e reja funksionale ose të caktohen si zona funksionale ato njësi të cilat e kanë tashmë të ngritur një sistem të kapaciteteve dhe i nevojitet vetëm një rimëkëmbje.
4	CILESI E NJEJTE E SHERVIMEVE URBAN-RURAL: Nuk ka cilësi të njejtë të shërbimeve që ofron Libohova me Gjirokastrën, Këlcyra me Permetin, Libohova me Gjirokastren. PABARAZI MIDIS	Pavarësisht fuqizimit që marrin zonat funksionale, nuk duhet harruar zbutja e polarizimit ndërmjet cilësisë së shërbimit publik të ofruar ndërmjet qendrës (zonat urbane) me zonat periferike (zonat rurale)

	ZONAVE URBANE DHE RURALE: Memaliaj, Libohova, Këlcyrë, kanë një potencial shumë të ulët për zhvillim ekonomik për efekt të ndërveprimeve, bazës ekonomike të pamjaftueshme etj.	
6	QENDER GRAVITETIT: Të anketuarit gjykojnë së nuk ia vlen të shkojnë në Libohovë, Këlcyrë, Memaliaj, për ndërveprim kur shërbimet i marrin në Gjirokastër, Tepelenë, Pëmet Memaliaj, Këlcyrë, Libohova nuk mund të konsiderohet si qëndër graviteti.	Rekomandohet që zonat funksionale të mos krijohen në mënyrë artificiale, arbitrale ose të shtyrë nga intëresa përtëj kritereve të përcaktuar të ndarjes administrativo – territoriale. Kjo për shkak së konceptë të tillë si “qendër e gravitetit” janë tashmë të evidentuara nga historiku i ndërveprimeve ndërmjet njësive administrative dhe është e nevojshme të përfitohet prej tyre dhe të përforcohen avantazhet që derivojnë nga kjo dhe jo të shpenzohen energji në kriimin e zonave funksionale të sforcuara.
7	MBIVENDOSE ME ISH-RRETHET: Nuk mbivendoset mbi conception e ish – rrethit. Madje e ka ndarë në dy pjesë këtë koncept territorial.	Duke qënë së një nga kriteret e selektuara nga qeveria për reformën administrative – territoriale ishte edhe mbivendosja me rrethet, rekomandohet që të rishihen të gjitha ndarjet faktike jo me qëllim riprodhimin e ndarjes së vjetër sipas konceptit të rrethit, por me qëllim reduktimin e shmangies nga mbivendosja me rrethet. Kjo sepse koncepti i njësisë administrative “rreth” ngërthen në vetvete konceptë të tillë si: qëndër graviteti, zonë funksionale, lidhjet historike dhe tradicionale, barazinë ekonomike ndërmjet zonave, etj.
9	ZHVILLIMI POLICENTRIK; Nuk ka zhvillim policentrik, vetëm fragmentarizim pasi këto zona funksionale janë vetëm administrative dhe nuk kanë zhvillim ekonomik. DISTANCA NJQV- TËRRITOR: Libohova mund të	Përveç mbivendosjes me ish – rrethet dhe qëndrimit besnik të konceptit zonës funksionale, rekomandohet të rishikohet dhe të merret feedback nëse ndarjet aktuale administrative – territoriale po rrezikojnë të gjenerojnë pasojat e fragmentarizimit. Në këtë kuptim rekomandohet një kontroll i efektivitetit të reformës administrative – territoriale sipas tërmave të mësipërm, të cilët janë edhe udhëheqësit kryesorë të reformës.

	konsiderohet si një ishull.	
13	MBROJTJE MINORITËTI: Minoriteti i vetëm është Zona Dropull, por nuk është krijuar një zonë funksionale e vecantë për të përfshirët qarkun e Gjirokastrës, pasi janë analizuar të gjithë kriteret dhe i bazuar rigorozisht në to. Ai përshtatet tërësisht me modelin e rrëthit (figura 27,28) si një sfidë përfshirët qarkun e Gjirokastrës dhe gjithë Shqipërinë.	Të rishikohen politikat e mbrojtjes dhe zhvillimit të minoritetëve në rastet kur këta të fundit nuk plotësojnë kushtet përfshirët qenë një zonë e veçantë funksionale dhe mbeten pjesë e bashkësive më të mëdha.

Së fundmi, në vijim paraqitet rekomandimi i këtij punimi në lidhje me ndarjen adekuade administrativo – territoriale në qarkun e Gjirokastrës, pasi janë analizuar të gjithë kriteret dhe i bazuar rigorozisht në to. Ai përshtatet tërësisht me modelin e rrëthit (figura 27,28) si një sfidë përfshirët qarkun e Gjirokastrës dhe gjithë Shqipërinë.

REFERENCA

1. Maurice, T. (2012). MANAGERIAL ECONOMICS. University of South Florida.
2. Trindal, C.Richard, and Trindal, Suzan Nobes.(2004). Lokal Government in Canada, 6 th, Ed, Scarbourugh: Thomson Canada. Pp.2.
3. Trindal, C. R. (1977), struktural Changes in local Government for Urban Regions. Monographs on canada Urban Government,# 2, Toronto: Institute of Administration of Canada. Pp.3.
4. Crawford, K.G, Canada Municipialy Government Toronto: University of Toronto, Press, 1954, pp. 15.
5. L.Hobhous, Liberalizem,Oxford University Press,Oxford,1964, pq.81
6. BRENDSHME, M. E. (2014, KORRIK). Relacion për projektligjin “për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”. Retrieved from Ministria e Puneve të Brendshme:
http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/RELACION_PROJEKTLIGJ_NDA_RJA_ADMINISTRATIVO_TERRITORIALE.pdf
7. Çuçi, B. (2014). Administrative and Territorial Reform. Newsletter.
8. Gjonaj, A. (2015). Elbasan-Leskaj: Reforma territoriale solli ngadalësim në zhvillimin e pushtetit vendor. Agjencia Telegrafike Shqiptare.
9. Janno Reiljan, A. Ü. (2012). The necessity of an administrative territorial reform in a country: the case of estonia . The University of Tartu FEBA, pp. 9-10.
10. Kivestw, R. (2008). Structural reform - a road to success? Aalborg University.
11. Kogut, I. (2014). Approach to the implementation of administrative and territorial reform in ukraine. Tavria State Agro technological University .
12. Kovács, W. (2014). The development of governmental coordination mechanisms in Hungary (1990-2014). Corvinus University of Budapest.
13. Marinovic, D. (2008). Administrative reform within the European Commision School of Management and Governance.
14. Oates, W, E. (1985). Searching for Leviathan: An Emperical Study, American Economics. Review Nr.75, pp. 748-751

15. Grossman, P. (1989), Fiscal Decentralization and Government size An Extension. Public Choice Nr.62, pp. 63
16. Ehdaie , J. (1994). Fiscal Decentralization and the Size of Government. Policy research Working paper. Nr. 1387. Work Bank
17. Brenan, G, and Buchanan, (1980) the power Tax Cambridge University Press. Pp. 183
18. Nina Boschman, (2009). Fiscal Decentralization and Option for Donor Harmonization. Local Governnance & Decentralization. Pp. 20
19. Nako, N. (2013, Dhjetor 30). Reforma e ndarjes administrative. Ekonomia.
20. Keith, L. Miller, (2002). Avantage & Disavantages of Local Government Decentralization. Pp. 2,3,4.
21. Romanvska, O. (2012). Contrasting the administrative Territorial reforms in Poland and Ukraine: Why similar countries chose different decentralization paths . Central European university.
22. Vallier, F. (2013). Decentralisation at a crossroads Territorial reforms in Europe in times of crisis. Council of European Municipalities and Regions.
23. Vendore, m. p. (2015). Reforma administrativo-territoriale: kriteret teknike për ndarjen e re administrativo territoriale. retrieved from parlament:
http://www.parlament.al/web/pub/kriteret_teknike_propozimi_per_komisionin_28prill2014_16985_1.pdf
24. Vendore, M. p. (Prill, 2014). Reforma administrative-territoriale; analizë e situatës së qeverisjes vendore në Shqipëri; (përbledhje ekzekutive); Raporti i përgjithshëm; për komisionin e reformës administrativo-territoriale.fq. 282-289
25. Rogers,E.M.(1988).Information technologies: How organizations are changing.In G.M.Goldhaber & G.A.Barnett (Eds), Handbook of organizational communication , pp.437.
26. Jean-Guy, Finn. (2008). Bulding local Government and Regional. Pp. 13-19.
27. Boeringer, E. (1996), Governance and Development: Issues and Contrants Proceedings of the World Bank Annual Conference on Development.
28. Cooke, B. & Kathari, V., (2001) “ The case for participation as Tyranny, in Cooke, B., eds., Participation, The New Turanny, London zed Books.
29. Oyugi, W. O., (2000), Decentralization for good Governance and Development

30. Smith, B. C., (1985), Decentralisation: The Territorial Dimension of State London: Allen and Unwin, pp.1.
31. Olson,M.H.(1982, December). New information technology and organizational culture. MIS Quarterly, pp. 21.
32. Barle, D. G., (2002), & Uys, F. M. (2004). Macro perspective on intergovernmental relation in respect of local political structures: Jurnal of Public Administration, Vol.37 N.02, pp.140-143
33. Borrat, O., and Patrick Le Gables. (2005). “ France: the interminicipal revolution” pp. 12-20
34. Bullman, Udo, (2001). “ Germany: Federalism under Strain”, pp.85-90. Oxford University Press.
35. Schumacher, E, F., (2004). “Small is beautiful”, pp. 75
36. Crook, R. C., 1994”Four Years of the Gana District Assemblies Option, Decentralization and Administrative Performance” Public Administration and development. Vol 14, pp.390-99
37. Mendoca, J. (2004,October). Organizational impact of information technology: A leadership course for IT. Proceedings of the 5th conference on Information Technology Education, pp. 244, New York: ACM Press.
38. Hesse, J., Sharpe, L, (1991). “Local Government in international Perspective: Same Comparative Observation”. Pp. 607-609
39. Wiig, K. M. (1997). Knowledge management: An introduction and perspective. The Jurnal of Knowledge Management, 1(1), pp.4.
40. Blair, D. C. (2002). Knowledge management: Hype, hope, or help, Journal of the American Society for Information Science and Technology, 53(12), pp .1019.
41. Loughtin, J, Daniel,L, Seiler.,(2001), “France: Between Centralization and Fragmentation”, pp. 186-189. Oxford University Press.
42. Yilmaz S, Varsha, V. (2013). Local government Discretion and accountability in Philippines. Journal of International Development. Nr. 25, pp. 229-235.
43. Sharma, K. C., (2000). “popular participation in Botswana in United National. Decentralization and Citizen Participation in Africa, Regional Development, pp. 183
44. Gabriel, W., Eisenmann, S., (2005). “Germany: A new type of local government?”. Pp. 118-121.

45. Boyne, G.A., (1997), Comparing the performance of Local Authority: An Evolution of the Audit Indicators Local Government Studies. Vol. 23, No.4, pp. 17, 19.
46. Boyne G, A., (2002). “ Concept and Indikators of Local AuthorityPerformance: An Evolution of the Statutory frameworks in England and Wales”. Public, Money and managment. Vol.22, No. 2, pp. 18-23.
47. Checkoway, B. And Van , Til. J., (1978), What Do We Knowabout Citizen Participation? A Selected Review of Research in Caugton, ed, pp.60.
48. Staley,S. (1992). Bigger is Not Better: The Virtues of Decentralized local Government, Cato Institute Policy Analysis. No.166, pp.3-19
49. David, B. Walker.,(1987), “Snow White and Dwaf: from metro Cooperation to Governance”. National Civic review Vol. 76, No.1, pp.15
50. Maywood (1993). Local government: In the Third World: Experience of Decentralization in Tropical Africa. Pp.3
51. Kling,R.(1980).Social analysesof computing: Theoretical perspectives in recent empirical research. Computing Surveys, 12(1),pp.61.
52. World Bank, (2004). World Development Raport 2004: Making Services Work for Poor People, Work Bank.
53. Chang, H,J. (2002). Kicking away the ladder: Development strategy in historical perspective london: Anthew.
54. Congers, D. (2007) Decentralization and service Delivery: Lessons from Sub- Sabarak africa IdS Buklinn Nr. 38, pp. 18-29.
55. Hagard, S. Willis E, garman, C. (2001). Fiscal Decentralization: a political theory with Latin America Cases, World politics Nr. 53, pp. 205-233.
56. Manor, J. Crook, RC. (1998). Democracy and Decentralization in Suth Asia and West Africa: participation, accountability and performance. New York: Cambridge University press.
57. Manor, J. (1999). The political economy of Decentralization: World Bank Publication.
58. Rosenau JN, (1995), Governance in the Twenty- First Centaury. Global Governance. Nr. 1. pp. 15 -19.
59. Schouwalder, G. (1997). New Democratic Spaces at the grassroots? Popular participation in Latin America Local governments. Development and Chenge. Nr. 28. Pp. 757-760.

60. Stringler, G.J. (1957) The Tenable range of Functions of local government in: US Congress Joint Economic Committee (Ed), Federal Expenditure Policy for economic growth and Stability, Washington DC, pp.213-219.
61. Shah, A., Theresa, T. (2004). World Bank.
62. Samudavamja, C. (1991). Statey- Identity Creation, State- Bulding and Civil society. Pp. 61-72.
63. Stoka, K., Mohan, G(2002). Participatory Development and Empowerment: The Denyers of Location. Third World Quarterly. Nr.21, pp. 251- 261.
64. Serdar, Y., Yakup, B., Rodrigo, S (2008). Local Government Discretion and Accountability: A Diagnostic Framework for Local Governance. Local Governance and Accountability Series Papers, Nr. 113. World Bank.
65. Sancton, A. (2000). Menger Mania, Mc Gill-Queens, University Press, Montreal pp. 74
66. Boyne, G. A (1998). Public Choice theory and Local Government, Macmiller. Basingtole, pp.252
67. Witherdy, A., Dollery, B. E., Auster, M. And Marshall, N. A. (1997). Local government, Many perspectives: Reporter 2, Australian Institute of Urban Studies, Sudney.
68. Dollery, B. Crase, L, Is Biger local Government Better? A Evolution of The Economic Case for Australian Municipal Amalgamantion. No.2004-4, pp. 10-12.
69. Deller, S. C., and John M. Halstead (1994). “ Efficiency in the Production of Rural Road Services: The Case of England Towns”, Lokal Economiks Nr. 70, Vol. 20, pp. 248-249
70. Mera,k.(1973). “ On the Urban Agglomeration and Economik efficiency”. Vol 21, No.2, pp. 309-312.
71. Drucker, P. (1998). The coming of the new organization.Cambridge, MA: Harvard Buziness School Press.
72. Mabuchi, M. (2001). “Municipal Amalgamation in Japoni” Retrieved November, 24. 2008. From <<http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2005/07/26/009034120050726131910/rendered/PDF/330380JPOwbi37157.pdf>> .
73. Stein, E (1999). Fiscal Decentralization and Government Size Latin Americ. Jurnal of Applied Economocs, No.2, pp. 357-391.
74. Lim, J,D,(2007). A comparative Study of Performance Measurment in Korean local Governments Using Data Envelopment analysis and Stochastic Frontier. Pp 18-20.

75. Jom,,H. Fiva. (2006). New on the Effect of Fiscal decentralization on the Size and Composition of Local government. Vol. 62, No. 02, pp. 251-257.
76. Worthington, A. (1999). "Performance Indikators and Efficiecy Measurement in Public" Australian Economic, Review, Vol.32, No.1, pp 31-35.
77. Koven, S., and F. Hadwiger (1992). "Consolidation of rural Service Delivery" Publik Produktivity & manaxhementa. Review, vol. 15, No. 3, pp. 315-321.
- 78.** Pfaffenberger, B. (2004). Book review: Global control: Information technology and globalization since 1845. Technology and Culture ,pp. 45,214.
79. Dewars,j. A. (1998). The informcion age and the printing press:Looking backward to see ahead (Rand Paper P-8014).Santa Monica,CA: Rand Distribution Services.
80. Manxhari, M. Bazat e Qeverisjes, fq. 5,8,247-249.
81. Batalli, M. Reforma e administratës publike në Kosove, fq. 20.
82. Gazeta Shqip (2014,Prill). "Propozimet e Kryebashkiakeve në Komisionin Parlamentar", fq. 7.
83. Bodkin, R. G.,and David. W. Conklin (1971). "Scale and Other determination of Municipal Expenditer in Outavio: A Quantitation analysis" International Economic Review.Vol.1, No.3, pp.465 480.
84. Gabler,L.R. (1971). "Population Size as Determinationt of City Expenditures and Employment some Further Evidence" Land Economics. Vol 47, No. 2, pp.130-121.
85. Dollery B.E.and L.Roboti (eds),2008, The Theory and Practice ofLocal Government Reform, pp. 23.
86. WP.(eds),2002,Consolidation of Fragmentation,The size of Local Governmel in Central and Eastern Europe,Open Sociey Institue ,Local Government and Publik Service Reform initiative, Budapest, pp. 31-4.
87. Olson M. 1969, "The Principle of Fiscal Equivalence: the Divizion of Rensponsibilities Among Different Levels of Government", American economic Review, pp.49.
88. Local Gavernment in Norway. Norwegian Ministry of Local Government and Regional Development, 2008. Pg. 31.
89. Montin, S. Between fragmentation and co-ordination: the changing of localgovernment in Sweden, Public Manaxhmentt, 2000, Vol. 2 No. 1. Pp.2-21

90. Gustafson, A. Local Government in Sweden, Uddevalla: The sweden Institute, 1993, pp 138.
91. The country authorities as regional developers. Norwegian Ministry of lokalGovernment and regional devlopment. 2010
92. The Danish Local government System. Local Government Denmark, February, 2009, pp .21.
93. Bailey, S.J, local government Economics: Principles and Practice, London: Macmillan Press,1999,pp. 359
94. Byrnes, J., Dollery, B. Do Economics Scale Exist in Australian Local government? A review of the research Evidence, Urban Policy and research, 2002, Vol.20, No.4, pp. 390, 412.
95. Daflon B. and T. Madies ,2009, Decentralization: a Few Principles from the Theory of Fiscal Federalism, Agence Francaise de Developpement, Notes and documents, No 42, May,Paris. Pp.276-7.
96. Dollery, B. Fleming. E.A conceptua Note on Scale Economics Size Economies and Scope Economies in Australan Local Government, Urban Policy and Reserch, 2006, Vol. 24, No. 2, pp. 270-280.
